



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE  
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ  
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

## **STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

### **Teza**

### **“Ndikimi i mediave në politikbërje-RMV”**

**Kandidati:**

**Mirjeta Avziu**

**Mentori:**

**PhD: Jonuz Abdullai**

**Tetovë, mars, 2019**

# PËRMBAJTJA

## HYRJE

### **1. ASPEKTET TEORIKE TË MEDIAS DHE POLITIKBËRJES**

- 1.2 Roli i mediave në politikbërje
- 1.3 Mediat dhe kultura politike
- 1.4 Komunikimi me publikun (opinionin)
- 1.5 Informimi i drejtë dhe plasimi i lajmit

### **2. NDIKIMI I MEDIAVE NË POLITIKBËRJE NË MAQEDONI**

- 2.1 Etika gazetareske dhe liria e mediave
- 2.2 Mediatizimi i politikës
- 2.3 Qasja e mediave vendase ndaj politikbërjes

### **3. PËRVOJAT E MIRA NË RAJON**

- 3.1 Ndikimi i mediave në politikbërje në Shqipëri dhe Kosovë
- 3.2 Media e pavarura dhe shoqëria civile
- 3.3 Rrjetet sociale dhe ndikimi i tyre në politikë
- 3.4 Ndikimi i organizatave joqeveritare në politikbërje  
OJQ Eco Guerilla, OJQ Triagollnik, OJQ Civil

### **4. SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI**

- 4.1 Shpalosja e përgjigjeve nga intervistimi i kryeredaktorëve të televizioneve MTV1, MTV2, AlsatM, Kanal 5
- 4.2 Shpalosja e rezultateve nga pyetësi anketues

### **5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE**

### **6. PËRFUNDIMI**

### **7. BIBLIOGRAFIA**

## HYRJE

Bota mediatike di të jetë e butë, aq sa edhe e ashpër. Di të jetë joshëse për argëtim, por zemërngushtë në plasim të lajmeve të pakëndshme, tragjike. Ajo di të jetë e përshtatshme kur na konvenon, por edhe e hidhur kur prek komfort zonën me raportime pa hatër. Di të jetë e bukur dhe e shëmtuar në të njëjtën kohë, mu si konceptimi i qytetarëve për politikën. S' do shumë kohë për të kuptuar antipatinë politike nga qytetarët joshfrytëzues të benefiteve politike. Për ta kuptuar këtë, mjafton të jesh një dëgjues i heshtur në një tavolinë të mllëfosur nga bëmat disa dekadëshe të kombinimeve laramane të subjekteve politike, të kaluara në kohë, por të paharruara për qytetarët.

Edhe më e theksuar bëhet çështja kur mediat janë hapësirë ofruese për përfaqim të ideve utopike gjatë kampanjave parazgjedhore. Edhe më i mllëfosur bëhet populli që tashmë sheh reprizë me të nisur fushata zgjedhore. Edhe media si edhe politika, është një hapësirë e pafund që të ndërthen në vete me truqet e saja dhe varësisht nga përmbajtja momentale mediatike në transmetim, duke iu referuar ndodhive të fundit politike në vend, në moment të caktuar, vjen në shprehje kahëzimi i mundshëm nga fryn era, pikërisht nga ndjekësit “besnik”.

Kjo është pika kyçe e kësaj teme, pra si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë! Temë kjo e përbërë nga dy pjesë, atë teorike, e bazuar nga mendimtarë, autorë dhe hulumtues të çështjes në fjalë, dhe pjesa empirike, e bazuar në intervista dhe pyetësor anketues të realizuara enkas për këtë temë.

Njerëzit janë ata që dëshirojnë të dinë se çfarë ndodh në fushën e politikës, sepse vendimet politike ndikojnë në kualitetin e jetës së tyre, politika krah medias, gjen përkrahje për promovim të programeve të paguara politike, me mesazhe taktikore për të bindur votuesit, dhe të njëjtët kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre në lidhje me pëlqyeshmërinë e mënyrës së qeverisjes, kritikën ndaj po të njëjtës, nivelin pjesëmarrës në vendime bashkiake, etj.

Politika është aftësia për përvetësimin e pushtetit, kurse media del krah saj si hije ndjekëse e çdo procesi politik, duke informuar auditorin me anë të kumtimit të lajmit në

formën më të drejtë të mundshme. Media është ajo e cila duhet të shërbejë si sytë dhe veshët e publikut.

Etika gazetareske dhe rëndësia e saj, plasimi i lajmit në mënyrë të duhur sipas rregullave të kodit gazetaresk, gazetaria si profesion dhe llojet e tyre, komunikimi me publikun dhe ndikimi i mediave bashkëkohore në politikbërje, janë vetëm disa nga nëntitujt e kapitujve të kësaj teme. Duke dashur të jemi edhe më praktik dhe të prekim shembuj real të jetës politike në përditshmëri, kemi kontaktuar kryeredaktorë të televizioneve kombëtare dhe nga servisi publik dhe udhëheqës të organizatave joqeveritare, të cilët kanë shprehur hapur mendimin e tyre në lidhje me relacionin media-politikë, madje duke bërë edhe krahasime mes qeverisjeve të përbërjeve të ndryshme politike.

Pyetëtori anketues, përmes pyetjeve, prek të gjitha sferat e parapara të temës, duke lënë të nënkuptohet pakënaqësia e mënyrës së qeverisjes dhe jotransparenca e institucioneve lokale.

Gjatë viteve të fundit ka pasur rritje të dukshme të pushtetit politik përmes ndikimit të masmediave dhe rrjeteve sociale. Fakt për këtë është mundësia që të japin rrjetet sociale për të qenë në hap me ndodhitë politike nga vetë profilet e politikanëve dhe njëkohësisht kanë bërë që të afrohet raporti politikan-qytetarë.

Fuqia mediatike pothuajse është e pandalshme, dhe në shumë raste di të jetë e pamëshirshme kundrejt padrejtësive dhe manipulimeve.

## 1. ASPEKTET TEORIKE TË MEDIAS DHE POLITIKBËRJES

### 1.1. Roli i mediave në politikbërje

Nga studimet dhe publikimet e mendimtarëve të lashtë, politika nënkuptohej si një sferë e cila i dedikohej qenies njerëzore ose individit, atij të cilit di të komunikojë, të shprehet, diskutojë, argumentojë dhe të hartojë parime për funksionim të barabartë në aspekt të ndarjes së detyrave dhe qeverisjes afatgjate të bazuar në kushtetutë.

Idetë për funksionim dhe disiplinat e ndarjes së politikës, gjithnjë kanë rezultuar komplekse, por edhe më të theksuara i bën fakti që në politikë ekziston “luksi” i mospajtimit për ndonjë vendim ose arsyetim paraprak. Këto dukuri më së miri shpjegohen nga monografia “Politika” e Aristotelit, ndër të parat e këtij lloji, që ka shërbyer si abetare e të gjithë ndjekësve të kësaj shkence. Aristoteli në librin e tij të katërt sipas ndarjeve përmbajtësore të monografisë “Politika”, ndër të tjera flet për kushtetutën, sistemin oligarkik dhe demokratik.

Sipas Aristotelit: “Çdo shtet përbëhet nga cilësi dhe sasi. Me cilësi nënkuptoj lirinë, pasurinë, edukimin, lindjen e mirë, ndërsa me sasi nënkuptoj superioritetin në numër.<sup>1</sup> Qeveria mund të jetë e qëndrueshme vetëm atje, ku klasa e mesme i kalon si njërin ose të dyja, dhe në këtë rast, nuk ekziston mundësia që të pasurit të bashkohen me të varfrit në kundërshtim me rregullat.”<sup>2</sup>

Shkenca politike si disiplinë ekziston që në antikitet me vetë ekzistimin e njeriut duke u nisur nga nevoja e udhëheqësit të një grupi ose fisi, dhe duke u theksuar me krijimin e shtet-poliseve greke, kurse studimet e gjithë jetës së Aristotelit kushtuar politikës dhe zhvillimit të saj, janë dëshmi për këtë.

Aristoteli studimin e politikës e ka trajtuar si një degë e njohurisë praktike, që ka për qëllim të jetë veprim e jo teori. Sipas tij, veprimi politik është gjithmonë kontekstual ose i varur nga rrethanat, një veprim i agjentëve të veçantë duke u përballur me grup të veçantë të rrethanave. Ai gjithashtu besonte se perspektiva e teoricientit politik duhet të mos largohet shumë nga ajo e qytetarit të thjeshtë, ose e burrë-shtetasve.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Aristoteli, Politika, Botimi I, Plejada, Tiranë, 2003, fq. 113.

<sup>2</sup> Po aty, fq. 114.

<sup>3</sup> Veton Latifi, Politikologjia, Academic Press, Shkup, 2008, fq. 14.

Me kalimin e kohës dhe ndryshimit të pikëpamjeve të politikbërjes nga ideatorë dhe veprimtarë të kësaj lëmie, u ndikua që avash avash të formohej një shkencë e re politike në epokën e Renesancës dhe Iluminizmit, duke dalë në pah filozofë dhe studiues me ide dhe prirje të reja për politikën, si: Machiaveli, Spinoza, Ruso, Hegeli, e të tjerë.

Të gjithë ishin kontribues të kalimit të politikës në një nivel tjetër, respektivisht për krijim të institucioneve të lira që do të bashkëvepronin nën ombrellën e një rregulloreje të vetme, Kushtetutën.

Autorë të ndryshëm kanë disa përkufizime për politikën:

- Politika është arti i së mundshmes (Bizmarku).
- Politika është diçka shumë serioze për t'ua lënë vetëm politikanëve (Sharll de Goll).
- Duket se politika dhe lufta janë dy profesionet më të natyrshme të njeriut. Njeriu gjithmonë është detyruar ose të negociojë ose të luftojë (Pol Valeri).<sup>4</sup>

Ndërlidhja e mediave me politikën, është pothuajse e pashmangshme. Popullata preket direkt nga skena politike dhe përderisa të parët janë vendimmarës për qeverisjen e të dytëve, domosdoshmërisht lind dëshira ose mllëfi për reagime, komentime dhe kureshtje mediatike. Njerëzit janë ata që krijojnë ekipet për media dhe natyrshëm mund të nënkuptohet që interesimi dhe komentimi rreth qeverisjeve ose vendimeve të pushtetarëve, ka ekzistuar edhe para formësimeve të përparuara mediatike. Po i njëjti interesim vazhdon, por me dozë të shtuar dhe do të ekzistojë çdo herë.

Për t'u ndërlidhur më bindshëm në raportin e mediave, qytetarëve dhe politikës, dua t'i referohem studimit “Pushteti dhe politika: vështrime të mundësisë, zërit dhe lojës besnike”, kërkim i realizuar nga një grup i përbërë prej tre profesorëve universitarë të Miçiganit dhe Pensilvanisë.<sup>5</sup> Ky studim ka të bëjë me raportin mes politikës dhe qytetarëve. Ata paraqesin një model në të cilin riformulojnë dhe zgjerojnë mundësitë, dëgjimin e zërit dhe besnikërinë, me qëllim për të ekzaminuar rolin e fuqisë në marrëdhëniet midis shteteve dhe qytetarëve të tyre.

---

<sup>4</sup> Jonuz Abdulli, Politika dhe politikat publike, Botimi III, Arbëria Design, Tetovë, 2016, f. 59-60-61.

<sup>5</sup> Clark, William Roberts, Matt Golder, and Sona N. Golder. “Power and politics: insight from an exit, voice, and loyalty game”, 2013, f. 17-18  
[https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark\\_golder.pdf](https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark_golder.pdf)

Ky kërkim është i rëndësishëm për atë, të pushtetshmin, që nuk shpjegon se çfarë bën. Vini re se qytetarët përdorin zërin vetëm kur presin që ai të jetë efektiv. Me fjalë të tjera, ata përdorin zërin vetëm kur presin që shteti të përgjigjet. Si rezultat, modeli nuk mund të shpjegojë pse shtetet nganjëherë vërehen se nuk reagojnë ndaj kërkesave publike të bëra nga qytetarët e tyre. Sidoqoftë, kërkon vetëm informacion jo të plotë nga ana e qytetarit, për të marrë një ekuilibër në të cilin përdorimi i zërit të qytetarit injorohet nga shteti. Në një ekuilibër të tillë, një qytetar me një kërcënim të besueshëm të daljes, përdor zërin nën bindjen se shteti është i varur; megjithatë, ky besim është i gabuar dhe shteti autonom injoron zërin e qytetarit.<sup>6</sup>

Mediat kanë rëndësi të madhe në jetën e përditshme. Njeriu i rëndomtë një pjesë të rëndësishme të kohës së vet e kalon duke shfrytëzuar mediat që mund t'i arrijë: televizionin, radion, Internetin, filmat, video-lojërat, gazetat e shtypura, revistat, si dhe një varg mediash të tjera. Mediat shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, të cilat kryesisht grupohen në tri sfera: informative, arsimore dhe argëtuese.

Kjo ndarje tradicionale në lidhje me shfrytëzimin e mediave sot gjithnjë e më tepër zgjerohet përmes përdorimit të të ashtuquajturave “media të reja”, përkatësisht komunikimit përmes Internetit, kompjuterëve dhe pajisjeve celulare.

Pranuesit e përmbajtjeve mediatike janë një nga pikat kryesore në sistemin mediatik. Atyre u drejtohet porosia mediatike dhe reagimi i tyre kthehet prapë në media (feedback) dhe ndikon te mënyra sesi do të prodhohen përmbajtjet tjera. Gjegjësisht informata kthyesë është faktor kyç në realizimin dhe kumtimin e një lajmi të mirëfilltë. Duke e ditur rëndësinë dhe vlerën e mediave, nga praktika është lënë të nënkuptohet që me vetë rritjen e interesimit të ndjekjeve të ngjarjeve politike nga ana e mediave, subjektet politike bashkë me aktorët politik, janë ndjerë të “obliguar” për punë organizimi strukturor dhe planifikime më premtuese, me të vetmin qëllim që përmes raportimit në media të arrihet deri te rezultati i dëshiruar ose i përafërt me të.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> Clark, William Roberts, Matt Golder, and Sona N. Golder. “Power and politics: insight from an exit, voice, and loyalty game”, 2013, f. 17-18  
[https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark\\_golder.pdf](https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark_golder.pdf)

<sup>7</sup> Otfried Jarren, Medien, mediensystem und politische, Chapter 10, *Öffentlichkeit im Wandel*, 1998, f. 68  
[https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0\\_4](https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0_4)

Proceset politike, procesi i vendimmarrjes, afatet për realizim të një projekti, etj., jo rrallë herë kanë ditur që të përshpejtohen, të ndikuar nga “trysnia” pozitive e mediave, dhe kjo ka bërë që të arrihet deri me një kënaqësi të një grupi të pjesëshëm shoqëror dhe mospajtimin e pjesës tjetër. Dhe si rezultat i arritjes së një qëllimi të një grupi dhe shfaqjes së pakënaqësisë të tjetri, rrjedhimisht lindin ngjarjet dhe lajmet e ndryshme shoqëroro-politike të cilat të mbajnë të ngërthyer për terminet e ditareve informativë. Me këtë kuptojmë që krijohet lidhje e pandashme mes medias dhe politikbërjes, fushë kjo e cila çdo ditë ka risi dhe mund të etiketohet si “fabrikë e prodhimit të lajmit”.

Sipas komunikologut dhe profesorit universitar në Universitetin e Cyrihut, Otfried Jarren, në përgjithësi përmbajtja e mediave politike kuptohet si rezultat i proceseve ndërvepruese që ndodhin brenda kornizës së strukturave politike dhe mediatike ndërmjet aktorëve politik dhe mediave.

Jemi dëshmitarë që dy dekadat e fundit janë vitet në të cilat industria mediatike filloi me zhvillimin intensiv të masmediave duke filluar me *web* faqet e para *online* në vitin 2000 dhe më pastaj vazhdoi me paraqitjen e portaleve, rrjeteve sociale, digjitalizim i teknikës televizive, dhe sot, me teknologji të përparuar, kemi dhjetëra mënyra për informim.

Kjo është arsyeja pse në refleksionet e shumta sociologjike, nocionet si “shoqëri e informacioneve” apo “shoqëri e mediave”, janë shndërruar në karakterizim të situatës momentale të zhvillimit. Me nocionet në fjalë tregohet se në shoqëritë moderne është rritur rëndësia ekonomike, kulturore dhe politike e prodhimit, shpërndarjes dhe perceptimit të informacioneve.”<sup>8</sup>

Jaren në librin e tij “Komunikimi politik në shoqërinë e mediave”<sup>9</sup>, vëmendje të veçantë i kushton nivelit meso të organizatave dhe nivelit makro të shoqërisë, pasi komunikimi politik është kryesisht një formë e organizuar e komunikimit, si nga ana e politikës ashtu edhe nga ana e mediave.

Madje edhe më tepër: sistemi i mediave është shndërruar në infrastrukturën qendrore të shoqërisë moderne. Mediat njëkohësisht bëhen gjithnjë e më tepër parakusht për praktikën e informimit dhe të komunikimit të aktorëve të tjerë, përfshirë këtu informacione nga fusha

<sup>8</sup> Otfried Jarren, *Medien, mediensystem und politische*, Chapter 10, *Öffentlichkeit im Wandel*, 1998, fq. 72 [https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0\\_4](https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0_4)

<sup>9</sup> <https://www.springer.com/de/book/9783531934464#>



sociale, pedagogjike, akademike dhe me theks të veçantë informacionet në fushën e politikbërjes.<sup>10</sup>

Pa media publicistike pothuajse nuk është i mundur komunikimi mes organizatave në shoqëri dhe publikut të përgjithshëm. Opinioni politik në demokracinë moderne, për shkak të strukturës, përmbajtjes dhe proceseve të tyre në masë të madhe, është i ndikuar nga mediat, por gjithnjë duke u munduar në maksimum për informim të paanshëm, të drejtë dhe transparent për auditorin dhe ndjekësit mediatik.

Jarren lë të kuptohet që funksioni apo roli i mediave në proceset politike dhe politikbërje, pothuajse është vendimtar, gjithnjë duke u thirrur në informimin e drejtë dhe lajmin e pashtrembëruar ose favorizues. Animet partiake s'kanë të bëjnë asgjë me gazetarinë. **“Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike”**, kështu këshillon edhe Kodi Etik i gazetarisë, për të cilin do të flasim më detajisht në kapitujt e veçantë të kësaj teze.<sup>11</sup>

Nga qasja e hierarkisë së pushtetit, në literaturën politologjike, hasim në tre modele evaluimi të përqendrimit të ndikimit në raportin mediat dhe politika:

- *Modeli Biotop* – në këtë grup kemi dy aktorë kryesorë: aktori politik dhe ai i mediave. Që të dy aktorët korrespondojnë mes veti mrekullisht. Ato vendosin së bashku se çfarë do të jetë “top temë” e ditës e çfarë jo. Pra, mediat dhe politika/qeveria vendosin, së bashku, për agjendat politike. Si politikat poashtu edhe mediat janë të varura nga njëra tjetra.
- *Modeli Mediokrat* – këtu mediat janë faktorë vendimtarë. Së paku në këtë grup, mediat kanë një rol të fuqishëm. Madje, këto konsiderohen edhe si dhunë e katërt në aparatën shtetërore. Është media ajo e cila vendos në këtë grup, si nga lartë në drejtimin politik (shteti), poashtu nga poshtë në drejtimin e opinionit.

---

<sup>10</sup> <https://www.springer.com/de/book/9783531934464#>

<sup>11</sup> Otfried Jarren, *Medien, mediensystem und politische, Öffentlichkeit im Wandel*, 1998, f. 75-76

[https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0\\_4](https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0_4)

- *Modeli Bottom-Up* – në këtë grup opinionioni publik është faktor vendimtar. Ai përcakton agjendat politike. Mediat, poashtu, si në modelin *top-down* kanë rolin transportues. Këtu mediat nuk instrumentalizohen nga politika. Përkundrazi janë në shërbim të opinionit publik.

- *Modeli Top-Down*, ku aktorët politik kanë një rol aktiv dhe të njëjtët përmes vendimeve dhe qëndrimeve të tyre, ndikojnë në botën reale. Çdo ndryshim dhe ngjarje në kohë dhe hapësirë, regjistrohet nga këta aktorë. Këto vendime dhe ngjarje pastaj do ju servohen mediave, të cilat ekskluzivisht janë të varura nga ky burim informacioni.<sup>12</sup>

Partitë politike, duke pasur parasysh fuqinë e ndikimit të mediave, shpesh mundohen që t'i joshin materialisht pronarët e mediave. Kjo tendencë, nëse do të arrinte sukses të plotë, atëherë media dhe gazetarët do të bëheshin shërbëtorë vetëm të një pjese të shoqërisë, e jo shërbëtorë të interesit të përgjithshëm publik – që është mision kyç i gazetarisë. Media duhet të kultivojë dhe përforcojë demokracinë dhe të mos propagandojë vetëm për një parti, veprim që çon drejt sistemeve jo demokratike dhe autoritare. Duke marrë parasysh aktivitetet politike, politikbërjen dhe prezantimin e tyre, ky zhvillim paraqet një sfidë të re për të gjithë aktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve në shoqëri.

## 1.2. Mediat dhe kultura politike

Mediat nuk i japin më formë jetës sonë, ato janë jeta jonë. Që nga momenti kur do t'i hapim sytë nga alarmi i mëngjesit, nga mijëra bilborde e pllakate që i kalojmë derisa shkojmë të hamë drekë, nga revistat e gazetatat ditore që i shfletojmë me kafën e pasdites, e derisa nuk na zë gjumi me televizorin, lap-topin ose kompjuterin ndezur. Me vetëdije a pa të, marrim dhe dërgojmë me mijëra informacione e porosi në ditë përmes mediave të ndryshme. Por, para se të vijoj me rëndësinë dhe mendimet e autorëve të ndryshëm në lidhje me to, do të kisha dashur t'i hedhim një sy gjenezës së fjalës së lirë.

---

<sup>12</sup> Bekim Baliqi, Politikat publike dhe qeverisja, Prishtinë, Konrad Adenauer Stiftung, 2017, f. 35

[https://www.kas.de/c/document\\_library/get\\_file?uuid=eac7e031-f7c5-3c26-f5f0-a3f9aa9bf7e4&groupId=252038](https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=eac7e031-f7c5-3c26-f5f0-a3f9aa9bf7e4&groupId=252038)

E drejta e fjalës pa mëdyshje paraqet një prej përfitimeve themelore të civilizimit në rrafshin global. Bëhet fjalë për liri, e cila sot njihet si një ndër të drejtat themelore të njeriut. Historia e kësaj të drejte fillon nga fundi i shek 17 dhe fillimi i shek 18, paralelisht me filozofinë e sqarimit, luftën e lirisë së vulës dhe luftën kundër qeverisjes despotike. Mund të thuhet se “liria e fjalës dhe mendimit” arrihet me “të drejtën e shtetësisë”, atëherë fillon edhe historia e shoqërisë demokratike.<sup>13</sup>

E drejta e fjalës përmendet në dekretin mbretërorë të Suedisë të lirisë së vulës (1766), në deklaracionin për të drejtat e shtetit Virxhinia (1776), ashtu si edhe në amendamentin e parë të Kushtetutës së SHBA-së (1791), por edhe në kushtetutat evropiane të demokracive parlamentare, siç janë kushtetuta e Holandës (1875) dhe e Belgjikës (1831). E drejta e fjalës është element përbërës edhe në kushtetutat aktuale. Kjo liri është e përmbajtur në preambulën e Kushtetutës së Francës (1958), por gjithashtu është e inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (1991).

Kështu në nenin 16 të Kushtetutës sonë qëndron:

“Garantohet liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehja e mendimit publik. Garantohet e drejta e fjalës, shfaqjes publike, informimi publik dhe themelimi i lirë i institucioneve për informim publik...”<sup>14</sup>

Me anë të këtij historiku të shkurtër, rikujtojmë edhe një herë që e drejta e fjalës dhe e informimit ka prejardhjen prej shumë vite më parë, dhe me kalimin e dekadave dhe shekujve e njëjta ka pësuar edhe më shumë shtrirje dhe zbatim.

Liria e fjalës është një parim që mbështet lirinë e një individi ose të një komuniteti për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre pa frikë nga hakmarrja, censura ose sanksioni ligjor. Shprehja "liria e shprehjes" përdoret ndonjëherë në mënyrë sinonime, por përfshin çdo veprim të kërkimit, marrjes dhe shpërndarjes së informacionit ose ideve, pavarësisht nga mediami i përdorur.

Nëse në kohën e komunizmit në Maqedoninë e Veriut, nuk guxohej të lexohej, flitej e të mësohej shqip, sot në sistemin demokratik gjërat kanë ndryshuar dukshëm, duke përfshirë këtu shprehjen e lirë të mendimit në publik, arritjen e lirisë së informimit të mediave dhe

<sup>13</sup> Климе Бабунски, Емилија Симоска, Наташа Габер, Политичката култура на граѓаните во Република Македонија, Скопје, 2001, f. 79.

<sup>14</sup> По ату, f. 80.

përdorimin e shumëllojshmërisë së mediave për t'u informuar, me çka futemi në termet e mediave masive, të cilat kanë arritur nivel të avancuar të zhvillimit dhe besueshmëri te publiku.<sup>15</sup>

Por çfarë në fakt paraqet mendimi politik publik?

Zakonisht njerëzit kanë mendime për çdo subjekt dhe paraqitje, duke përfshirë kandidatët politik, politikën publike, yjet kinematografike, futbollistët, etj. Mendimi publik ka të bëjë me qëndrimet dhe mendimet e njerëzve për punët publike, dhe më shpesh prezanton reagim të njerëzve për ndodhi konkrete politike ose reagim pas ndonjë sjelljeje konkrete të ndonjë personi politik.<sup>16</sup>

Media është ndërmjetës, përçues ose mjet: është kanal përmes të cilit qarkullojnë informacionet. Media është diçka që e shfrytëzojmë kur dëshirojmë që në mënyrë indirekte të komunikojmë me njerëzit tjerë. Fjala “media” përfshin një numër të madh mjetesh bashkëkohore të komunikimit: televizionin, kinemanë, filmin, radion, fotografinë, gazetën, revistën, bartësit e zërit (CD-të muzikore, pllakat etj.), lojërat kompjuterike dhe internetin. Disa media, si për shembull interneti ose telefonat celularë, janë media hibride (multimedia), për shkak se në vete përfshijnë më shumë media (radio, kamerë, ekran, telefon etj.) dhe tekste mediatike. Fjala “tekst mediatik” shënon simbolet – programin kompjuterik (softuerin), pamjet (e lëvizshme ose statike), muzikën, tekstin e shtypur, ueb-faqet etj, të cilat transmetohen përmes mediave. Jo rrallë, këto media quhen mas-media, për shkak se mundësojnë komunikim me informacione ndërmjet një publiku të gjerë, ndërkohë që, gjithashtu, e njëjta mund të përfshijë dhe një numër relativisht të vogël, siç është me studentët në ligjërata ose me publikun para “video-bimit”.<sup>17</sup>

Praktika ka treguar se sa më e hapur të jetë një shoqëri, gjasat janë më të mëdha se ajo do ta zhvillojë teknologjinë e komunikimit maksimalisht. Avash avash mediat janë shndërruar nga shtëpi informative, në aktorë kryesorë të informimit të ngjarjeve, qoftë edhe më të vogla.

---

<sup>15</sup> Димитар Мирчев, Лидија Христова, Модерната политологија, ФОН Универзитет, Скопје, 2008, f. 218.

<sup>16</sup> По ату, f. 2018.

<sup>17</sup> Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup 2010, f. 11.  
<http://www.medium.edu.mk/attach/mpal.pdf>

Me kalimin e viteve dalin në pah termet “komunikimi masiv” dhe “media masive”, të cilat u krijuan në fillim të shekullit 20, që të përshkruajnë një fenomen të ri shoqëror dhe një nga tiparet kryesore të botës moderne, ndërtuar mbi themelet e demokracisë popullore dhe industrializimit.<sup>18</sup> Me zhvillimin e hovshëm të mas-medias, dhe me ofertën e shumëllojshmërisë përmbajtësore, nuk ka mundësi për ndjekje absolute, për vetë faktin që shijet dhe preferencat ndryshojnë duke u bazuar në opsionet e shumta që ka audiencia.

Mas-mediat së bashku me komponentët e përmendur më lartë, janë pranuar si të rëndësishme politikisht që prej arsimimit masiv dhe shtypit popullor në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Gjithsesi pranohet gjerësisht që nëpërmjet kombinimit të ndryshimeve shoqërore e teknologjike, mediat janë bërë aktorë politik gjithnjë e më të fuqishëm dhe, në disa aspekte, të ndërthurura më thellë në procesin politik.<sup>19</sup>

Tre zhvillime janë veçanërisht të rëndësishme:

- Së pari, ndikimi i të ashtuquajturve agjentë “parësorë” të socializmit politik, si familja dhe klasa shoqërore, ka rënë.
- Së dyti, zhvillimi i audiencës së televizionit masiv që prej viteve 1950-të e në vazhdim, dhe në kohët e fundit shtimi i kanaleve dhe prodhimeve të mediave të lidhura me mediat e “reja”, ka rritur në masë depërtimin e mediave në jetën e përditshme të njerëzve. Kjo do të thotë që tani publiku varet nga mediat shumë më tepër se sa që ishte ndonjëherë më parë.
- Së treti, mediat janë bërë aktorë ekonomikë më të fuqishëm. Jo vetëm që korporatat kryesore mediake janë bërë lojtarë më të fuqishëm global, por një sërë shkrirjesh kanë synuar bashkimin e sferave të veçanta të publikimit, televizionit, filmit, muzikës, kompjuterëve dhe telekomunikimit në një industri të vetme e masive “infoargëtimi”.<sup>20</sup>

E këtu, domosdoshmërisht theksi bie mbi segmentin audiencë. Audiencat e medias janë bërë më pak ‘masive’ dhe më shumë përzgjedhëse. Për shembull, në vitin 1930 pothuajse çdokush gjente stacionin radiofonik që transmetonte *Amos ‘n’ Andy*. Sot stacioni i tregut i

---

<sup>18</sup> Lindita Aliu Tahiri. Bazat e komunikimit masiv, Tiranë, 2018, f. 20.  
<https://stereotipe.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

<sup>19</sup> Po aty, f. 21.

<sup>20</sup> Margaret Scammell, Holli Semetko, The media, journalism and democracy, United Kindom, 2000, f. 43  
<https://www.crcpress.com/The-Media-Journalism-and-Democracy/Scammell-Semetko/p/book/9781138729612>

klasifikuar në krye të një tregu të madh është me fat nëse tërheq 10 për qind të audiencës. Në vitin 1950 *I love Lucy*, ishte një shou televiziv i klasifikuar në majë me rreth 50 për qind të shikuesve që ndiqnin atë. Në vitin 1980 *The Cosby Show* renditej i pari me rreth 33 për qind ndjekës, kurse në vitin 2007 CSI kishte rreth 13 për qind ndjekës. Në vitin 1960 në çdo katër të rritur pothuajse tre prej tyre lexonin një gazetë, sot kjo shifër ka rënë në çdo dy vetë, një lexon. *Reader's Digest* kishte një qarkullim prej 18 milion kopjesh në vitin 1976, sot kjo shifër ka rënë në 10 milionë.<sup>21</sup>

Të dhënat e lartpërmendura janë dëshmi e rëndësisë së publikut në raport me ndjekësit ose audiencën. Arsyet e këtij ndryshimi vijnë si rezultat i angazhimeve të shumta dhe jetës dinamike deri në atë shkallë, sa që pothuajse nuk kanë aspak kohë të lirë për ndjekje mediatike. Edhe në rastet e rralla për informim mediatik, preferojnë përmbajtje të caktuara të preferencave të tyre që të argëtohen ose shpërqendrohen nga përditshmëria e ngarkuar.

*Dominick* është shumë praktik për sa i përket shembujve dhe statistikave të lartpërmendura, duke pasur parasysh që edhe sot e kësaj dite vlejnë faktet e njëjta, bile edhe më të theksuara, sepse media ka arritur llojshmërinë më të madhe të historisë së saj deri më sot, me zgjidhje pafund për kanale që dëshirojmë. Me mundësi ndjekjeje të kanaleve të ndryshme botërore me anë të kabllovikut, satelitit ose internetit. E mos të flasim për kapshmëritë e përmbajtjeve të ndryshme që i kemi në dispozicion përmes *YouTube-s* e bllogjeve të ndryshme.<sup>22</sup>

Vlen të përmendim përparimin e teknologjisë, gjë e cila ka sjellë deri në qasje të reja drejt lajmit, bashkë me të edhe sjelljen në “jetë” të rrjeteve sociale të quajtura si pjesë e mediave elektronike dhe të ndjekura nga miliona njerëz në gjithë botën. Sot përmes teknologjisë moderne të komunikimit jemi të mbërthyer 24 orë në çdo ditë të javës dhe e kemi informacionin të përdorshëm menjëherë, në çdo kohë dhe në çdo vend. E gjithë kjo frymë e re dhe i gjithë ky avancim, nuk mund të paramendohet nëse një populli nuk i është ushtruar edukim i avashtë kulturor-politik, pikërisht përmes mjeteve të komunikimit ose medias. Kështu duke bërë që qytetari ose publiku të jetë i gatshëm të pranojë dhe t’i zbatojë në praktikë dhe diskutime, frymat e reja politike, me çka do të vinin në shprehje aftësitë e kulturës shoqërore, bashkë me të edhe kulturën politike.

---

<sup>21</sup> Joseph R. Dominick. *Dinamika e komunikimit masiv (media në periudhën digjitale)*, UET Press, Tiranë, 2010, f. 55

<sup>22</sup> Po aty, f. 56

Rëndom kultura politike nënkuptohet si një variabël që bashkëvepron në mënyrë jo të lehtë me faktorët ekonomikë, social dhe madje edhe institucionet. Çdo shoqëri ka kulturën që dallohet me vlerat dhe stilin e jetesës së pjesëtarëve të vet, nga ato të shoqërive të tjera. Kulturën e kuptojmë si mënyrë komplete të jetës së njerëzve dhe si pasuri që individët e fitojnë nga gjeneratat para tyre, ose me fjalë tjera, kultura mund të trajtohet si pjesë e mjedisit që është nga njeriu dhe si e tillë ajo e rrethon ose ndikon ndaj aksionit social, por nuk e përcakton plotësisht.<sup>23</sup>

Në botën e sotme, termi kulturë politike është bërë pjesë e gjuhës së përditshme, si në media ashtu edhe në bisedat aktuale. Për të ekspozuar atë që tani quhet kulturë politike, zakonisht flitet për zakone, karakter kombëtar ose vetëdije kolektive, duke përfshirë dimensionet e veçanta të fenomeneve shoqërore dhe politike, gjegjësisht ka origjinën kur këto sjellje ndahen në të njëjtën mënyrë nga një grup specifik, që lidhet me udhëheqësinë e një qeverie të caktuar.

Ekzistojnë definicione nga autorë të ndryshëm në lidhje me përkufizimin e kulturës politike:

*Denis Kavanagh:* Kultura politike është pjesë e kulturës së përgjithshme të shoqërisë dhe përfaqëson tërësinë e vlerave themelore, ndjenjat, njohuritë, qëndrimet dhe bindjet brenda të cilave vepron sistemi politik i vendit, duke i dhënë formën dhe përmbajtjen e procesit politik.<sup>24</sup>

Me definicionin e kulturës politike të Kavanagh, nënkuptojmë virtytet njerëzore të një individit, ndërtimin e karakterit në bazë të virtyteve dhe përgatitjes ose ndërtimit të principeve si pasojë e së cilave do të merren vendime. Kultura e përgjithshme ka të bëjë me të përditshmen, qëndrimin, trajtimin, përgjegjësinë, përmbushjen e obligimeve, etj, nga të cilat del formësimi adekuat i një individit të kompletuar, që nesër të quhet denjësisht posedues i kulturës politike.

---

<sup>23</sup> Jonuz Abdulli, Politika dhe politikat publike, Botimi III, Arbëria Design, Tetovë, 2016, f.119

<sup>24</sup> Po aty, f. 119.

*Norberto Bobbio*: Kulturën politike e përcakton si "bashkësia e qëndrimeve, normave dhe besimeve, të përhapura gjerësisht nga anëtarët e një njësie të veçantë shoqërore, dhe qëllimi i së cilës janë fenomenet politike."<sup>25</sup>

Sipas Bobbio, filozofit italian të drejtësisë, shkencës politike dhe historian i mendimit politik, definimi i kulturës politike nga këndvështrimi i tij, të jep përshtypjen e një shtëpie me rregulla patriarkale, e cila në sipërfaqe karakterizohet me përmbushjen e të njëjtave deri në pikën e fundit, kështu duke bërë që së bashku të arrihet deri te caku ose qëllimi i përbashkët, në rastin e Bobbio, të jenë në epiqendër fenomenet politike.

*Gabriel Almond dhe Sidney Verba*: Koncepti kulturë politike është zhvilluar dhe është ngushtë i lidhur me konceptin e sistemit politik. Në kuptim të gjerë, kultura politike përfshin tërësinë e të gjitha karakteristikave të personalitetit me rëndësi për politikën. Kultura erdhi si vijim i përpjekjeve për të faktorizuar botën shpirtërore të njerëzve në shpjegimin e politikës. Kultura politike nxjerr në pah njëfarë pavarësie të kulturës nga faktorët ekonomik dhe rolin e kulturës për rendin politik dhe zhvillimin ekonomik. Ata argumentojnë se kultura politike, e ashtuquajtura kultura qytetare, është e përshtatshme për demokracinë dhe e bën atë më stabile. Kultura politike është rezultat i orientimeve kognitive (njohëse), emocionale dhe evaluase (vlerësuese) në drejtim të sistemit politik, aspekteve hyrje (input) dhe dalje (output), sipas vendit që ka në sistemin politik.<sup>26</sup>

Almond dhe Verba njihen si dy prej autorëve me qasje më të përafërt të kulturës politike edhe në nocionin e saj në ditët e sotme, meqë në përkufizimin e tyre përfshijnë sferat e ndryshme të cilat preken nga politikbërja e një vendi. Ata kishin për qëllim të identifikonin kulturën politike, që përkrahte më efektivisht politikën demokratike. Sidoqoftë politikologët e përdorin termin në një kuptim më të ngushtë, për t'iu referuar orientimit psikologjik të njerëzve, ku "kultura politike" është "modeli i orientimeve" për objektet politike si partitë, qeveria, kushtetuta, të shprehura në besime, simbole dhe vlera. Kultura politike dallon prej opinionit publik për faktin se modelohet prej vlerave afatgjata dhe jo thjesht prej reagimeve të politikave dhe problemeve specifike.

---

<sup>25</sup> Norberto Bobbio, *Politika e cultura*, Cambiagio, 1955, f. 50.

<sup>26</sup> Jonuz Abdulli, *Politika dhe politikat publike*, Botimi III, Arbëria Design, Tetovë, 2016, f.120.



Kultura në kuptimin e saj të gjerë, është mënyra e jetesës së njerëzve.<sup>27</sup> Sociologët dhe antropologët priren të bëjnë dallim mes kulturës dhe natyrës, ku e para përqarkon atë që kalohet nga një brez tek tjetri, me anë të mësimit dhe jo nga trashëgimia biologjike. Megjithatë, shkencëtarët politik, e përdorin shprehjen në një kuptim më të ngushtë për t'iu referuar prirjes psikologjike të një populli, ku kultura politike është modeli i prirjeve ndaj objekteve politike si partitë, qeveria, kushtetuta, shpreh në besime, simbole dhe vlera. Kultura politike dallon nga opinioni publik në atë që modelohet më fort nga vlerat afatgjata, sesa nga reagimet e thjeshta të njerëzve ndaj politikave dhe problemeve të veçanta. Kultura politike nënkuptohet si orientim i njerëzve ndaj objekteve politike, siç janë partitë, qeveritë, kushtetutat, të shprehurit në besime, simbole dhe vlera.<sup>28</sup>

Gjithashtu, një rol të veçantë në krijimin e kulturës politike luan edhe gjuha si mjet komunikimi i njeriut dhe si faktor i lidhur me jetën politike të shoqërisë. Kultura politike mund të shqyrtohet më detajisht në tre lloje themelore të kulturës politike:

- Parokiale (parochial),
- Nënshetase (subject)
- Pjesëmarrëse (participant)<sup>29</sup>

Kultura politike e tipit parokial, karakterizon ato persona që as nuk dinë ndonjë gjë, as nuk kanë ndonjë qëndrim ndjesorë dhe as ndonjë qëndrim vlerësues për sistemin politik qendror (më së shpeshti në nivel qendror ose kombëtarë), ashtu siç nuk kanë edhe ndonjë ndjenjë të kompetencës politike.<sup>30</sup>

Duke u nisur nga përkufizimi i grupi të parë të kulturës politike, më bie në mend ai grup i caktuar e shoqërisë, i cili është i pavarur nga jeta politike dhe veprimtaria e saj, kështu duke u fokusuar në zhvillimin e biznesit familjar ose gjetjen e vendeve të punës pa ndikime politike, p.sh.: kjo vërehet qartë në qëndrimin indiferent nga ana e tyre kundrejt rrjedhës së politikës në vend dhe mosinteresimit të ecurisë së proceseve politike. Kjo më e theksueshme është te ajo pjesë e vogël e popullatës, puna e të cilëve është e lidhur me projekte të organizatave të vendeve evropiane ose trajtojnë projektet direkt me klientë të huaj.

---

<sup>27</sup> Andrew Heywood. Politika, Macmilan Foundations, 1997 (2008), f. 186.

<sup>28</sup> Po aty, f. 186.

<sup>29</sup> Jonuz Abdulli, Politika dhe politikat publike, Botimi III, Arbëria Design, Tetovë, 2016, f.125.

<sup>30</sup> Hysamedin Feraj, Shkenca Politike, Botimi I, Tiranë, 2004, f. 183.

Tipi i kulturës politike të nënshtetasit karakterizon ato persona apo grupe që kanë njëfarë orientimi njohës, ndjenjësorë dhe vlerësues ndaj sferës “Output” të sistemit politik, por bëjnë përpjekje për t’i ndikuar dhe formësuar vetë këto dalje të sistemit politik.<sup>31</sup>

Rast konkret në lidhje me llojin e kulturës politike nënshtetase, kemi njerëzit ose pjesën e popullsisë e cila të njëjtën e sheh si njohuri (për të qenë i njohur me situatën në vend), e sheh si vlerësim (për të mundur të japë mendimin e tij/saj në lidhje me një ndodhi të caktuar politike) dhe e sheh si ndjenjë që e nxit të jetë pjesë e diçkaje (ndodhie politike) aktuale.

Tipi i kulturës politike të pjesëmarrësit karakterizon ato persona apo grupe që kanë një orientim njohës, ndjenjësor dhe vlerësues si ndaj sferës hyrëse edhe ndaj sferës dalje të sistemit politik.<sup>32</sup>

Karakteristikë e këtij tipi të kulturës politike është mënyra se si pjesa më e madhe e shoqërisë janë të dhënë pas politikës në mënyrë të pakusht, dhe e konsiderojnë të domosdoshëm faktin e të qenit të informuar për ecurinë politike në vend, veçanërisht për subjektin për të cilin ata favorizojnë. Te ky grup përfshihen pjesa më e madhe e popullatës së vendit, banorë të cilët i përkushtohen totalisht pjesëmarrjes politike, por duke përfshirë edhe aktorët politik ushtrues të pushtetit dhe opozitës dhe çdo partie të mundshme, qoftë edhe e vogël.

Si përfundim, kuptuam që kultura politike është koncept që përmbahet prej qëndrimeve, bindjeve dhe vlerave në të cilat mbështetet veprimtaria e një sistemi politik. Gjegjësisht shpjegimet kulturore ndihmojnë se si mund të ndryshojë reagimi ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve politike në shoqëri të ndryshme.<sup>33</sup>

---

<sup>31</sup> Hysamedin Feraj, Shkenca Politike, Botimi I, Tiranë, 2004, f. 184.

<sup>32</sup> Po aty, f. 185.

<sup>33</sup> Seeu/Bachelor, Lënda Kultura politike, ligj7, prof. Hasan Jashari.

### 1.3. Komunikimi me publikun (opinionin)

Format më të hershme të komunikimit njerëzor janë ndikuar nga natyra me të cilën janë rrethuar njerëzit. Shenjat dhe simbolet, muzika dhe vallëzimi dhe ritualet, që ende sot kanë ngelur në zona të caktuara, si pasojë e traditës dhe filleve të para të mënyrës së komunikimit me njëri-tjetrin. Njeriu si qenie më e përsosur dhe më e dalluar nga gjithë qeniet tjera, arrin t'i përdor tingujt dhe shenjat duke u dhënë kuptime të shumëllojshme, brenda sistemit gjuhësor.

Ndër të tjera, komunikimi mund të konceptohet si: orvatje për përshtatje, në të cilën transportit të informacionit i duhet shtuar loja e roleve dhe e akteve, nëpërmjet të cilave bashkëbiseduesit e njohin njëri-tjetrin si të tillë, vepronë si të tillë dhe kështu ndërtojnë bashkësi gjuhësore në një botë njerëzore.<sup>34</sup>

Kërshëria e njerëzve për botën që i rrethon, dëshira për të mbledhur dhe kontrolluar informacionin, dhe jeta sociale e ka transformuar kafkën, trurin dhe aparatit e të folurit, duke e bërë të mundur komunikimin gojor të njerëzve dhe zhvillimin e gjuhëve. Njerëzit kanë qenë të organizuar në bashkësi të përbëra nga grupe familjare. Kur bashkësitë filluan të rriten, prijësit e tyre krijuan nevojën sociale për ta përcjellë mesazhin më larg, dhe këtu u shfaq dallimi mes audiencës dhe interpretuesve, dhe kujdesin për këtë ndarje, pra për audiencën. Publiku ishte pasiv dhe merrte mesazhet politike, fetare, didaktike, kulturore, të transmetuara, ngjashëm si sot, nga TV, radio, teatri, etj. Ekzistenca e komunikimit njerëzor në hapësirë dhe në kohë, është një fakt shumë më i hershëm se sa mediat masive të kohës së sotme. Ai ka qenë pjesë integrale e organizimit të shoqërive të hershme, sidomos përbrenda institucioneve religjioze, politike dhe arsimore. Madje edhe elementi i masivitetit ka qenë i pranishëm qysh herët, me propagandën politike dhe fetare. Në një mënyrë, dukuritë e këtilla mund të quhen komunikim masiv, edhe pse ato nuk janë shfaqur në trajtën e asaj që sot kuptohet si 'media'.<sup>35</sup>

---

<sup>34</sup> Christian Baylon, Xavier Mignot. Komunikimi, Logos A, Shkup, 2004, f. 179.

<sup>35</sup> Lindita Aliu Tahiri. Bazat e komunikimit masiv, Tiranë, 2018, f. 78-79.

<https://stereotipe.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

Është interesant historiku i dukurisë së komunikimit dhe transformimit në të shpjeguar që ka pësuar kjo fushë, por ajo që peshon në këtë mes, është ekzistenca e komunikimit mijëra vite më parë dhe se si inteligjenca dhe aftësia përmirësuese e trurit të njeriut, ka arritur ta çojë atë deri në këtë fazë të avancuar në shoqëri, kështu duke bërë që i njëjti të gjejë zbatim, referim dhe thirrje të ndryshme profesionale të kësaj dege.

Por çka nënkupton komunikimi sot?

Në studimet e shkencave shoqërore nocioni ‘komunikim’ haset shpesh, madje jo rrallë herë thuhet se jetojmë në një qytetërim të komunikimit. Por, ky koncept nuk është i ri, sepse njeriu nga natyra është qenie komunikimi, dhe tipar i tij kryesor është gjuha, e cila në thelb shërben për të komunikuar. Mjetet e komunikimit janë zhvilluar aq shumë, sidomos me lindjen e shtypshkronjës dhe me mundësinë e riprodhimit të pafund të fjalës falë mediave, sa që komunikimi sot ka marrë përmasa globale. Komunikimi njerëzor e shfaq gjithë origjinalitetin e vet kur bëhet nëpërmjet gjuhës. Thënë më së thjeshti, komunikimi është transmetimi i mesazheve prej dërguesit tek marrësi.

Në vitet 50-të të shekullit të kaluar, studiuesi Harold Lasswell, ofroi një model narrativ për të shpjeguar komunikimin. Sipas tij, për ta përshkruar procesin e komunikimit duhet t’u përgjigjemi disa pyetjeve: Kush thotë Çka, Përmes Cilit kanal, Kujt i drejtohet dhe Çfarë efekti ka? Anise ky është model i thjeshtë dhe praktik, ai nuk e përfshin reagimin e marrësit dhe nuk e shfaq komunikimin si proces të krijimit të kuptimeve të përbashkëta.<sup>36</sup>

Nga lartë nënkuptojmë që mënyra e të folurit, transmetimi i mendimit dhe pranimi i të njëjtëve nga pala bashkëbiseduese, kanë sjellë drejt zgjerimit të nocionit të komunikimit edhe pse dukuria komunikative ka qenë prezente që me ekzistencën e qenies njerëzore. Me kalimin e viteve dhe me përsosmërinë e mendjeve krijuese dhe shpikëse nga dekada në dekadë, komunikimi ka pësuar përparim qoftë në teori apo praktikë. Sot i njëjti ka rol bazik në pozicionimin në shoqëri, arsim, vend të punës, etj.

Pjesë e rëndësishme e shtrirjes së komunikimit është edhe zhvillimi mediatik, duke bërë edhe më prezente mundësinë e aplikimit të së njëjtës në drejtime dhe sfera të ndryshme, në

---

<sup>36</sup> Lindita Aliu Tahiri. Bazat e komunikimit masiv, Tiranë, 2018, f. 11.

<https://stereotipe.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

mënyrë që të krijohen rrugë të reja për komunikim të denjë dhe të duhur varësisht nga çështja në fjalë.

Deri para pesë e më shumë dekadash komunikimi me publikun ka qenë më i rrallë, më i avashtë dhe me raportim në sfera të pakta. Dhënia e informacioneve ka qenë e fokusuar ekskluzivisht në ngjarjet kryesore të vendit dhe atë të sferave, politike, sociale, ekonomike, arsimore dhe të ngjashme, por gjithnjë me karakter serioz. Me avancimin teknologjik, me shpikjet e reja për lehtësim komunikimi, dhe për informim më të shpejtë dhe të menjëhershëm, ose të quajtur ndryshe në ditët e sotme “informim në kohë reale”, komunikimi me opinionin dhe komunikimi i lajmit, është lehtësuar dukshëm, sa që është e pamundur të fshihet edhe një incident minimal. Shkak për shpërndarje të menjëhershme të një lajmi, janë portalet e ndryshme, duke mos përfshirë edhe vetë përdoruesit e rrjeteve sociale me llogari personale, për të cilat nuk ekziston një lloj kufizimi ose restriksioni për sa i përket kumtimit të lajmit dhe mbi të gjitha - besueshmërisë së tij.

Në bazë të eksperiencës sime, ky zhvillim dhe kjo liri mediatike e rrjeteve sociale, jo gjithnjë rezultojnë të jetë lajm i saktë, jo gjithnjë ka të bëjë me anën e të vërtetës së një ngjarjeje, jo gjithnjë është e bazuar në fakte dhe dëshmi dhe për të njëjtën jo gjithnjë duhen besuar dhe jo gjithnjë ka qëllim vetëm dhe vetëm informimin, sepse tashmë hyjnë në funksion edhe përfitimet ekonomike nga klikimet ose pëlqimet. Por, si çdo proces, edhe zhvillimi mediatik ka përparësitë e veta, kështu duke qenë më afër opinionit përmes mundësive të kyçjes së auditorit në debate, kyçjen në biseda me mysafirët e ftuar përmes pyetjeve të hapura në rrjetet sociale, duke i bërë pjesë të emisioneve përmes pranisë në studio si publik, etj.

Opinionit publik dhe qëndrimi i tyre nuk mund të vërehen drejtpërdrejt ose të përcaktohen saktësisht mjaftueshëm për të lejuar një matje të paqartë. Qëndrimet janë baza themelore ose grupe mendore ndaj ndonjë objekti që zakonisht matet në drejtim të përgjigjeve verbale ndaj deklaratave vlerësuese. Një opinion është një deklaratë preferenciale për njërin anë të një argumenti ose zgjedhjeje të paraqitur. E njëjta është po aq njohëse sa vlerësuese. Posedon një karakter specifik dhe të përkohshëm dhe një person mund të ketë shumë mendime për tema të ndryshme, pa ndonjë kohezion të nevojshëm. Opinionet ndryshojnë në forcën në të cilën ata mbahen dhe në shkallën në të cilën bazohen

në informacione të sakta.<sup>37</sup> Opinionet janë gjithashtu individuale, megjithëse ato mund të grumbullohen për të formuar diçka që quhet opinion publik, i cili zakonisht merret për të nënkuptuar mbizotërimin ose shumën e pikëpamjeve të popullatës në tërësi.<sup>38</sup>

Komunikimi i suksesshëm me publikun kërkon strategji të suksesshme dhe planifikim, në mënyrë që të ketë efektin e synuar. Fusha e komunikimit të publikut në radhë të parë duhet të mbledhë informacion që i shërben si burim për planifikimin e komunikimit.

Planifikimi i komunikimit me publikun duhet të ketë parasysh synimet, të vlerësojë rreziqet dhe përfitimet, si dhe të parashohë alternativat në rast dështimi. Në qoftë se identifikohen objektivat me tregues të matshëm dhe të vëzhgueshëm, planifikimi i komunikimit e përcakton vetë komunikimin dhe teknikën se si do të realizohet ky komunikim me publikun, për shembull përmes broshurave, lajmërimeve, posterëve, bllogjeve, fjalimeve, performancave, e të tjera. Gjithsesi faza e fundit e marrëdhënieve me publikun është vlerësimi i programit dhe matja e ndikimit të fushatës tek audienca.<sup>39</sup>

Me fjalë tjera, mund të nënkuptojmë që komunikimi me publikun sa duket i thjeshtë aq është kompleks, për vetë faktin e impenjimit dhe përgjegjësisë që kërkohet për të pasur sukses drejt përmbushjes së objektivave dhe qëllimit të caktuar paraprak, pavarësisht nga mënyra e komunikimit ose kumtimit të lajmit.

Sot shumica e popullatës komunikon me bashkëqytetarët përmes medias, të cilat sigurojnë njëfarë afërsie sidomos në vendet e mëdha dhe teknologjikisht të avancuara ku njerëzit kanë më pak mundësi të njihen drejtpërsëdrejti. Në nivel personal, media mundëson një afirim me qeniet e tjera dhe një solidaritet, por mund të nxisë edhe zemërim, frikë, stres dhe izolim nga bota e jashtme, varësisht nga informatat apo dezinformatat që i ofron. Përmes informimit të drejtë dhe sa më gjithëpërfshirës, mediat kanë vend qendror për zbatimin e demokracisë. Është esenciale që popullata të ketë informacione në mënyrë që të bëjë zgjedhjet e caktuara politike dhe të marrë pjesë në jetën qytetare.

---

<sup>37</sup> Denis McQuail, *McQuail's Mass Communication Theory* (6th edition), WashingtonDC, 2006, 429. <https://www.amazon.com/McQuail%E2%80%B2s-Communication-Theory-Denis-McQuail/dp/1849202923>

<sup>38</sup> Po aty, f. 430.

<sup>39</sup> Lindita Aliu Tahiri. *Bazat e komunikimit masiv*, Tiranë, 2018, f. 46-47. <https://stereotype.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

Pjesëmarrja publike e qytetarëve e krijon sferën publike, e cila funksionon më efektshëm në shoqëritë ku është e pavarur nga shteti dhe nga forcat ekonomike të shoqërisë, dhe njëkohësisht kanë të drejtën e tyre për të krijuar opinionet e tyre në lidhje me çështjet konkrete.<sup>40</sup> Pra, hartimi i një fushëveprimi të suksesshëm të komunikimit me publikun, ndikon pozitivisht te opinionit në mënyrë që informacioni ose lajmi të ketë bazament vërtetësie që audienca të jetë në gjendje për të sjellë vendime të duhura krahas bindjeve të tyre të cilësdo fushë.

#### 1.4. Informimi i drejtë dhe plasimi i lajmit

Tiparet më të përgjithshme të shtypit, të gazetarisë në tërësi, janë të lidhura ngushtë me funksionet dhe detyrat. Kështu do të doja të vijoj me përkufizimin e lajmit si nocion dhe strukturën kyçe në raportim në shtyp, radio dhe televizion.

Lajmi në gazetari është një njoftim për ngjarje të rëndësishme të ditës, përcjellë e transmetuar nga masmedia e shkruar apo ajo elektronike: gazetatat, revistat, agjencitë telegrafike, radioja dhe televizioni. Lajmi është përmbajtja e faktit, ngjarje apo dukuri qoftë ajo çka i kumtohet lexuesit, dëgjuesit apo teleshikuesit. Të tjera përkufizime:

- Lajmi është gjithçka që i intereson një pjese të madhe të komunitetit dhe, që deri në atë kohë, nuk ka pas rastin të bëhet publike.
- Lajmi është informacioni për një devijim nga rrjedha e zakonshme e ngjarjes, një ndërprerje nga diçka që pritej.
- Lajmi është informacioni që u duhet njerëzve për të marrë vendime të rëndësishme për jetën.<sup>41</sup>

Pa u thelluar në analizë detajore të përkufizimeve të lartëcituarat, mund të kuptojmë që në secilin prej tyre ka udhëzime specifike, që çon deri në formulimin e një lajmi të duhur me të

---

<sup>40</sup> Lindita Aliu Tahiri. Bazat e komunikimit masiv, Tiranë, 2018, f. 42.

<https://stereotype.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

<sup>41</sup> Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja. Gazetaria 1, Shtëpia botuese e librit universitar 2003, Shtypshkronja 'Dajti 2000', Tiranë, 2003, f. 82-83.

gjithë përbërësit e nevojshëm. Informimi i drejtë dhe i paanshëm s'ka të bëjë me zbulime shkencore, mjafton të ndiqen fjalë për fjalë rregullat gazetareske dhe do të kemi një rezultat të dëshiruar dhe transparent kundrejt audiencës.

Përbërja e natyrës së informacionit publik përbëhet nga disa veçori, që përmbledhtas mund të renditen si vijon:

1. Njoftim për fakte, ngjarje e dukuri politiko-shoqërore bashkëkohëse; transmetim dijesh për jetën; veprimtari vetëm njëkahëshe përcjellë auditorit; kumtim pa kthim të ndërsjellë.
2. Veprimtari informuese me karakter masiv, drejtuar një opinioni të gjerë shoqëror: lexuesve, dëgjuesve dhe teleshikuesve.
3. Lidhje varësie me faktorë teknikë, me mjetet e komunikimit masiv: gazetë a revistë, radio, televizion, internet, etj.<sup>42</sup>

Paanshmëria është me rëndësi thelbësore gjatë raportimit. Lajmet duhet të bazohen në fakte, të cilat janë të verifikuara, të atribuara dhe të dëshmuara. Për të qenë të paanshëm gjatë plasimit të lajmeve dhe informacioneve, do të thotë që të përjashtohet çdo qasje ose mendim personal gjatë formësimit të tyre, ndërsa publikut t'i lihet të nxjerrë vetë përfundime, pa ia imponuar qëndrimet personale. Gjatë raportimit, gazetarët duhet të tentojnë që t'i hulumtojnë dhe t'i transmetojnë pikëpamjet konfliktuoze, të mos injorojnë asnjë perspektivë apo qëndrim të rëndësishëm, t'i shmangin preferencat personale për ndonjë çështje ose zgjedhjen personale të atyre që i intervistojnë.<sup>43</sup>

Raportimi i lajmit, është etapa përfundimtare e procesit të informimit publik, ku mishërohet tërësia e veprimtarisë gazetareske, redaktoriale deri në publikim; është kumtimi, paraqitja e fakteve dhe ngjarjeve më të rëndësishme të ditës; botimi, transmetimi, përcjellja e të rejave të lexuesit, dëgjuesit ose teleshikuesit. Për të arritur deri te kumtimi i lajmit, që është komunikimi i masmedias me auditorin, informata formësohet duke kaluar fill e rend në

---

<sup>42</sup> Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja. Gazetaria 1, Shtëpia botuese e librit universitar 2003, Shtypshkronja 'Dajti 2000', Tiranë, 2003, f. 80.

<sup>43</sup> Vesna Shopar, Zoran Dimitrovski, Sefer Tahiri, Aleksandra Temenugova, Doracak për interesin publik në gazetari, 2016, f. 30 <http://respublica.edu.mk/attach/priracnik-mediumi-11-03-2016-ALB.pdf>



të gjitha etapat e një procesi krijues profesional. Nuk duhet harruar as edhe për një çast të vetëm që parimi themelor i çdo lajmi në tërë procesin e raportimit është vërtetësia.<sup>44</sup>

Në Raportin për Komisionin mbi Lirinë e Shtypit të vitit 1947, titulluar ‘Shtyp i lirë dhe i përgjegjshëm’, thuhet: ‘Në mënyrë më specifike Komisioni përpiloi pesë standarde vendimtare, të cilat, sipas vlerësimit të tij, janë të nevojshme për një shtyp të lirë dhe të përgjegjshëm. Shtypi duhet të japë pasqyrim të vërtetë, të kuptueshëm të ngjarjeve të ditës, brenda konteksteve në të cilat ata marrin kuptim.’<sup>45</sup>

Paanshmëria, transparenca dhe vërtetësia në informim, janë kodi i një lajmi të mirëfilltë dhe të duhur. Mëvetësia e informacionit publik mishërohet në veti me kërkesa të brendshme, si:

- *Risia* e kumtit që përcjell. Përpara se të ulen të shkruajnë një kronikë a një lajm, gazetarët duhet t’u përgjigjen pyetjeve: çfarë risie do t’i transmetojmë opinionit shoqëror; ç’ide përmban informata që presin; ç’mesazh do t’i përcjellim opinionit?
- *Operativiteti*, shpejtësia në kapjen, përpunimin dhe transmetimin e një fakti, të një dukurie apo një ngjarjeje shoqërore të ditës. Lexuesit, dëgjuesit apo teleshikuesit kërkojnë kumtim të freskët dhe të shpejtë, lajme a kronika jo vetëm të ditës, por edhe të orëve të fundit.
- *Konkretësia*. Shkrimet informative të çfarëdolloji, duhet të jenë kronika, lajme e reportazhe konkrete, me emra, me tipa shoqërorë, me adresa të plota, me shifra e fakte, që njihen në mjedise të caktuara njerëzish.
- *Objektiviteti*. Shoqëria shtron përpara gazetarëve, me domosdoshmëri, kërkesën për pasqyrimin e jetës realisht, me vërtetësi; për informacion shoqërisht të dobishëm. Shtypi objektiv pasqyron me besnikëri fakte, dukuri, ndodhi, që përmbajnë edhe vlerësimin ideor e publicistik të tyre.<sup>46</sup>

---

<sup>44</sup> Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja. Gazetaria 1, Shtëpia botuese e librit univerzitar 2003, Shtypshkronja ‘Dajti2000’, Tiranë, 2003, f. 62.

<sup>45</sup>Hamit Boriç. Gazetaria 2, Shtëpia botuese e librit universitar 2004, Shtypshkronja ‘Dajti 2000’ Tiranë, 2004, f. 117-118.

<sup>46</sup>Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja. Gazetaria 1, Shtëpia botuese e librit universitar 2003, Shtypshkronja ‘Dajti 2000’, Tiranë, 2003, f. 72-73.

Gjatë gjithë procesit të ndjekjes së ngjarjes ose lajmit në teren, gjëja parësore që gazetari duhet të ketë prezent, është pikërisht auditori: Si do ta presë ai shkrimin, do ta pranojë a kundërshtojë. Në rastet kur ka të bëjë me fakte a interpretime kritike, gazetari bën kujdes që çdo fjalë të jetë e motivuar, e argumentuar logjikisht e faktikisht. Reagimi i lexuesit, dëgjuesit ose i teleshikuesit, lidhet me autoritetin e dinjitetin e gazetarit, por edhe të medias, me besueshmërinë e respektin ndaj saj.<sup>47</sup>

Edhe përkundrejt rregullave të shkruara, sugjerimeve dhe ripërsëritjes së herë pas herëshme të kodit gazetaresk, ka raste kur kemi devijim të vërtetësisë së lajmit, me ç'rast rrezikojmë profesionalizmin personal, sepse dimë shumë mirë që veset jo të mira dhe rruga më e shpejtë për të arritur diçka, janë më të lehta për të ngelë pjesë e praktikës sonë. Pastaj vijon dëshpërimi dhe rrezikimi i besueshmërisë së mëtejme të aktorëve të ngjarjes në fjalë, besueshmëria e auditorit të gjerë dhe subjektivizmi i informimit.

Shpesh heshtet për fakte, ngjarje a dukuri që nuk i interesojnë gazetës, drejtuesve, financuesve të saj ose njerëzve që ushtrojnë pushtet mbi të. Këto arsyetime krijojnë bindjen se zgjedhja e fakteve është proces subjektiv. Mund të arrijmë në përfundim se subjektivizmi më shumë se pasojë e botëkuptimeve të ndryshme të gazetarëve është shprehje e trysnive të qarqeve të interesuara për ta pasqyruar realitetin jo ashtu siç rrjedh normalisht, por sipas synimeve e qëllimeve të atyre që kanë në dorë dhe ushtrojnë ndikim mbi median.<sup>48</sup>

Paanshmëria e lajmit është një tjetër faktor i cili duhet të jetë kriter i pandashëm i raportimit apo informimit të saktë dhe të duhur. Shpeshherë është ndjekësi i terrenit (gazetari), ai i cili sjell lajmin e anuar në redaksi për x, y arsye, por fazat vijuese selektuese dhe kontrolluese, në krye me përgjegjësit e tyre, duhet të bëjnë filtrimin, në këtë rast, të japin kahjen e duhur dhe të vërtetë të lajmit. Pjesa redaktoriale ka rol kyç në përgatitjen e lajmit për botim, sepse si rrjedhojë e transmetimit në televizion ose informimit përmes radios ose përmes leximit, do të pasojnë reagimet e auditorit. Dhe vijmë në përfundim që objektiviteti gazetaresk është sinonim i profesionalizmit në gazetari. Objektiviteti gazetaresk mund t'i referohet drejtësisë, mosinteresimit, gjendjes faktike, apartizmit, por shpeshherë i përfshin të gjitha këto cilësi bashkë, por gjithnjë duke i qëndruar besnik vërtetësisë dhe paanshmërisë së lajmit gjatë informimit.

---

<sup>47</sup> Hamit Boriç. Gazetaria 2, Shtëpia botuese e librit universitar 2004, Shtypshkronja 'Dajti 2000' Tiranë, 2004, f. 127.

<sup>48</sup> Po aty, f. 130.

## 2. NDIKIMI I MEDIAVE NË POLITIKBËRJEN NË MAQEDONI

### 2.1. Etika gazetareske dhe liria e mediave

Gazetaria sot po jeton një mutacion të paparë. Puna e gazetarëve është më e shpejtë, i nënshtrohet kufizimeve të shumta dhe është shumë më komplekse. Mediat e lajmeve kanë kuptuar, se revolucioni i informacionit ka rezultuar të jetë një shpatë me dy tehe, përkundër të gjitha virtyeteve të saj çliruese. Është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë mënyra të ndryshme për të parë etikën. Etika gazetareske rezulton nga ambicia e gazetarit për të qenë një profesionist i shkëlqyer. Është bindja-dëgjueshmëria e gazetarit ndaj natyrës së punës së tij. Është pikërisht etika ajo fushë e cila i ndihmon gazetarët të përcaktojnë se çfarë është e drejtë për të bërë në gazetari.

Në teorinë e gjuhës gazetareske tërë tema e etikës përmbledhet në një pyetje të vetme: çfarë qëllimi duhet të synojë të arrijë sjellja e gazetarëve dhe ç'mjete duhen përdorur për ta arritur këtë qëllim? Të merresh me etikën, nuk do të thotë të gjykosh moralitetin e gazetarisë, por të arrish të kuptosh se cili mund të jetë sensi moral i punës së gazetarëve, i përhapjes së lajmeve, i veprimit të mediave në shoqëritë industriale. Është folur shumë për teorinë dhe teknikat e gjuhës gazetareske, është folur për relativitetin e lajmit, janë shqyrtuar aplikimet e shumta dhe aspektet deontologjike.<sup>49</sup> Pra, ngrihet çështja se cili është kuptimi i tërë këtyre aspekteve, me qëllim që të hetohet natyra morale e botës së lajmit, kufijtë e së cilës, me futjen në veprim të mediave të reja, janë zgjeruar aq shumë, duke na dhënë aspekte që tronditin marrëdhëniet midis realitetit dhe lajmit, midis lajmit dhe publikut dhe që ngrejnë pikëpyetje që nuk kanë ekzistuar më parë lidhur me përgjegjësitë shoqërore të gazetarëve.<sup>50</sup>

Ka mënyra të ndryshme për të kuptuar etikën në gazetari, gjithashtu edhe këndvështrime të ndryshme. Nga libri i një autori, në librin e një autori tjetër, nga eksperiencia e një gazetari të tjetri, dhe nga këndvështrimi i një pjese të auditorit të tjetri, mund të hasim në dhjetëra versione të ndryshme për sa i përket saktësisë dhe së duhurës në etikën gazetareske.

---

<sup>49</sup> Alberto Papuzzi. Diskutim për etikën (përmbledhje esesh dhe artikujsh për etikën e gazetarisë së sotme), Instituti shqiptarë i medias, Tiranë, 2007, f. 71.

<sup>50</sup> Po aty, f. 71.

Profesori universitar në Universitetin e Nevarras, Luka Brajnoviç, etikën e parasheh si një bashkësi të normave objektive, të vlefshme për të gjithë që ushtrojnë këtë profesion.

Duke pasur parasysh natyrën e paqëndrueshme të tregut të punës dhe kushtet e punës së gazetarëve, etika nuk renditet si përparësi në agjendën e medias, respektivisht nga vetë gazetarët<sup>51</sup>, ndaj shpesh herë ka nga ata që e zvogëlojnë etikën në norma dhe parime, dhe kërkojnë që me etikë të zgjidhen problemet praktike dhe të momentit. Kështu duke hamendësuar: a mund të përdor kamera të fshehur? A mund të pranoj ftesa për inaugurime nga kompani të ndryshme lidhur me kontaktet e vendit të punës? A duhet të fsheh të vërtetën në ndonjë rast? Këto janë pyetje që presin një përgjigje ose formulë për të vepruar. Kjo është ideja më e përhapur te lloji i gazetarëve të lartpërmendur, në lidhje me veprimet e tyre.<sup>52</sup>

Nga ana tjetër etika pret formulimin e një qëndrimi, pra të qenit etik është një mënyrë e jetës. Ky vizion i etikës shkon përtej rregullit të vendosur, gjegjësisht është zbulimi i vetes dhe se si të jetosh si person dhe si profesionist i përmirësuar dhe i denjë për punën dhe jetën.

Etika është rregull e sjelljes ose rregull e principeve të moralit, që drejtojnë veprimet tona në situatat e dhëna. Fjala etikë ka prejardhjen nga greqishtja *ethos*, që nënkupton zakonet, traditat, ose një karakter që drejton një kulturë ose grup të caktuar. Në rastin tonë, në mënyrë specifike etika i referohet aplikimit të mendimit racional nga ana e mediave profesionale, kur ata janë duke vendosur mes dy ose më shumë zgjidhjeve morale kompetitive. Aplikimi i etikës mediatike ka të bëjë me gjetjen e përgjigjes më të mbrojtur moralisht ndaj një problemi, për të cilin nuk ka përmirësim, por nuk ka edhe përgjigje më të mirë.<sup>53</sup>

Disa njerëz mendojnë se gjykimet etike dhe morale kanë dy mundësi: të drejta ose të gabuara. Në të vërtetë, ekziston një gamë e tërë zgjedhjesh etike. Filozofi bashkëkohor Bernard Gert ka përshkruar katër kategori të zgjedhjeve etike: ato që janë etikisht të ndaluara, ato që kërkohen etikisht, ato që janë etikisht ideale dhe ato që lejohen etikisht.

---

<sup>51</sup> Media dhe shoqëria e informacionit në Shqipëri, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë, f. 40.

<sup>52</sup> Po aty, f. 42.

<sup>53</sup> Stanley J. Baran. Introduction to mass communication, Mayfield Publishing Company, Toronto, Update 2001, f. 390.

- *Veprimet e ndaluara etikisht* janë ato që janë të gabuara. Këto janë veprime që shkaktojnë dëm të pajustificueshëm ose që përfshijnë neglizhencën e pajustificuar të një personi mbi përgjegjësitë e tij/saj lidhur me rolin.<sup>54</sup>
- *Veprimet e kërkuara etike* janë ato që pasojnë drejtpërdrejt nga përgjegjësitë që lidhen me rolin e një personi. Kjo kategori është inverse e veprimeve në kategorinë e ndaluar: etikisht kërkohet që të mos shkaktohet dëm i pajustificuar.
- *Veprimet etike ideale* ndodhin kur një person gjen veten lidhur me përgjegjësitë e tij ose të saj, shmang shkaktimin e dëmit të pajustificuar, dhe gjithashtu vepron në një mënyrë që promovon të mirën dhe që parandalon, zbut, ose adreson dëmet që janë shkaktuar.
- *Veprimet e lejuara etike* janë ato që shkojnë në vazhdimësi midis atyre që kërkohen dhe atyre që janë ideale. Një shumëllojshmëri veprimesh alternative që mund të lejohen etikisht.<sup>55</sup>

Etikës gazetareske s’do mend që i bashkëngjitet edhe liria e medias, sferë kjo e cila në fillim të dekadës së fundit ka pas rënie, shkruajnë raportet për çështjen e lirisë së medias, por edhe në vitet e fundit vazhdojmë rrugën e njëjtë, por me tempo më të shpejtë. Raportet e ndryshme të organizatave botërore dhe vendase, bëjnë të ditur ngulfatjen që mediat hasin në raportim të lirë dhe pa ndërhyrje nga ana e aktorëve qeverisës politik.

Sipas UNESCO-s “Liria e mediave ka fuqinë për të shndërruar shoqëritë. Media e lirë i shndërron shoqëritë pasi ato ofrojnë informacione që ndriçojnë procesin e vendimmarrjes. Kështu, individëve u jepet fuqia që të vendosin për fatet e tyre. Në një kontekst të tillë, liria e mediave luan një rol vendimtar në transformimin e shoqërisë duke ristrukturuar aspektet e saj politike, ekonomike dhe sociale. Kjo është arsyeja pse UNESCO promovon lirinë, si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara me një mandat për të mbrojtur dhe promovuar lirinë e shprehjes, si dhe lirinë e saj përfundimtare, të shtypit. Në këtë mënyrë, liria e mediave shumëfishon zërat. Ndërkohë që rritet liria, thirrjet individuale energjike

---

<sup>54</sup> Deni Elliott. Ethical Challenges: Building an Ethics Toolkit, First published by AuthorHouse, Bloomington, 2009, f. 27 [https://www.academia.edu/35600873/Ethical\\_Challenges\\_PDF.pdf](https://www.academia.edu/35600873/Ethical_Challenges_PDF.pdf)

<sup>55</sup> Po aty, f. 27 [https://www.academia.edu/35600873/Ethical\\_Challenges\\_PDF.pdf](https://www.academia.edu/35600873/Ethical_Challenges_PDF.pdf)

mblidhen dhe bëjnë thirrje për transformim shoqëror dhe ndryshime pozitive politike, kështu duke u bërë një forcë e pandalshme”.<sup>56</sup>

Është pikërisht pavarësia e mediave dhe thënia e mendimit të lirë, që frikëson pushtetarët, sepse ende nuk jemi në atë nivel të kulturës dhe profesionalizmit, që të pranojmë hapur mendimet, idetë, kritikën, por jo edhe mospëlqimet, gjatë një qeverisjeje. Janë kritikën ato që na risin dhe na përmirësojnë, gjithnjë duke i pranuar me gatishmëri për mirëqenie të përbashkët dhe trajtim të barabartë. Kërkojmë të drejtpërdrejtën, por nuk kemi guxim të përballemi me të. Kërkojmë të jemi dikush, ama pa qenë fillimisht askush. Këto janë vetëm disa nga “epidemitë” e vetpëlqyeshmërisë, që na karakterizon si popullsi dhe që na bren si qytetarë të këtij vendi. Pikërisht jo modestia, i çon ata, pushtetarët, të mendojnë manovra nga më të ndryshmet që situatës jo të mirë, t’i veshin petkun e mashtrimit, si pasojë e veprimeve të tyre të pahijshme. Ja pse s’duam liri të mediave.

Fatkeqësisht, liria e mediave edhe në statistikat e *Freedom House*, për vendin tonë, nuk janë aspak të lakmueshme. *Freedom House* është një organizatë e pavarur mbikëqyrëse e përkushtuar, për zgjerimin e lirisë dhe demokracisë në të gjithë botën. Analizojnë sfidat ndaj lirisë, avokojnë për të drejta më të mëdha politike dhe liri civile, dhe mbështesin aktivistët parësorë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të promovuar ndryshimin demokratik. Kjo organizatë është themeluar në vitin 1941, dhe është organizata e parë amerikane që mbron përparimin e lirisë në nivel global.

Nga e njëjta pohojnë: “Pranojmë se liria është e mundur vetëm në mjediset politike demokratike ku qeveritë janë përgjegjëse ndaj popullit të tyre; mbizotëron sundimi i ligjit; dhe liritë e shprehjes, shoqatës dhe besimit, si dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve dhe grave, janë të garantuara. Më shumë se një e treta e popullsisë së globit, gjegjësisht më shumë se 2.5 miliardë njerëz jetojnë në vendet që *Freedom House* i përcakton si "Jo të lira".<sup>57</sup>

Raporti i publikuar i lirisë së mediave, i vitit 2017, përfshin (Freedom of the press 2017) një pjesë bukur të mirë të hartës botërore, duke filluar nga Lindja e Mesme dhe Afrika

---

<sup>56</sup> <http://www.unesco.org/new/es/unesco/events/prizes-and-celebrations/celebrations/international-days/world-press-freedom-day/previous-celebrations/2012/2012-themes/media-freedom-has-the-power-to-transform-societies/>

<sup>57</sup> <https://freedomhouse.org/about-us> - Organizatë e pavarur mbikëqyrëse e përkushtuar, për zgjerimin e lirisë dhe demokracisë në të gjithë botën.

Veriore, Azia, Pacifiku, Euroazia, Sub-Saharana, Afrika, Amerika dhe Evropa. Ata e titullojnë kështu raportin për Evropën: *‘‘Politikanët gërryen respektin për shtypin e lirë’’*.<sup>58</sup>

Marrë shkas nga paragrafi më lartë, mendoj që janë influencat dhe fuqia politike ato që po arrijnë të lëvizin themelet e fisnikërisë në gazetari, është ndoshta edhe pangopësia e gazetarit që e shtyn atë të merr vendime jo të mira, si shtrembërimi i lajmit ose kahëzimi i rrejshëm i një situatë. Nëse për pak minuta zhvendosim vëmendjen te rezultatet e mediave të huaja dhe kapaciteti i tyre për menaxhim në mënyrë të pavarur financiarisht ose të paktën pjesërisht të pavarur, mund të shohim faktorin e diskapacitetit vetpërmbajtësorë të kanaleve televizive të ne. Ndërsa sikur ne të gëzonim një situatë favorizuese financiare mediatike, atëherë mendoj që ndoshta edhe mund të kishim një gazetari më pak të varur politikisht, raportet do të ishin stimuluese dhe motivuese.

Zyrtarët qeveritarë dhe politikanët në vendet në të gjithë Evropën, shfaqën nivele të ndryshme të përbuzjes ndaj mediave në vitin 2016, duke inkurajuar perceptimin e gazetarëve kritikë si armiq politikë dhe duke hapur derën e ngacmimeve më të gjera. Udhëheqësit politikë në vendet e Ballkanit Perëndimor, bënë presion më të madh në median e pavarur, nxitur nga angazhimi i BE-së për zbatimin e standardeve demokratike midis vendeve anëtare që aspirojnë. Në Maqedoni, partia qeverisëse kishte kontroll të konsiderueshëm mbi ciklin e lajmeve përmes transmetuesit publik dhe degëve private miqësore, dhe raportuesit rrezikuan sulme, ndërsa mbulonin protestat antiqeveritare, përfshirë këtu edhe nga policia.<sup>59</sup>

Edhe përkundër rezultateve aspak të kënaqshme në lidhje me lirinë e të shprehurit në vend, gjegjësisht kontrollimin e të njëjtës nga garniturat në pushtet, unë si gazetarë, e di dhe e shoh që kam miq dhe kolegë të cilët janë pro të drejtës, të vërtetës, janë me dëshirë dhe zemër për të qenë ku është lajmi. Për të konkretizuar, dua të përmend katër periudha konkrete dhe gjurmë lënëse, për raportimin e të cilëve kam parë nga afër palodhshmërinë, guximin dhe gatishmërinë e kolegëve të mi, dhe pikërisht gjatë leximit dhe citimit të këtij paragrafi, vazhdimisht më vinin në mendje rastet si:

- Raportimi për refugjatët në kampe në Tabanoc dhe kufirin me Greqinë në 2015
- Vërshimet në Shkup në korrik të 2016

<sup>58</sup> <https://freedomhouse.org/about-us>

<sup>59</sup> Michael J. Abramowitz. Freedom House, The freedom of the press, 2017, f. 22.  
<file:///C:/Users/ai10999/Downloads/FREEDOMof%20the%20press%202017%20-%20raport%20from%20freedom%20house.pdf>

- Revolucioni laraman në periudhë disamujore gjithashtu në 2016
- Rasti i 27 prillit të vitit 2017 me hapjen e dyerve të Kuvendit.

Raportit për lirinë e shtypit *Freedom of the Press* 2016 për Maqedoninë:

“Në prill të 2016, disa gazetarë u sulmuan fizikisht nga policia ndërsa raportuan për protesta kundër amnistisë së politikanëve të akuzuar nga materialet e programit të përgjimeve në shkallë të gjerë dhe të paligjshme.

Në prill, Zoran Bozhinovski, i cili ishte zhvendosur në Serbi për shkak të shqetësimeve për sigurinë pas publikimit të artikujve kritikë për partinë qeverisëse, u ekstradua në Maqedoni me akuzën e spiunazhit dhe zhatjes, në një rast që Instituti Maqedonas për Media dhe të tjerët, e përshkroi si një vendndodhje politike. Ai mbeti në paraburgim në fund të vitit.

Një Komision i përkohshëm i krijuar brenda rregullatorit të mediave ishte ngarkuar me monitorimin e mbulimit të mediave për zgjedhjet e dhjetorit. E përbërë kryesisht nga anëtarët e emëruar nga partitë politike, i njëjti komision nuk zgjodhi asnjë çështje në lidhje me pavarësinë e rregullatorit.

Një stacion i ri televiziv kombëtar, TV Nova, filloi në shkurt. Mbulimi i saj favorizoi partinë në pushtet dhe ndihmoi për të forcuar pozicionin mbizotërues të mediave pro qeveritare në tregun e mediave.<sup>60</sup>

Nga ky raport i 2017 kuptohet qartë influenca politike në mediat në vend, me theks të veçantë në periudhën parazgjedhore, gjë që solli leverdi për të interesuarit, por ky veprim hodhi edhe një hap drejt mosbesimit të qytetarit në raportimet mediatike.

Në një shkrim tjetër nga gazetarja e K2.0, organizatë mediatike e pavarur, Ivana Kostovska, e diplomuar në “Mbretëritë e Bashkuara dhe me profil të pasur mediatik, duke përfshirë eksperiencën në BBC, s’i ka ikur prononcimi kritik lidhur me lirinë e mediave në periudhën e rastit të 27 prillit, ajo shkruan: “Në katër vitet e fundit, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (ShGM) numëron rreth 50 raste në të cilat gazetarët vendorë kanë pësuar, si rezultat i shkeljeve të të drejtave të tyre, me sulme fizike dhe verbale, apo nëpërmjet mohimit të së drejtës për të raportuar. Kryetari i kësaj shoqate, Naser Selmani, thekson se vetëm 10

<sup>60</sup> Michael J. Abramowitz. Freedom House, The freedom of the press, 2017.  
<https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2017/macedonia>



raste kanë rezultuar me procedura në gjykatë. “Zgjidhja e rasteve të cilat përfshijnë sulme ndaj gazetarëve, do të ishte mënyrë për ta matur gatishmërinë e qeverisë për të shtyrë para reforma për media”, thekson Selmani. Ai shton gjithashtu: “Mediat janë më të relaksuara se në kohën kur ishin nën presionin e qeverisë së Gruevskit”. Por sulmet dhe shqetësimet që i përjetojnë gazetarët janë vetëm një pjesë e mozaikut të madh që ilustron sfidat që e pengojnë lirinë e mediave në Maqedoni” thekson ndër të tjera Kostovska.<sup>61</sup>

Për të ilustruar më qartë këtë konkluzë analitike të Kostovskës, më bien në mend 2 raste të sulmeve të gazetarëve: 1 marsi i 2017 kur u sulmua ekipi e portalit AION, gjegjësisht gazetari Aleksandar Todevski dhe kameramani Vladimir Zhelçevski, nga pjesëtarë të protestës “Për Maqedoni të përbashkët” të organizuar me iniciativë të qytetarëve. Ndërsa rasti tjetër i sulmit ndaj gazetarëve ndodhi në 27 prill të 2017, me hapjen e deryve të parlamentit ku mbetën të lënduar dhe gjendje të rëndë si gazetarë ashtu edhe politikan opozitarë.

Sulmi kundrejt gazetarëve, në një shtet demokratik, llogaritet sulm direkt ndaj vetë demokracisë së atij vendi. Përveç sulmeve fizike, kemi edhe sulmet verbale dhe psikologjike përmes rrjeteve sociale ose mesazheve në telefon. Më të freskët kemi rastin e sulmit të të punësuarit në Regjistrin Qendrorë, Emil Jakimovskit, kundrejt gazetarëve Meri Jordanovska dhe Iskra Koroveshovska, sulm i cili arriti deri në padi dhe si pasojë Jakimovskit i kushtoi vendi i punës.

## 2.2. Mediatizimi i politikës

Mediatizimi politik është forma e komunikimit që lehtëson prodhimin, shpërndarjen dhe shkëmbimin e përmbajtjes politike në platforma dhe brenda rrjeteve që strehojnë ndërveprimin dhe bashkëpunimin. Ato kanë evoluar me shpejtësi gjatë tre dekadave të kaluara, dhe vazhdojnë të zhvillohen, ndonjëherë janë edhe të paparashikuara. Media e re ka implikime të gjëra për qeverisjen demokratike dhe praktikën politike. Ata kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrat me të cilat funksionojnë institucionet qeveritare dhe se si komunikojnë

---

<sup>61</sup>Ivana Kostovska, Shkrim: ‘Shpresa për lirinë e mediave në RM’, Kosovo 2.0, 2017.  
<https://kosovotwopointzero.com/hopes-media-freedoms-macedonia/>

liderët politikë. Ata kanë transformuar sistemin e mediave politike dhe ripërcaktuan rolin e gazetarëve.

Media e re politike, ka ripërcaktuar mënyrën e kontestimit të zgjedhjeve dhe mënyrën se si qytetarët përfshihen në politikë. Krijta e mediave të reja ka komplikuar sistemin e mediave politike. Media e trashëgimisë që përbëhet nga institucione të krijuara të mediave masive që paracaktjnë internetin, të tilla si gazeta, emisione, radio dhe programe lajmesh televizive, bashkëjetojnë me mediat e reja që janë rezultati i inovacionit teknologjik. Ndërsa mediat e trashëgimisë mbajnë formate relativisht të qëndrueshme, mjetet e mediave të reja, të cilat përfshijnë faqet e internetit, bllogjet, platformat e shpërndarjes së videove, aplikacionet digjitale dhe ato sociale, po zgjerohen vazhdimisht në mënyra inovative.<sup>62</sup>

Kjo ka krijuar varshmëri dhe fasilitet në të njëjtën kohë, si për individët personalisht, ashtu edhe në biznese, por duke përfshirë këtu edhe politikën. Dimë që sot çdo lëvizje, çdo llogaridhënie parazgjedhore dhe vizitë e funksionarëve në qytete e fshatra, postohet dhe informohet pikërisht përmes rrjeteve sociale.

Media e re u shfaq në fund të viteve 1980 kur platformat argëtuese, si radio bisedat, shfaqjet televizive dhe gazetatat tabloid, morën role të spikatura politike dhe i dhanë zhanër infotainment. Infotainment errëson linjat midis lajmeve dhe argëtimit dhe privilegjet e tregimeve të bujshme, të drejtuara nga skandali, mbi lajmet e vështira. Politikanët iu drejtuan mediave të reja për të anashkaluar kontrollin e shtypit kryesor mbi agjendën e lajmeve. Theksi i informimit i mediave të reja në këtë fazë të hershme, u ofroi liderëve politikë dhe kandidatëve, një vend miqësor për t'u paraqitur para publikut, sesa të paraqiten para mediave të “vështira”.<sup>63</sup>

Sikur të mos kishte devijuar dhe çorientuar qëllimi primar i hyrjes në sistem i mediave të reja të viteve të '80-ta, sot përdorimi i rrjeteve sociale dhe i masmedias, do të ishte në nivel

---

<sup>62</sup> Natalie Jomini Stroud. *Niche News: The Politics of News Choice*, Issue 2, Oxford University Press, New York, 2011, f. 121 *Published in print:2011 Published Online: September 2011 ISBN: 9780199755509*.

<https://www.universitypressscholarship.com/search?isQuickSearch=true&pageSize=20&q=Natalie+Jomini+Stroud.++The+Politics+of+News+Choice%2C+Issue+2&sort=relevance>

<sup>63</sup> Diana Owen. *The new media's role in politics*, OpenMind Project, f. 3.

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/03/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-New-Medias-Role-in-Politics.pdf>

tjetër, do t'i shpërbente në mënyrë adekuate politikës dhe mirëqenies së qytetarit, me informim korrekt dhe pa influenca për përfitime në besueshmëri dhe reklamim pa pagesë të kampanjave zgjedhore.

Duke pasur parasysh rritjen e jashtëzakonshme të mediave sociale, në veçanti Twitter dhe Facebook, mediat sociale përdoren gjithnjë e më shumë në kontekstin politik, kohët e fundit si nga qytetarët ashtu edhe nga institucionet politike p.sh., politikanë, parti politike, fondacione politike, qendra të mendimit, etj. Nga këndvështrimi i institucioneve politike, është e rëndësishme të marrësh pjesë aktive në komunikimin politik, bazuar në përdorimin e mediave sociale, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Në këtë mënyrë, media sociale përfaqëson mjetin ideal dhe bazën e informacionit për të vlerësuar opinionin publik mbi politikën dhe pozicionet politike, si dhe për të ndërtuar mbështetjen e komunitetit për kandidatët që kandidojnë për zyra publike.<sup>64</sup>

Një tjetër term i cili del në pah me përparimin mediatic dhe ndikimin e të njëjtave në politikë dhe proceset politike, është '*Watchdog Press or Politicians' Mouthpiece*', thënë shqip, Shtypi mbikëqyrës ose qeni roje (mbikëqyrës) i politikës.

Sipas Diana Owen, profesoreshës së Shkencave politike, pranë Universitetit Georgetown, nocioni i shtypit qeni roje ose mbikëqyrës politik, i jep medias një rol mbrojtës të interesit publik. Shtypi 'qeni roje', siguron një kontroll mbi abuzimet e qeverisë duke furnizuar qytetarët me informacion dhe duke detyruar transparencën e qeverisë. Mbështetja publike për rolin e vëzhguesit të mediave është thelbësore, me një studim të Qendrës Pew Research, që zbulon se 70% e amerikanëve besojnë se raportimi i shtypit mund të "parandalojë udhëheqësit të bëjnë gjëra që nuk duhet të bëhen".<sup>65</sup>

*Watching Dog Press* është shprehje konkrete për kontrollin mbi median dhe për mosdevijimin e të njëjtave në qëllimin dhe misionin e tyre. Por para së gjithash detyrë e shenjtë e gazetarisë së qenit roje, është pengimi me çdo kusht i përlyerjes së informimit

---

<sup>64</sup> Daniel Dajun Zeng, *Social Media Analytics and Intelligence*, 2010.

Framework: <file:///C:/Users/Mirjeta/Downloads/SNAMAuszug.pdf>

<sup>65</sup> Diana Owen. *The new media's role in politics*, OpenMind Project, f. 10

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/03/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-New-Medias-Role-in-Politics.pdf>

korrekt me ndikimin, dhe fuqinë e pushtetarëve që mund të arrijnë përmes ofertave joshëse për pronarët mediatik, ose mundësimin e fasiliteve kontinuale gjatë qeverisjes së tyre.

Mediat e reja kanë rritur aftësinë e reporterëve për të përmbushur rolin e tyre mbikëqyrës, madje edhe në një epokë të zvogëlimit të burimeve për gazetarinë hetuese. Informacioni mund të shpërndahet me lehtësi përmes burimeve zyrtare të mediave, pasi vendet e lajmeve lokale mund t'u kalojnë informacione rreth ngjarjeve të prishura tek organizatat kombëtare. Lajmet gjithashtu mund të dokumentohen dhe shpërndahen nga qytetarët përmes rrjeteve sociale. Kur një uragan i egër i kategorisë 5, shkatërroi Porto Rikon dhe përgjigjja e qeverisë amerikane ishte e ngadaltë, gazetarët ngelën jashtë mundësive për informim dhe banorët ishin të parët që informuan nga mediat sociale për të siguruar lajme të dorës së parë për gazetarët kombëtarë që kishin vështirësi të arrinin në ishull,<sup>66</sup> është ky vetëm një shembull se sa me rëndësi dhe kapshmëri janë bërë mediat online.

Si përfundim mediatizimi ka zgjeruar rolet tradicionale të shtypit në një shoqëri demokratike. Ka rritur dukshëm mundësinë e informacionit politik, për të arritur madje deri te qytetarët më të interesuar. Mundësimi i krijimit të hapësirave digjitale publike, ku opinionet mund të ndahen hapur me anë të komentimeve, ka bërë që qytetari të jetë më afër politikës dhe proceseve të saj. Gjithashtu janë krijuar rrugë të reja për angazhimin, që lejojnë publikun të lidhet me mënyra të reja me qeverinë, dhe të kontribuojë në rrjedhën e informacionit politik.

### 2.3. Qasja e mediave vendase ndaj politikbërjes

Nëse flasim për të duhurën në gazetari, për të vërtetën dhe transparencën, gjërat janë të thjeshta. Por nga përvojat jetësore që kemi në vend, si unë, bashkë me gjithë qytetarët e RMV, dimë që jo gjithnjë mund të llogarisim në raportim efikas, të paktën sa i përket formulimit të lajmit me vërtetësi nga koka deri në përfundimi.

---

<sup>66</sup> Diana Owen. The new media's role in politics, OpenMind Project, f. 11.

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/03/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-New-Medias-Role-in-Politics.pdf>

Pothuajse gjithnjë, gazetari është përgjegjës për kahëzimin e lajmit. Pse? Sepse ai/ajo është në teren dhe ndjek ngjarjen, press konferencën, ecurinë e një procesi, etj., prandaj varësisht nga lloji i gazetarit që kemi në teren, ashtu do të kemi edhe kahëzimin.

Dejvid Bruer, gazetar dhe redaktor për shumë vite i temave politike në BBC, konsultant në CNN dhe në Al Xhezira, në bazë të përvojës definon shtatë tipe karakteristike të gazetarëve, të cilët i hasim edhe te ne:

- *Gjahtari*: Pa u lodhur i përcjell politikanët. Ky gazetar asnjëherë nuk dorëzohet. Ai ka fuqi udhëheqëse, por gjahtarit shpesh mund t'i mungojë objektiviteti dhe këndvështrimi i gjerë. Kontributi i tij për qartësimin e të kuptuarit nga ana e publikut është në pikëpyetje.
- *Aktivisti*: I përkushtuar në kauzën e tij. Për të është vështirë që të gjendet baraspeshë, Nuk arrin ta vlerësojë perspektivën e ndryshme dhe të ofrojë balanc. Shpesh rrezikon që ai të shndërrohet në storje, në vend që ta udhëheqë atë dhe ta mbulojë.
- *Miku*: Bëhet i afërt me politikanët dhe rrallë herë e sjell pozicionin e tyre në pikëpyetje. Shpesh këmbëngul se politikanin ka të drejtë, pa marrë parasysh faktet që flasin për të kundërtën. Do t'i bëjë shërbim politikanit, por do të ketë kufij – zakonisht kur të shohë se mund të zbulohet. Ky gazetar gjithmonë është i gatshëm ta shtrijë dorën, nëse vlerëson se mbulimi i rrëfimit mund të jetë i favorshëm për të dhe për politikanin. Gazetari mik lëviz si fryn era dhe është i lehtë për manipulim.<sup>67</sup>
- *I poseduari*: Ai është “pronë” e politikanit dhe varet nga ai për shkak të kompromiseve të bëra më parë, apo afërsisë së tepruar. Integritetin e vet gazetaresk me siguri e ka humbur në zhvillimin e hershëm. Mund të pritët prej tij që të publikojë çfarëdo qoftë sipas dëshirës së politikanit, pa bërë pyetje. Ai kënaqet duke u lavdëruar me emrat e personave të njohur dhe afërsinë me personat me ndikim.
- *Anëtari i partisë*: Bën gjithçka që ta fshehë anëtarësinë e vet, por megjithatë e tregon atë me tonin e tij, përzgjedhjen e temave dhe aftësinë (ose paaftësinë) e tij në parashtrimin e pyetjeve hulumtuese. Ky gazetar do të shpenzojë shumë kohë në nxirjen e qëndrimeve politike të atyre me të cilët nuk pajtohet. Zakonisht do ta njihni sipas entuziazmit për të imponuar një rrëfim.

---

<sup>67</sup> OJQ Civil, ShGM, Doracak Gazetaresk, 2011, f. 38-39.

<https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/Journalist-Manual-inside-AL-4web.pdf>

- *Komodi*: Unë do ta ruaj shpinën ty, ti mua. Përse të zihemi kur që të dy mund të jetojmë rehat dhe leverdishëm. Kush do ta dijë? Ky gazetar e shikon punën e vet si ekzistencë dhe detyrim vetëm gjatë orarit të punës, nga ora 9 deri në orën 5. Zakonisht kënaqet me verë dhe ushqim të mirë. Në dispozicion është për të gjitha partitë për të hapur “afere” dhe këtë e shikon si qëndrim të vetin korrekt, të paanshëm dhe të pavarur.
- *Gazetari i vërtetë*: I lirë nga lidhjet partiake. Ka integritet dhe nuk mund të blihet. Ka pasion profesional, e kërkon të vërtetën, raporton në mënyrë të drejtë dhe korrekte dhe paraqet më shumë opinione, madje edhe kur të njëjtat mund ta dobësojnë konceptin e rrëfimit. Është i gatshëm të hulumtojë gjithçka që e ka për zemër. Askënd nuk e shikon jashtë kufijve të qëndrimit kritik. Ai është i realtë kur është fjala për natyrën e njeriut. Gazetari i vërtetë e kërkon të vërtetën.<sup>68</sup>

Bota televizive di të jetë edhe mashtruese ose kamufluese për auditorin, por nga brenda gjërat nuhaten ndryshe. Dhe tani që po bëj një rikujtim të kolegëve, vërtet që secili prej tyre më del i/e përcaktuar në njërin nga kategoritë përkufizuese të gazetarëve. Indirekt nënkuptojmë që kemi lloje gazetarësh të kategorive jo shumë të dëshirueshme, gjithashtu edhe politikë redaktoriale dinë të jenë të anshme, por pa ekspozime direkte. Më saktësisht në lidhje me mediat dhe politikën në vendin tonë, shpjegon profesoresha universitare në librin ‘Fillet e pluralizmit politik në Maqedoni dhe post-komunizmi’:

“Ndikimi i partive politike në lirinë dhe pavarësinë e shprehjes së mediave është i madh, veçanërisht për ata që janë në pushtet. Sipas ekspertëve të mediave dhe hulumtimeve të mëparshme, radio dhe televizioni maqedonas si shërbim kombëtar publik në Maqedoni ishte dhe ende është i ndikuar nga elitat politike në pushtet. Nga ana tjetër, komercializimi brutal dhe pjesëtimi i televizioneve të tjerë me koncesion kombëtar gjithashtu uli vlerësimet drastike të mediave më me ndikim. Qytetarët e Maqedonisë gjithnjë e më shumë po shikojnë programe të huaja dhe programet televizive kroate, të cilat sipas disa anketimeve, janë më të shikuara në zonat urbane.”<sup>69</sup>

---

<sup>68</sup>OJQ Civil, ShGM, Doracak Gazetaresk, 2011, f. 40.

<https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/Journalist-Manual-inside-AL-4web.pdf>

<sup>69</sup> Hasan Jashari, Jonuz Abdullahi, Zemri Elezi, Memet Memeti, Ali Pajaziti, Fillet e pluralizmit politik në Maqedoni dhe post-komunizmi, SEEU, 2019. Artikull nga: Liljana Siljanovska, 2019, f. 195-196.

Edhe përkundër numrit të madh të mediave që punojnë në vend, që do të thoshte se duhej të ekzistonte një shkallë e lartë demokratizimi dhe pluralizmi, doemos duhet theksuar që në mesin e shumë problemeve që me vite zvarriten në sferën mediatike në Maqedoni janë:

- Përqendrimi i palejuar i pronësisë të mediat,
- Ndikimi i elitave ekonomike dhe politike ndaj mediave.

Me përqendrim të palejuar mediatik nënkuptohet kur një person ose firmë është pronar i më shumë radiodifuzerëve (televizioneve ose radiove), njëkohësisht të radiodifuzerit dhe të gazetës ditore ose të agjencisë së lajmeve, të agjencisë për reklamime ose të agjencisë që merret me hulumtimin e tregut dhe të opinionit publik, si dhe të shoqatës e cila merret me distribuimin e veprave audio-vizuale, të programit filmik dhe të shërbimeve të telekomunikacionit. Teoricienët thonë se në Maqedoni, në disa raste, më shumë media me ndikim, gjenden në duart e një të fuqishmi politik ose/dhe ekonomik.<sup>70</sup>

Ndërkaq, si problem në sferën mediatike maqedonase, teoricienët theksojnë edhe të dhënë se pronarë të disa mediave me ndikim, janë politikanë dhe liderë partish dhe farefisi i tyre më i afërt, ndërsa disa prej tyre në vitet e kaluara shpeshherë kanë qenë ose ende janë në koalicion me partitë politike në pushtet. Jo rrallë, disa padronë mediatikë i shfrytëzojnë mediat e tyre për të reklamuar bizneset e tyre.<sup>71</sup>

Mediat në Maqedoni janë nën ndikimin e elitave politike dhe të biznesit, që reflektohet edhe te përmbajtjet mediatike. Këto dukuri shpeshherë janë theksuar si problem edhe nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në Maqedoni, kështu që në Raportin e Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë të datës 15 tetor 2009, thuhet se “në sferën e mediave të shtypura ende ka përqendrim të lartë mediatik dhe jotransparencë të pronësia”, ndërsa

---

<sup>70</sup> Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Doracak për arsimtarë për zotërimin e mësimin bazik për mediat në lëndën e gjuhës amtare, Shkup, 2010, f. 28-29.

<http://www.medium.edu.mk/attach/mpal.pdf>

<sup>71</sup> Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Doracak për arsimtarë për zotërimin e mësimin bazik për mediat në lëndën e gjuhës amtare, Shkup, 2010, f. 28-29.

<http://www.medium.edu.mk/attach/mpal.pdf>

“ndikimet politike në media janë shqetësuese, për shkak se shkojnë drejt vetëcensurës dhe kufizimit të lirisë së shprehjes”.<sup>72</sup>

Pronësia mediatike është një sferë në të cilën më së shumti pëson gazetari. Në këtë pjesë qëllimet janë të fokusuar në dimensionin e të qenit i mirë me të gjithë, dhe i vërtetë me askënd. Interesi i përfitimit e tejkalon udhëheqjen përmes qëllimit dhe besnikërisë ndaj të njëjtit.

Media në Maqedoni është e mbingarkuar nga politika e përditshme, domethënë, ata gjithnjë e më shumë po pushtojnë një parti pavarësisht nëse është me interesa politike apo një garë e fitimit tregtar. Hulumtimi “Etikë dhe gazetari në Evropën Juglindore” (2010), i realizuar nga Rrjeti i Profesionalizimit të Medias në Evropën Juglindore dhe Instituti i Medias në Maqedoni, tregojnë se rreth 90% e gazetarëve para se të publikojnë informacionin, së pari i nënshtrohet kontrollit të pronarëve të tyre, dhe pothuajse prapa secilit medium qëndron një grupim i caktuar ekonomiko-politik, dhe një interes i diktuar nga mënyra e raportimit dhe përpunimit të temave. Sipas këtij hulumtimi, disa janë duke u përpjekur të fshihen pas informacionit objektiv, ndërsa të tjerët po e bëjnë mjaft të hapur.<sup>73</sup>

Qartë thënë mediat në vend, jo rrallë here kanë qëndrime favorizuese ndaj garniturës politike në pushtet, jo gjithnjë në bazë të vendimeve të gazetarit, por të diktuara nga pronarët. Nuk përjashtohet edhe manipulimi i lajmit nga ana e gazetarit, që nga sjellja e të njëjtit nga tereni. Gjithsesi, në kapitullin e fundit të këtij punimi, do të kemi mundësi të njoftohemi me situatën reale të raportit media-politika dhe se cila te cila ndikon, me anë të shpalosjes së përgjigjeve të përfaqësuesve mediatikë, OJQ-ve dhe nga vetë përdoruesit e mediave online.

---

<sup>72</sup> Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Doracak për arsimtarë për zotërimin e mësimit bazik për mediat në lëndën e gjuhës amtare, Shkup, 2010, f. 30.

<http://www.medium.edu.mk/attach/mpal.pdf>.

<sup>73</sup> Hasan Jashari, Jonuz Abdullahi, Zemri Elezi, Memet Memeti, Ali Pajaziti. Fillet e pluralizmit politik në Maqedoni dhe post-komunizmi, SEEU, 2019. Artikull nga: Liljana Siljanovska, 2019, f. 195-196.



### 3. PËRVOJAT E MIRA NË RAJON

#### 3.1. Ndikimi i mediave në politikbërje në Shqipëri dhe Kosovë

Marrëdhënia politikë-media është reflektuar në njëzet vitet e fundit edhe në qasjen e gazetarëve ndaj profesionit dhe rolit të tyre në shoqëri, kurse efekti i të njëjtëve ka ndikuar dukshëm në mënyrën jo të duhur të informimit dhe dallimin e dukshëm të animeve politike, ose favorizimeve të ndryshme me ngjyrimet partiake. Shpeshherë kemi panoramë pozitive kundrejt zhvillimit mediatik të shteteve fqinje, por që është e vërteta përparimi në teknikat e emitimit, nuk ka të bëjë aspak me mënyrën e përpunimit të një lajmi ose mënyrën e plasimit të të njëjtit.

Studimet sistematike mbi historinë e medias në Shqipëri janë shumë të pakta. Sistemi mediatik pas vendosjes së regjimit komunist ishte endemik. Ai konsistonte në një numër të vogël gazetash me tirazh të ulët dhe me numër të kufizuar faqesh, dy radiostacione në Tiranë dhe Korçë, si dhe disa shtypshkronja në Tiranë, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, në të cilat ishin shtypur gjatë luftës gazetat, *Bashkimi*, organ i Frontit Antifashist apo *Kushtrimi i lirisë* që do të kthehej pas luftës në gazetën *Zëri i Rinisë*. Gjatë regjimit komunist këto gazeta të viteve të '30 u bllokuan, dhe u morën masa për ta kufizuar edhe rrethin e njerëzve që duhet të njiheshin me to, si studiuesit, gazetarët, etj.<sup>74</sup> Nga viti 1944-1945, në media sundonte liria elitare, gazetarë dhe shkrimtarë të viteve 20-30 që kontribuan në këtë vit, u burgosën ose u larguan nga detyra.

Radio Tirana e kishte filluar transmetimin në nëntor të vitit 1938, me valë të shkurtra. Gjatë kësaj kohe, ajo i shërbente qeverisë së Zogut, ndërsa gjatë Luftës së II Botërore, kryesisht nazistëve. Në fund të luftës dhe menjëherë pas çlirimit, radioja ishte mjete më i përhapur, me anë të së cilit Partia komuniste trumbetonte fitoren e saj. Suksesi i radios në Shqipëri nga ajo kohë dhe disa dekada më vonë, lidhet dhe me faktin që shumica e popullsisë ishte analfabete dhe nuk mund të lexonte shtypin,<sup>75</sup> gjë që lë të nënkuptohet sundimi i regjimit politik në media, që pothuajse një shekull më parë.

---

<sup>74</sup> Jonila Godole. Gazetaria shqiptare në tranzicion, Papirus, Tiranë, 2014, f. 51.

<sup>75</sup> Po aty, f. 52.

Zhvillimi i televizionit në Shqipëri është më i vonë se në vende të tjera të Evropës. Gjatë viteve të regjimit komunist ai do të shërbente, njësoj si shtypi dhe radioja, thellësisht si mjete propagande, por pushteti njëkohësisht ua kishte frikën stacioneve të huaja televizive dhe ndikimit që këto mund të kishin mbi shtetasit e tij. Prandaj organizata e “Frontit Demokratik” ndërmerre herë pas here iniciativa si “zhdukja e antenave ilegale”, por me gjithë përpjekjet, qytetarët shqiptarë vazhduan të ndiqnin fshehurazi kanalet e huaja, kryesisht ato italiane. Për sa i përket cilësisë së transmetimeve televizive, lajmet ishin të përcaktuara qartë sipas ‘shabllonit’ të Komitetit Qendror të Partisë, formuloheshin zakonisht me të njëjtin stil të thatë dhe përmbanin informacione të rreme si për informacionet ekonomike brenda vendit, ashtu edhe për ngjarjet që ndodhnin jashtë tij. Njësoj si në shtyp dhe në radio, edhe në TV mbizotëronte mediokriteti, për sa i përket cilësisë së programacionit.<sup>76</sup>

Forumi shqiptar për median e lirë, një organizatë e pavarur që përfaqëson një grup të mediave në Shqipëri, lëshoi një deklaratë publike në 23 maj të vitit 2003, duke apeluar kundër kushteve të mediave në Shqipëri dhe duke shprehur shqetësimet e tyre për të ashtuquajturën “fushatë qeveritare, që synon të fitojë kontroll të plotë të mediave të pavarura, përmes frikësimit të mekanizmave të falimentimit dhe shantazheve financiare, si dhe gjuhëzimit të gazetareve kryesorë jo-qeveritarë në vend, përmes një fushate të përgjithshme gjykimesh me gjobë të papërballueshme për botuesit.”<sup>77</sup>

Me evoluimin e fazave të sistemit mediatik, gazetarët shqiptarë u transformuan nga një armatë të heshtur dhe të varur nga politikat editoriale, pra indirekt nga politika dhe pushteti. Shembull për këtë është instrumentalizimi i tyre në çdo fushatë elektorale që ka ndodhur nga 1992 e deri më sot. Forcimi i shtypit dhe medias private u shoqërua në një hap të dytë me rritje të komercialitetit, por edhe të personalizimit të politikës duke e kthyer median në hapësirën ku “lahen rrobat e palara të kundërshtarëve politikë”. Për sa i përket rolit të pushtetit në lidhje me mediat, veçanërisht gjatë qeverisjes socialiste (1999-2002), media u mbështet me ndihma financiare, ku mbi 2/3 e reklamës vinte nga qeveria. Ajo që në pamje të parë mund të duket si ndihmë, mund të interpretohet edhe si konsolidim i një varësie të medias nga politika. Gjatë qeverisjes socialiste (2002-2005 dhe prej vitit 2013) marrëdhënia e pushtetit me informacionin ka qenë dhe vazhdon të mbetet e ndikuar nga një model

---

<sup>76</sup> Jonila Godole. Gazetaria shqiptare në tranzicion, Papirus, Tiranë, 2014, f. 54.

<sup>77</sup> Albanian Media Monitor 2003, Albanian Media Monitoring Centre, Tiranë, 2003, f. 171.

centralist komunikimi. Përkundrazi, qeverisja demokratike në dy fazat e saj (1992-1997 dhe 2005-2013), ka ndjekur një marrëdhënie të ndryshme me median dhe të drejtën e informimit.<sup>78</sup>

Edhe në gjashtë vitet e fundit, nuk njihet ndonjë përmirësim ose pavarësim historik i medias në Shqipëri. Madje kemi qenë ndjekës të vazhdueshëm të politikave fqinje me ç'rast kemi mundur të shohim sjellje jo të hijshme të një kryeministri kundrejt gazetarëve, duke i quajtur me epitete të ndryshme fyese ose duke refuzuar në mënyra të ulëta për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Protestat e studentëve dhe përballja sypatrembur e studentëve me kryeministrin edhe përkundër qëndrimit përulës që Kryeministri Rama kishte kundrejt tyre, ata nuk reshtën deri sa fituan pikat e pretenduara. Gjithashtu kemi prezent edhe protestat e opozitës, për të cilat zhargoni i pozitës në pushtet, lente për të dëshiruar. Dhe kështu politika dhe pushteti vazhdojnë me ndërhyrjet dhe kontrollet e tyre në media, duke mos çarë kokën për pasojat në bërje të gazetarisë dhe cenimin e të drejtës për informim të drejtë dhe të paanshëm.

Por, këtë ndikim dhe joprofesionalizëm, nuk e hasim vetëm në Shqipëri. Nëse kthehemi për afërsisht dy dekada e gjysmë mbrapa, s'duhet shumë për të rikujtuar gjendjen aspak të lakmueshme të informimit të mediave në Kosovë. Raportimi në gjuhën shqipe ishte i kufizuar vetëm me Radio Televizionin e Prishtinës, si organizatë e vetme transmetuese origjinale e pavarur në gjuhën shqipe në Kosovë dhe e përditshmja Rilindja, gazeta e vetme në gjuhën shqipe. Të njëjtat, në verën e '90-ve, u morën nga Serbia duke lënë sy mbyllur dhe vesh shurdhë popullin e Kosovës. Iniciativat nuk mungonin. Kishte etje për të dëgjuar e për t'u informuar në gjuhë të nënës. Arritën qëllimin për shtyp të përditshëm, me gazetat Bujku dhe Koha Ditore dhe dy orë transmetim satelitorë nga Shqipëria.<sup>79</sup>

Vitet kalonin dhe gjendja përkeqësohej. Kosova gjendej në prag të një lufte të pamëshirshme nga serbët. Gjatë kësaj periudhe, shtëpitë braktiseshin nga banorët, duke lënë mbrapa vetëm gazetarët e guximshëm.

Një grup raportuesish dhe fotoreporterësh të gazetës Bujku, ishin fisnik ndaj profesionit të tyre, duke ndjekur lajmin nga afër, edhe përkundër rrezikut që u kanosej. Ishte dashuri për

---

<sup>78</sup> Jonila Godole. Gazetaria shqiptare në tranzicion, Papirus, Tiranë, 2014, f. 93-94.

<sup>79</sup> Zekë Gecaj, The Kosovo: News & Propaganda war, The international Press Institute, Vienë, 1999, f. 346.

vendlindjen dhe besnikëri për profesionin. Ata jo vetëm që rrezikoheshin, por edhe u kërcënuan e u torturuan nga pala serbe, por përsëri i mbetën fisnik profesionit. Ndaj epoka e raportimit të mediave të Kosovës në kohën e luftës, edhe pse me shumë vështirësi dhe humbje, është një prej bëmave më të guximshme dhe për t'i pasur zili. Jo rastësisht preka këtë pjesë të vështirë, sepse dua të ndërlidhem në etikën dhe dashurinë për profesionin e gazetarisë. Për sypatremburinë ndaj të vërtetës në kohën kur nuk kishte vlerë asnjë përfitim financiar e leverdi personale krahas një raportimi puro të drejtë dhe të paanshëm.<sup>80</sup>

Ndërsa aktualisht janë shtatë gazeta të përditshme në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot, Bota Sot, Tribuna, Lajm, Epoka e Re. Një gazetë tjetër, Gazeta Express, kaloi nga versioni i shtypur në atë elektronik në vitin 2013. Nuk ka informata të pavarura për numrin e saktë të tirazhit të shitur ndërsa shifrat e gazetave janë zakonisht të fryra për të dëshmuar një hise më të madhe në tregun e reklamave. Numri i gazetave të përditshme është dukshëm më i vogël sesa numri i përgjithshëm i transmetuesve. Aktualisht nuk ka ndonjë regjistër a të dhënë statistikore zyrtare përkitazi me numrin e përgjithshëm të mediave të shkruara në Kosovë, përveç shtatë gazetave të përditshme. Vështirësitë financiare, ndikojnë në pagat e gazetarëve që janë shumë jo konkurruese, në krahasim me gjithë sektorin privat në Kosovë. Si pasojë e kësaj, mediat luftojnë me konkurrencën, jo vetëm nga sektori privat, por edhe nga ai publik. Kjo ka një ndikim të rëndësishëm në nivelin e profesionalizimit, ku shkalla e qarkullimit të gazetarëve mbetet e lartë dhe mundësitë për zhvillim mbeten të ulëta.<sup>81</sup>

Me anë të të bërit kompromis me profesionalizmin në vendin e punës, si pasojë e pakënaqësive, vjen deri te dëshira për përmbushje të të njëjtave përmes mundësive të dyta, gjegjësisht, kryerja e një shërbimi duke mbuluar një anë të një lajmi, duke i dhënë kahje tjetër, duke manipuluar me besimin e punëdhënësit dhe auditorit, dhe kjo çon deri te një devijim i punës etike drejt lejimit të depërtimit të politikës në media, duke kontrolluar mënyrën e plasimit të lajmit, me premtime jashtë profesioneve përkatëse të të dy palëve.

Shqyrtimi i raporteve të përzgjedhura ka shpalosur që gjendja e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në pesë vitet e fundit nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Në raportet që bëjnë rangimin e vendeve, siç janë ato të Freedom House, IREX Media dhe RSF, Kosova

<sup>80</sup> Zekë Gecaj, *The Kosovo: News & Propaganda war*, The international Press Institute, Vienë, 1999, f. 347.

<sup>81</sup> Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë, OSCE; Misioni në Kosovë, Qershor, 2014, f. 7.

vazhdon ta mbajë pak a shumë të njëjtën pozitë nëpër lista. Freedom House vazhdon ta kategorizojë Kosovës si “pjesërisht të lirë”, ndërsa rangimi i RSF-së vazhdon të jetë gati-gati i njëjtë, me një ngritje të lehtë për pesë vende që nga viti 2012, një rimëkëmbje kjo qëkurse Kosova pati shënuar rënie të madhe në rangim në vitin 2010.<sup>82</sup>

Gazetaria hulumtuese është njëra ndër degët e gazetarisë që has pak praktikë në tregun mediatic. Është e vështirë në kompletim të puzzlit për të dale deri te një e vërtetë e fshehur dhe e pakamufluar. Zbulimi i keqpërdorimeve të mundshme me anë të një analize dhe hulumtimi të thellë, është mënyra se si duhet të veprohet për të qenë një gazetar i denjë investigativ (hulumtues). Sipas të gjithë citateve dhe qëndrimeve nga autorë të ndryshëm me përvojë, por edhe duke e u bazuar nga puna e përditshme e gazetarëve që na servohet çdo ditë në televizione, mund të kuptojmë që ndjehet mungesë e dukshme e gazetarisë hulumtuese te ne. Kjo lloj gazetarie mban në vete punë dhe përgjegjësi, por është edhe njëra nga degët e gazetarisë në të cilën gazetari mban edhe më shumë rrezik për veten. Gazetari hulumtues duhet të jetë i aftë për njohuri thelbësore, madje edhe përtej thelbësore, të ketë njohuri të ligjeve që mbulojnë punën e mediave, shkathtësi në punën me letra dhe komunikim me njerëz dhe internet dhe aftësi për të menaxhuar dokumente të ndryshme në sasi të mëdha, por mbi të gjitha konfidenciale.

Kosova përbëhet nga dy trupa rregullativ dhe vetë rregullative të mediave, KPM dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Komisioni i Pavarur për Media parashihet tek neni 141 i Kushtetutës së Kosovës dhe ka për detyrë licencimin dhe rregullimin e transmetuesve në Kosovë. Licencimi i transmetuesve parashih që këto media t’i përmbahen një liste të rregullave profesionale, etike, si dhe teknike të parashtruara nga KPM. Ky institucion, nga ana tjetër, ka për detyrë monitorimin e këtyre mediave, në mënyrë që të sigurohet implementimi i rregulloreve të saj.<sup>83</sup>

Kjo “tele-politikë” mund të shihet si një aspekt i mediatizimit të politikës, çka është një zhvillim tërësisht normal. Mirëpo duket se në vend të mediatizimit të politikës, në fakt, tele-

---

<sup>82</sup> IREX, Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave në Evropë & Euroazi (2002 – 2013). Freedom House, Liria e shtypit (2002 -2013). Freedom House, Kombet në tranzicion (2003-2013). Reporterët pa kufij, Indeksi botëror i lirisë së shtypit (2005-2014) <https://www.osce.org/sq/kosovo/122391?download=true>

<sup>83</sup> Shkamb Qavdarbasha, Gjendja e mediave në Kosovë 2014, Instituti për politika zhvillimore, Prill, 2014, f. 7. [https://indep.info/wp-content/uploads/2017/01/04\\_INDEP\\_Gjendja-e-Mediave-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-2014.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2017/01/04_INDEP_Gjendja-e-Mediave-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-2014.pdf)

politika përbën më shumë klientelizimin politik të medias. Duke qenë se fokusi i medias zhvendoset nga publiku tek politika, për rrjedhojë, kjo i shërben politikës në vend që t'i shërbejë publikut. Ajo që vërehet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni është përdorimi, keqpërdorimi dhe abuzimi i medias nga politika, edhe pse në raportin e Balkan Barometer 2017<sup>84</sup>, theksohet që në Shqipëri dhe në Kosovë ka besueshmëri në media, ndërsa Maqedonia jo.

### 3.2. Media e pavarur dhe shoqëria civile

Një shtyp i lirë nuk është një luks. Një shtyp i lirë është thelbi absolut i zhvillimit të ekuilibruar, sepse nëse nuk mund të sigurosh të drejtën e votës për të varfrit, nëse ata nuk kanë të drejtën e të shprehurit, nëse nuk ka dritë kërkimi për korrupsionin dhe praktikën e pabarabarta, nuk mund të ndërtoni konsensusin publik të nevojshëm për të sjellë ndryshime, ka thënë *James Wolfensohn*, ish-president i Bankës Botërore.

Shpesh media e pavarur ka epitetin si media alternative, me qëllim për të dalluar veten nga mediat me rol kryesor në vendet përkatëse. Pjesë e mediave të pavaruara mund të jetë çdo formë e mediave si televizion, gazeta, radio ose internet dhe nga vetë emërimi 'media e pavarur' që forma e mediave të përmendura më lart janë pa ndikim nga interesat e qeverisë ose të ndonjë grup tjetër vepruesish. Në shtetet evropiane dhe më gjerë, termi media e pavarur, i referohet kryesisht mediave të reja që janë në zhvillim e sipër dhe që kontribuojnë për informim të pavarur.

Një media e lirë dhe e pavarur, është thelbësore për një shtet demokratik me plot kuptimin e fjalës. Është më se e rëndësishme financimi i bollshëm vetanak i mediave, në mënyrë që ata të kenë pavarësinë e tyre për sa i përket fondeve të garniturave udhëheqëse shtetërore, sepse në këtë mënyrë do të mund t'i shmangen varësisë ose blerjes nga subjektet politike. Me financimin e duhur, gjithashtu shoqëria ka benefite në ngjalljen e interesit për t'u marrë me politikë, sistemi politik është më i qëndrueshëm dhe korrupsioni është më nën kontroll. Qytetarët që besojnë te transmetuesi i tyre publik, janë më të kënaqur me rendin dhe demokracinë e vendit.

---

<sup>84</sup> [https://www.rcc.int/seeds/files/RCC\\_BalkanBarometer\\_PublicOpinion\\_2017.pdf](https://www.rcc.int/seeds/files/RCC_BalkanBarometer_PublicOpinion_2017.pdf)

Përse media është e rëndësishme për organizatat e shoqërisë civile?

Ne jetojmë në epokën e medias, disa madje e quajnë “realiteti i medias”. Nga media ne arrijmë të mësojmë shumicën e ngjarjeve rreth botës që na rrethon. Shumë ngjarje bëhen të njohura vetëm kur filmohen dhe publikohen në media. Organizatat e shoqërisë civile në fushat e tyre të ndryshme të punës dhe veprimit social, janë të lidhura ngushtë me median dhe në marrëdhënie të ndërvarura me të. Mediat përbëjnë një burim të rëndësishëm informimi për OJF-të, pasi i njohin ato me atë se çfarë po ndodh në fushën ku punojnë si dhe në fusha të tjera të rëndësishme (në shkallë ndërkombëtare, kombëtare, në fushën profesionale etj).<sup>85</sup> Nga ana tjetër, media është gjithashtu një nga rrugët kryesore me anë të së cilës mund të bëhet i dëgjuar zëri i OJF-ve, duke mundësuar që informacioni mbi punën që OJF-të bëjnë, këndvështrimi ynë rreth çështjeve të caktuara, apo ngjarjet e organizuara nga ne, të mbërrijnë te publiku i gjerë. Përmes medias, OJF-të vendosin ura lidhjeje me grupet e interesit, anëtarët, mbështetësit, klientët, qeverinë dhe njerëzit e tjerë me ndikim në punën e tyre. Kështu që, media mund të jetë një aleat ose kundërshtar i mundshëm i OJF-ve që ndihmon ose pengon OJF-të në përpjekjet e tyre për të bindur dhe mobilizuar publikun e gjerë. Ndaj, kur flasim për rëndësinë që media ka për OJF-të, fillimisht duhet ta konsiderojmë median si partnerë dhe aleatë të mundshëm.<sup>86</sup>

Kristina në librin e saj për mediat dhe shoqëritë civile, ndan eksperiencat e saj në lidhje me po të njëjtën temë, ku thotë:

“Shumica e bisedave të mia me shumë OJF nga Sllovenia dhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përmbajnë shprehje me vërejtje, ankesa dhe frikë kundrejt medias të tilla si: Media nuk ka interes për punën dhe qëllimet e mira të OJF-ve.

- Ajo thjesht është në kërkim të lajmeve të rëndësishme.
- Gazetarët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të mbuluar çështje të caktuara rreth OJF-ve.

---

<sup>85</sup> Kristina Plavšak Krajnc, Rrjeti ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile (BE) 2007, f. 6-7.

<http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/03/balkan-civic-practices-4-sq.pdf>

<sup>86</sup> Po aty, f. 6-7.

- Shpesh ata flasin për çështjet tona në një mënyrë sipërfaqësore, pa pasur informacion të plotë, me gabime dhe gjithashtu me një lloj anësie politike.
- Nuk kemi as kohë dhe as para për të punuar me median.
- U kemi dërguar shumë e shumë lajmërimi mediave, por ato ose nuk i kanë botuar fare ose kanë marrë thjesht një pjesë të informacionit prej tyre.
- Kemi organizuar një konferencë për shtyp, por nuk erdhi asnjë media.
- Gazetarët telefonojnë vetëm nëse kanë nevojë për ndonjë gjë ose kanë ndonjë lajm të keq në lidhje me ne.
- Ne thjesht nuk u përgjigjemi fare as telefonatave e as pyetjeve të gazetarëve.
- Synimi i vetëm i tyre është që të na shqetësojnë ose të na vendosin nën një dritë të keqe.”<sup>87</sup>

### 3.3. Rrjetet sociale dhe ndikimi i tyre në politikë

Interneti ishte pritur si media e re, e cila mundëson demokratizim të skajshëm të shoqërisë, për shkak se mundëson komunikimin, hapjen e dialogut dhe lirinë e shprehjes së çdo qytetari, në çdo kohë, nga cilido vend i botës. Skeptikët, ndërkaq, i kundërshtojnë pikëpamjet e këtilla entuziaste, duke drejtuar gishtin kah i ashtuquajtimi jaz digjital që ekziston midis shteteve të pasura dhe të varfra, midis zonave urbane dhe rurale, midis burrave dhe grave, duke theksuar karakterin elitare të internetit, megjithatë dhe problemin me një varg informacionesh, me relevancën e tyre, anonimatit e shfrytëzuesve ose qëndrueshmërinë e argumenteve.<sup>88</sup>

Epoka e tanishme e komunikimit në rrjet filloi me shpikjen e *World Wide Web* në 1991 dhe zhvillimin e Weblogut, listave shërbyese dhe postës elektronike, që mbështetën komunitetin online. Faqja e parë e mediave sociale, *Six Degrees*, u zhvillua në 1997 dhe u zhbë në vitin 2000, pasi kishte shumë pak përdorues. Faqet e Niche që përmbahen nga grupet me identitet, të tilla si Asian Avenue, qarqet e miqësisë, përfshirë *Friendster* dhe

<sup>87</sup> Kristina Plavšak Krajnc, Rrjeti ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile (BE) 2007, f. 5.

<http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/03/balkan-civic-practices-4-sq.pdf>

<sup>88</sup> Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup 2010, f. 40.



*MySpace*, kontakte profesionale, si *LinkedIn*, dhe avokatët e politikave publike, siç është *MoveOn*. Ardhja e Web 2.0 në mesin e viteve 2000, me theks në pjesëmarrje, përdorues të përqendruar, platforma bashkëpunuese, përkoi me zhvillimin e platformave të qëndrueshme të mediave sociale, duke përfshirë Facebook në 2004 dhe YouTube në 2005, të cilat janë bërë elementë të fushatave politike, organizimit dhe qeverisjes. Kur Twitter u themelua në vitin 2006, u parashikua si një faqe me microblogging, ku grupe miqsh mund të dërgonin mesazhe të shkurtra (tweets) për miqtë e tyre, në lidhje me ndodhitë e jetës së tyre.<sup>89</sup>

Që në vitin 1992 Webzinat u bënë shumë shpejt për shtypin elektronik, ajo çka fanzinat përfaqësonin prej shumë kohësh në botën e shtypit të shtypur: gazeta mjaft të ndryshme, të realizuara me shpenzimet më të vogla, më së shpeshti me iniciativën e personaliteteve apo bashkësive të etura për liri dhe mjaft kritike ndaj rendit të vendosur apo institucioneve.<sup>90</sup>

Me anë të internetit vijoi edhe dalja në skenë e rrjeteve të ndryshme sociale, krijimi i portaleve të ndryshme, web faqet me lajme të lëmive të ndryshme, etj, avash avash bënë që pothuajse çdo sferë të rrotullohet rreth mediave online dhe rrjeteve sociale, qoftë kjo për informim, kalim kohe ose pikë referim për çështje të caktuar.

Nën regjimin e internetit, gazetari dhe media kanë pësuar një ndryshim drastik me ndërthurjen e teknologjisë dhe globalizimit. Globalizimi ka rritur fuqinë e mediave, por ajo e ka bërë gazetarinë pre e presioneve të ideologjive dhe interesave komerciale. Interneti ka qenë efektiv për sjelljen e lajmeve dhe informatave te njerëzit. Përdorimi i internetit në lajme dhe shpërndarje informacioni ka hyrë në media të ndryshme që si bllogje online dhe forma digjitale për të arritur një botë më të gjerë. Sidoqoftë, konkurrenca ekonomike dhe orari 24 orësh i gazetarisë, në internet kanë kontribuar në sensacionalizëm dhe thashetheme. Shumica e gazetarëve të internetit kanë përqafuar Tweeter, Facebook dhe rrjetet tjera sociale, që më vonë të

---

<sup>89</sup> Diana Owen. The Past Decade and Future of Political Media: The Ascendance of Social Media, OpenMind Project, 2018, f. 8.

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/12/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-Past-Decade-and-Future-of-Political-Media-The-Ascendance-of-Social-Media.pdf>

<sup>90</sup> Francis Balle. Mediat dhe shoqëritë, Edicioni 15, Botimet 'Papyrus', Tiranë, 2011, f. 238-242.

lidhin ndjekësit në faqet e tyre dhe për të kontribuar në mendimet dhe opinionet e tyre.<sup>91</sup>

Digjitalizimi mediatic ka bërë që informimi të jetë më i shpejtë dhe në kohë reale nga vendi i ngjarjes, pikërisht përmes lidhjeve të drejtpërdrejta me anë të internetit. Në njëfarë mënyre kjo ka ndihmuar në shkurtimin e kohës së përgatitjes së lajmit, dhe shfrytëzimin e të njëjtës në diçka tjetër. Raportuesit online, jo detyrimisht duhet të jenë profesionist, kjo ju mundësohet si pasojë e mosekzistimit të një rregulloreje të adresimit online dhe selektimit të mirefilltës nga jo e vërteta. Sido që të jetë, etika në plasim të lajmit duhet të jetë parësore edhe në mediat online.

Media online dhe rrjetet sociale, ndikojnë frytshëm për garniturën politike dhe ndjekësit e tyre. Përveç faktit që simpatizantët e subjekteve politike mund të kenë qasje më të lehtë ndaj aktorëve politik, këta të fundit e kanë lehtësuar edhe më kapshëmërinë me qytetarët, duke krijuar kanale zyrtare mediatike në internet dhe duke transmetuar drejtpërdrejtë çdo konferencë shtypi, pritje diplomatike, takim me diplomatë, për çështje të rëndësishë kombëtare ose evropiane.

Le të ndalemi pak te disa nga efektet e drejtpërdrejta të rrjeteve sociale në politikëbërje, të analizuara nga Tom Murse, gazetarë në Thoughtco,<sup>92</sup> sajt parësorë i referimit me më shumë se 20 vjet veprimtari në përmbajtje arsimore të krijuar nga ekspertë, i cili raporton si vijon:

- *Kontakt i drejtpërdrejtë me votuesit* - Mjetet e mediave sociale përfshirë Facebook, Twitter dhe YouTube, lejojnë politikanët të flasin drejtpërdrejt me votuesit, pa shpenzuar asnjë monedhë. Përdorimi i mediave sociale u lejon politikanëve të anashkalojnë metodën tradicionale të arritjes së votuesve përmes reklamave të paguara ose mediave me pagesë.
- *Reklama pa paguar për reklama* - Është bërë mjaft e zakonshme që fushatat politike të prodhojnë reklama, t'i publikojnë ato falas në YouTube, në vend që të paguajnë kohë televizive ose radio.

---

<sup>91</sup> Michael Mule Ndonye, *Media Ethics in Journalism and Mass Communication*, Kenya, 2014, f. 35.

[https://www.academia.edu/8345702/Media\\_Ethics\\_in\\_Journalism\\_and\\_Mass\\_Communication\\_Exploring\\_the\\_Virtual\\_World](https://www.academia.edu/8345702/Media_Ethics_in_Journalism_and_Mass_Communication_Exploring_the_Virtual_World)

<sup>92</sup> <https://www.thoughtco.com/about-us>

- *Si fushatat bëhen virale* - Twitter dhe Facebook janë bërë instrumental në organizimin e fushatave. Ato lejojnë votuesit dhe aktivistët me të njëjtën mendje të ndajnë me lehtësi lajme dhe informacione, siç janë ngjarjet e fushatës me njëri-tjetrin. Për këtë shërben funksioni "shpërndarje" në Facebook dhe "retweet" në Twitter.
- *Përshtatja e mesazhit për audiencën* - Fushatat politike mund të futen në një informacion të pasur ose analitik, për njerëzit që i ndjekin ato në mediat sociale dhe të personalizojnë mesazhet e tyre bazuar në demografinë e zgjedhur.<sup>93</sup> Një fushatë mund të gjejë një mesazh të përshtatshëm për votuesit nën 30 vjeç, që nuk do të jetë aq efektive për votuesit mbi 60 vjeç.
- *Rritje fondesh* - Disa fushata kanë përdorur të ashtuquajturat "bomba parash", për të mbledhur sasi të mëdha parash në një kohë të shkurtër. Bombat e parave janë zakonisht periudha 24-orëshe, në të cilat kandidatët u bëjnë presion mbështetësve të tyre për të dhuruar para. Ata përdorin rrjetet sociale si Twitter dhe Facebook për të përhap lajmin dhe shpesh i lidhin këto bomba të hollash me polemika specifike që shfaqen gjatë fushatave.
- *Polemikë* - Qasja e drejtpërdrejtë e votuesit gjithashtu ka mangësi. Mbajtësit dhe profesionistët e marrëdhënieve me publikun, shpesh menaxhojnë imazhin e një kandidati, dhe për arsye të mirë: Lejimi i një politikani të dërgojë tweet-a të pa filtruar ose postime në Facebook, ka zbarkuar shumë kandidat në ujëra të nxehtë ose situata të turpshme.
- *Reagim (Feedback)* - Të kërkos feedback për votuesit ose zgjedhësit mund të jetë një gjë e mirë. Por mund të jetë edhe një gjë shumë e keqe, në varësi të mënyrës se si reagojnë politikanët.
- *Peshimi i opinionit publik* - Vlera e mediave sociale është në menjëherësinë e saj. Politikanët dhe fushatat nuk bëjnë absolutisht asgjë pa e ditur më parë se si do të luajnë deklaratat e politikave ose lëvizjet e tyre midis elektoratit.
- *Trendi (It's Hip)* – Një arsye pse media është efektive, është se ajo angazhon votuesit e rinj.
- *Fuqia e shumë njerëzve* - Mjetet e mediave sociale kanë lejuar njerëzit të kyçen me lehtësi së bashku, për të bërë kërkesë për qeverinë dhe zyrtarët e tyre të

<sup>93</sup> Tom Murse, How Social Media Has Changed Politic, 2019.

<https://www.thoughtco.com/how-social-media-has-changed-politics-3367534>

zgjedhur, duke shfrytëzuar profilet e tyre kundër ndikimit të lobistëve të fuqishëm dhe të interesit të veçantë.<sup>94</sup>

Kjo analizë e Tom Murse në lidhje me ndryshimin që ka pësuar politika me jetësimin e rrjeteve sociale, tregon qartë dhe saktë hap pas hapi etapat e ecurisë së procesit të ndikimit të rrjeteve sociale gjatë kampanjave zgjedhore dhe politikbërjes. Lehtësimi i komunikimit me simpatizantët dhe mundësia e reklamimit pa shpenzime marramendëse, kanë rol parësorë në ngritjen e reitingut dhe përmirësimin statusit dhe reputacionit të subjektit politik. Me këtë deri diku edhe sigurimin e fitores në periudha elektorale.

#### 3.4. Ndikimi i organizatave joqeveritare në politikbërje

Organizatave joqeveritare, që veprojnë në fushën e lirisë së shprehjes dhe të aksesit në informacion, si dhe organizatat që merren më gjerësisht me të drejtat civile, duhet të nxisin një debat publik mbi probleme të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e medias në këtë frymë të hapur dhe të paanshme, duke rritur ndërgjegjësimin se si media ndikon mbi qytetarët. Një iniciativë e tillë duhet të mbështetet fuqimisht nga institucionet ndërkombëtare dhe ato evropiane, të tilla si Bashkimi Evropian, OSBE dhe Këshilli i Evropës.<sup>95</sup>

Duke dashur të jemi edhe më konkret dhe të nisemi nga rezultate konkrete, për këtë kapitull kam realizuar tre intervista me tre udhëheqës të Organizatave joqeveritare të cilët përballen në përditshmëri me ndikimin e vendimeve politike në shoqëri.

Më poshtë kemi përgjigjet e paedituara të secilit pjesëmarrës në intervistë, por me një përmbledhje analize të përgjigjeve të tyre, për të parë këndvështrimet e tyre kundrejt ndikimit të mediave në politikbërje në vendin tonë.

---

<sup>94</sup> Tom Murse, How Social Media Has Changed Politic, 2019

<https://www.thoughtco.com/how-social-media-has-changed-politics-3367534>

<sup>95</sup> OJQ Civil, ShGM, Doracak Gazetaresk, 2011, f. 45.

<https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/Journalist-Manual-inside-AL-4web.pdf>

## **Xhabir Memedi Deralla – Kryetar i OJQ Civil**

### **1. Si ndikojnë Organizatat e shoqërive civile në politikbërje?**

Organizatat e shoqërisë civile kanë një ndikim të fortë në hartimin e politikave në vendin tonë. Sidoqoftë, e njëjta varet shumë nga qëndrimi i hapur i qeverisë për shoqërinë civile. Gjatë sundimit të VMRO-DPMNE-së në periudhën 2006-2016, praktikisht qeveria ishte e mbyllur "hermetikisht" për bashkëpunim dhe pa dëgjuar sugjerime nga organizatat e shoqërisë civile. Qeveria e udhëhequr nga Zoran Zaevi, nga ana tjetër, është treguar e hapur maksimalisht për shoqërinë civile. Organizatat e shoqërive civile, janë realizues aktiv të krijimit të politikave të kësaj qeverie, e cila është një kontrast i ashpër me çdo periudhë tjetër në të kaluarën.

### **2. A janë OJQ-të faktor për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

Përkatesisht, organizatat e shoqërisë civile luajnë rol serioz në procesin politik, veçanërisht në fushën e strategjive qeveritare për të luftuar korrupsionin, me një kontribut të madh nga CIVIL, me strategjinë “Një shoqëri për të gjithë” dhe gjithashtu edhe në procesin e integritetit në BE. OShC-të kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në procesin e Prespës, si dhe në forcimin e politikave dhe praktikave për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht në fushën e drejtësisë sociale në kuptimin më të gjerë.

### **3. Sa kanë OJQ-të liri shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen jo të mirë, nga garnitura politike në pushtet?**

Kjo hapësirë është praktikisht e pakufizuar, duke marrë parasysh zhvillimet moderne teknologjike dhe të komunikimit. Liria e shprehjes është e përfshirë në politikën e kësaj qeverie dhe nuk ka asnjë pengesë për të vënë ato kritika në çdo kohë dhe në çfarëdo forme. Sidoqoftë, shumë nga shoqëria civile vuajnë nga mungesa e aftësive për të njohur se si funksionojnë mediat, dhe aq më pak për të prodhuar përmbajtje mediatike në të cilat ata shprehin pikëpamjet dhe analizat e tyre. CIVIL gjithashtu vë në dukje se Organizatat e shoqërive civile, shpesh vuajnë nga qëndrime të pamjaftueshme për lajme të rreme dhe dezinformata, kështu që ata ndodhin të jenë shumëzues të sulmeve hibride kundër demokracisë maqedonase, sesa t'i luftojnë ato.

**4. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita politike në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtejshme?**

Nga përgjigjet më lartë mund të vërehet se mendimi im është që Qeveria i merr shumë seriozisht pikëpamjet e organizatave të shoqërive civile dhe i zbaton ato.

**5. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Jo gjithmonë. Organizatave të shoqërive civile nuk kanë arritur të garantojnë lirinë e shprehjes, natyrisht, me përjashtim të një numri të organizatave që specializohen në këtë fushë.

**6. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Media është akoma e ndikuar fuqimisht nga qendrat politike, ekonomike dhe kriminale të pushtetit. Shumë media kanë mbajtur qëndrim klientelist ndaj qendrave të pushtetit. Të mësuar me tretjen e shumave të mëdha të parave publike nga qeveria e Gruevskit, tani që është shkëputur nga politikat e qeverisë së Zaevit, ata po "marrin hak", sepse nuk marrin më fonde nga partitë në pushtet, domethënë qeveria.

**Zharko Trajkov – Drejtor i OJQ Triagollnik**

**1. Si ndikojnë OJQ-të në politikbërje?**

OJQ-të po përpiqen të iniciojnë procesin e hartimit të politikave duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke përmbushur interesat dhe nevojat e grupeve të caktuara të synuara. Kryesisht bëhet fjalë për nivelin e lartë ose të mesëm, por ndikimi është i pamundshëm, pikërisht për shkak të veprimit të kufizuar dhe specifik.

**1. A janë OJQ-të faktor për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

OJQ-të përmes ndërhyrjes së tyre Output që ata realizojnë, mund të ndikojnë, por spontanisht, të paorganizuar dhe të kufizuar pikërisht për shkak të mungesës së rezultatit të veprimeve të tyre.

## **2. Sa kanë OJQ-të liri shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen jo të mirë, nga garnitura politike në pushtet?**

OJQ-të kanë shumë pak hapësirë për veprim dhe shprehje të pakënaqësive ndaj proceseve politike. Arsyet për këtë janë burimet e kufizuara të cilat kanë dispozicion dhe qasja e paorganizuar për zhvillimin e OJQ-ve në Maqedoni. Gjithashtu ndikojnë negativisht edhe kapacitetet e kufizuara të OJQ-ve për shkak të mungesës së kriterëve të qarta për anëtarësim, por edhe manipulimit në procesin e veprimit në ndjekje të interesave të tyre. Mungesa e një strategjie shtetërore për zhvillimin e OJQ-ve dhe përfshirja deklarative e sektorit të OJQ-ve në zhvillimin dhe realizimin e përparësive shtetërore, po ashtu është një anë e mangët për shprehje të lirë. Ndikimi i partisë në shpërndarjen e fondeve të mbështetjes së projektit dhe krijimin e qëllimshëm të projekteve të drejtuara nga donatorët, e gjithë kjo për të gjetur patjetër një mundësi kontrolli kundrejt sektorit joqeveritarë.

## **3. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita politike në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtjshme?**

Këtu po flasim vetëm për angazhime deklarative, duke pasur parasysh faktin se individë ose organizata të tëra, janë në funksion të strukturës politike, dhe stafi i shprehur pengon konstruktivizmin dhe përmbajtjen e qëndrimeve, në mënyrë që ato të jenë me vlerë themelore për t'u përdorur.

## **4. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Në këtë pike, unë personalisht nuk mund ta kem këtë mendim, duke marrë parasysh të gjitha arsyet e mësipërme. Në çdo rast, OJQ-të si opozitë duhet të luajnë atë rol, por për realizim, ka disa parakushte për të plotësuar, siç është krijimi i strukturave stabile dhe të qëndrueshme, një strukturë adekuate financiare që nuk do të kontrollohet dhe imponohet nga strukturat politike, por edhe një kuintesencë për shoqërinë, gjegjësisht të ekzistojë shtet me drejtësi, e cila do të garantojë realizimin e ndryshimit pozitiv dhe jo vetëm veprimin entropik pa rezultate, të cilat do të lejojnë ndikimin.

## **5. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Të kontrolluar, e udhëhequr dhe e realizuar nga një larmi interesash, të pa verifikuar, klienteliste, konformiste dhe larg proceseve të veprimit të vlerës instrumentale dhe operacionale.

### **Arianit Xhaferi – Kryetarë i OJQ Eco Guerrilla**

#### **1. Si ndikojnë OJQ-të në politikbërje?**

Roli i OJQ-ve në politikbërje është shumë i rëndësishëm shkakut i përvojës, ekspertizës dhe qasjes që ky sektor ka ndaj politikave publike. Shpeshherë OJQ-të ofrojnë zgjidhje të mençura dhe të realizueshme për probleme konkrete në shoqëri, por është me rëndësi të thyhet rezistenca që ekziston në organet e vendimmarrjes dhe ekzekutivit për t'i pranuar ato që ne i konsiderojmë për këshilla dhe sugjerime, kurse ata i shohin si kritika dhe sulme.

#### **2. A janë OJQ-të faktor për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

OJQ-të kanë rol të rëndësishëm në përmirësimin e klimës politike si dhe zhvillimin e mbarëvajtjen e proceseve politike. Të lira nga çdo ndikim i jashtëm (me përjashtime të vogla nga disa OJQ që njihen si GoNGO – government organized NGO), OJQ-të kanë kapacitet për të përmirësuar zbatimin e ligjeve, ndryshimin ose përmirësimin e ligjeve, akteve ligjore (etj).

#### **3. Sa kanë hapësirë shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike?**

Qeveria Zaev është treguar shumë më e hapur për bashkëpunim me sektorin civil, krahasuar me qeverisjen Gruevski. Hapësira për të shprehur pakënaqësitë nuk mungon, qeveria reagon pozitivisht ndaj ankesave të OJQ-ve për problem të caktuara.

Për fat të keq, sjellje të njëjtë nuk tregojnë qeveritë lokale (komunat), dhe sidomos ato që udhëhiqen nga kuadrot e BDI-së. Teuta Arifi (kryetare e Komunës së Tetovës), nuk pranon kritikën dhe si pasojë vandalizojnë edhe protestat urbane në formë të një ekspozite publike,



siç ndodhi me ekspozitën “Të palarat në shesh” të datës 11 Nëntor 2019, e cila pati fatin e ngjashëm si të statujave gjigante të BUDËS në Afganistan, të cilat u shkatërruan nga talibanët. Më shqetësues është fakti që edhe pse na dëgjojnë të ankohe mi dhe na thonë që kemi të drejtë, shpeshherë as qeveria qendrore, aq më pak komunat, nuk bëjnë asgjë për të ndryshuar gjendjen për të cilën jemi ankuar.

#### **4. Sa merren parasysh qëndrimet e OJQ-ve nga elita politike në pushtet?**

Qeveria Zaev ka përfshirë në programin e qeverisjes plotë nga këshillat, rekomandimet dhe sugjerimet e organizatave të ndryshme të sektorit civil. Organizatat qytetare (përfshirë dhe Eco Guerilla) i kanë paraqitur shtetit shumë rekomandime për çështje të ndryshme, dhe shumë nga ato rekomandime sot janë pjesë e programit të qeverisë. E njëjta gjë përsëri nuk ndodh me komunat.

#### **5. A janë faktor ndryshues pozitiv për një liri shtypi të pavarur?**

Liria e shtypit të pavarur nuk rrezikohet dhe censurohet gjithmonë nga (pu)shteti, por shpeshherë kemi të bëjmë edhe me autocensurën që vetë redaktorët ose gazetarët i bëjnë lajmeve të tyre. Kjo ndodh shpesh edhe si pasojë e parave që marrin për të reklamuar partitë politike, por edhe si pasojë e ryshfeteve të ndryshme që mund të kenë marrë persona të caktuar në ndonjë shtëpi mediatike, siç kemi pasur rastin të dëgjojmë tek bisedat e përgjuara që publikohen nga El Çeka. Ka një numër mediash që janë si pjesë të OJQ-ve dhe ato shpeshherë janë të lira dhe të pavarura sepse nuk varen nga reklamat partiake, por shumë të tjera janë në rrezik dhe kërcënim të vazhdueshëm nga pushteti.

Ajo çka mund të vërejmë qartazi dhe njëzëri nga të tre drejtuesit e tre organizatave joqeveritare, është bindja e tyre që organizatat joqeveritare janë faktor kyç ndikues për politikbërje më të mirë në vend dhe shoqëri, por garniturat politike janë ata të cilët për fat kë keq sugjerimet dhe propozim zgjidhjet e mundshme nga sektori civil, i shohin si sulme ose kritika negative. Ata theksojnë që garnitura e kaluar ka qenë më hermetike për sa i përket bashkëpunimit me sektorin joqeveritar, ndërsa vërehen përmirësime pozitive nga përbërja e tanishme politike, të paktën thonë ata, propozimet dëgjohe mi dhe merren parasysh. Ndërsa sa i përket pyetjes si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë - të varur ose të pavarur nga subjektet politike, ata janë unanim në po të njëjtin mesazh, por me fjalë të

ndryshme, gjendjen politike e shohin të udhëhequr, të ndikuar, të “sponsoruar”, biles edhe më ashpër e shohin atë si të ndikuar fuqimisht nga qendrat politike, ekonomike dhe kriminale të pushtetit, pjesë kjo dukshëm më në pah në qeverisjen Gruevski.

Në të shumtën e rasteve cekin edhe gazetarin si pre e politikës me anë të financimeve monetare dhe leverditëse, në mënyrë që gazetaria t’i shërbejë shtrembërimin të lajmit në favor të politikave në interes të aktorëve kryesorë politikbërës në vend.

#### **4. SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI**

4.1. Shpalosja e përgjigjeve nga intervistimi i kryeredaktorëve të televizioneve (MTV1, MTV2, AlsatM, Kanal 5)

Pjesë e rëndësishme dhe fundamentale e kësaj teme, është pikërisht hulumtimi i realizuar në teren me pjesëmarrës adekuat, me anë të së cilëve do të mund të vërejmë realitetin e ndikimit të mediave në politikbërje në vendin tonë, gjegjësisht, do të kemi mundësi të shohim nëse hipotezat e shtruara paraprakisht, janë të vërteta ose e kundërta.

Mbledhja e të dhënave është bërë me anë të pjesëmarrësve në hulumtim, duke përdorur intervistat, me ç'rast pjesëmarrësit në hulumtim kanë shprehur këndvështrimet dhe eksperiencat e veta të spikatura personalisht, dhe me anë të të dhënave të tyre përmes përgjigjeve të pyetjeve, arrihet deri te informacionet bazë dhe reale për të cilat është edhe qëllimi i kësaj teme dhe këtij hulumtimi.

Kemi përfshirë gjithashtu edhe më të rëndësishmit në këtë storie, qytetarët, ata, pa votën e të cilëve nuk mund të gëzojnë pushtet garniturat politike. Janë realizuar gjithsej katër intervista me katër kryeredaktorë, dy nga servisi publik dhe dy nga televizione kombëtare.

#### **Migena Gorenca – Kryeredaktore e MTV – Transmetimi dytë, kanali në shqip**

##### **1. Si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë?**

RMV vazhdon të jetë në grupin e shteteve ku liria e medias konsiderohet e kufizuar. Vetëm kjo fjali do të duhej të ishte përgjigje e kësaj pyetjeje. “Lufta” mes medias dhe politikës vazhdon të jetë luftë në të cilën njëra palë, në emër të lirisë së shtypit, fjalës së lirë, të drejtës së qytetarëve për të mësuar të vërtetën etj, është në njërën anë të frontit, me “kundërshtar” të drejtpërdrejtë përballë, klasën qeverisëse, e cila jo gjithnjë dëshiron që e vërteta të jetë e zëshme. Në këtë luftë fiton ai që është më i forti. Politika, fatkeqësisht. Kjo bën që, përveç zërave të veçantë të guximshëm, por që ende mbeten vetëm zëra vetanake, mediat në përgjithësi të zgjedhin rrugën e konfortit, të “mos trazimit të folesë së grerëzave”, ose në rastin më fatlum, të trazimit me pikatore të problematikave që dalin nga politikbërja e gabuar.

Ka raste kur media detyron pushtetarët të tërheqin vendimet apo zgjedhjet ligjore të gabuara, por ende kjo fuqi që ka media, nuk shfrytëzohet sa duhet. Faza e liberalizimit të mediave për fat të keq kaloi dhe kalon ende, në fazën e mediave politike, me pronarë me lidhje të forta me politikën, ku apriori tematikat që trajtohen, në vend të vihen në funksion të përmirësimit të politikëbërjes, vihen në funksion të justifikimit të veprimeve politike, varësisht përkatësisë apo simpatisë politike të pronarit të medias.

Ka faza të caktuara kur në sipërfaqe dalin media “kritike” ndaj pushtetit, e po të njëjtat media, sapo pushteti ndryshon e në krye vjen opozita e deridjeshme, papritmas fillojnë e justifikojnë veprimet për të cilat deri dje vlerësonin se ishin të gabuara. Një qasje e tillë, jo vetëm që ul kredibilitetin e gazetarisë, jo vetëm që ul besueshmërinë që qytetarët kanë te mediat, por lançoi praktikën e gabuar në të cilën fare qartë çdo njeri, edhe pa asnjë formim mediatik, e ka lehtësisht të dallueshme përcaktimin politik të mediave.

Nuk ka asgjë të keqe që një media të mbështesë politikën e një subjekti të caktuar, sa kohë që e bën të qartë për shikuesit, dëgjuesit, lexuesit e saj se në cilën anë të frontit është. Rreziku fillon kur mbështetja kamuflohet duke shkaktuar huti, kur vendimet politike të gabuara justifikohen me materiale gazetareske të kamufluara me “fakte” të pavërtetueshme. Në një atmosferë të tillë mediatike, vështirë që media në përgjithësi, aktualisht, të ketë ndonjë ndikim domethënës në politikëbërje.

Për sa kohë që media të caktuara, kanë burim financiar reklamat qeveritare, reklamat e qeveritarëve biznesmenë, pra kanë lidhje të padukshme me politikën, vështirë që mund të kthehen në një zë kritik dhe ndikues në përmirësimin e politikave. Për fat të mirë, ka përjashtime, por për mua, të pakta.

## **2. A janë mediat faktorë për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

Çdo ditë miratohen ligje të gabuara të cilat pas pak kohësh tërhiqen po nga vetë propozuesit e tyre, politikanë të caktuar çdo ditë shkulin ligjet me të dyja këmbët, megjithatë problematikat e tilla në media, edhe pse trajtohen, nuk mbahen gjatë në vëmendjen e opinionit. Jemi kthyer në kërkues të sensacionit ditor, e jo në zgjidhës afatgjatë të problemeve. Merremi me problemin në ditën që ndodh, e më pas e harrojmë sepse kapemi mbas sensacionit tjetër. Mbas një viti, problemi nuk është zgjidhur e ne prapë riciklojmë tekstin e njëjtë me shtesën “ka kaluar një vit prej kur...” por prapë mbas tre ditësh harrojmë.

Mediat ju kanë dhënë komoditet politikanëve që tashmë e dinë, se nëse e kalojnë fazën njëjavore kur do jenë në qendër të kritikave të opinionit, mund të vazhdojnë qetësisht politikën e tyre të gabuara, sepse faza tjetër do t'ju vijë pas 6 muajsh. Kjo ndodh sepse në luftën për mbijetesë, jemi futur në një gjendje të përgjithshme ku mediat shkëmbejnë shërbime me politikën dhe faktorët ekonomikë, që ndikojnë në një mënyrë apo në një tjetër, në politikën redaktuese. Shumë respekt për përjashtimet në profesionin tonë.

### **3. Mediat sa kanë hapësirë shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen, nga garniturat politike në pushtet?**

Liria e shtypit, fillon e përfundon në përkufizimin që vetë ne ia japim kësaj lirie. E kjo liri sërisht varet nga afërsia jote politike-ekonomike, me qendrat e fuqisë. Hapësira mund të kufizohet në kufijtë e lëvdatave për çdo gjë që bën qeveria apo opozita, e deri në qasje kritike të argumentuar të të njëjtave, duke dhënë zgjidhje. Kushtetuta garanton moscenzurimin e fjalës së lirë. Pushteti thotë se “jo tamam çdo gjë mund të thuhet në emër të kësaj të drejte”. Vazhdojmë të jemi në një ambient ku e vërteta jo çdo herë është e vërtetë. E ku fatkeqësisht, e vërtetë quhet vetëm ajo që u leverdis qendrave të caktuara të interesit qoftë politike, qoftë ekonomike.

Qeveria ende vlerëson se gazetarët duhen mbajtur nën kontroll, lufta kundër lajmeve të rreme, justifikon pushtetarët të akuzojnë media e gazetarë të caktuar për shpërndarje të lajmeve të rreme, sa herë që informacionet nuk shkojnë në favor të interesave të tyre. Për t'i bërë ballë këtij presioni, nuk duhen vetëm gazetarë medialisht të edukuar, por edhe qytetarë medialisht të edukuar, që do të dinin të dallonin se kur një lajm i caktuar ka prapavija të tjera, e kur informacioni është një e vërtetë që kërkon zgjidhje reale për një vendim të gabuar të poliriëbërësve. Në frikën se nëse kritikon, mund të etiketohesh si gazetar opozitar, autocenzura është zgjidhja më e qetë e shumë gazetarëve. Pakica tjetër, ende vazhdon të vlerësojë se media është korrektor i pushtetit dhe mban lart dinjitetin e profesionit.

#### **4. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita politike në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtjshme?**

Një gazetar i guximshëm, nuk dua të elaboroj për çfarë interesash, por e cilësoj të guximshëm, zbardhi për opinionin skandalin në rastin “Zhvatja” duke qartësuar sado pak hutinë e disa vendimeve gjyqësore të pakuptueshme për persona të veçantë të akuzuar në rastet e PSP-së. Një lajm mediatik, për fat të keq jo i mediave në RMV, çoi në dorëheqjen e zv/ministrit të shëndetësisë. Presioni mediatik, bëri të dorëhiqet deklarativisht zv/kryeministri i ekonomisë, i cili ende kryen funksionin e tij, sepse nuk ka “kush ta zëvendësojë”.

Mediat kanë ndikim, por mediat nuk guxojnë “të lodhen” nga hulumtimi i së vërtetës, që në fakt është hulumtim në kontinuitet dhe kërkon përkushtim. Për të thënë të vërtetën e pastër duhet të kesh guxim, nuk duhet të lejosh të të vënë çmim blerës, nuk guxon të frikësohesh se ndoshta përfundon burgjeve duke nxjerrë të palarat e “të fuqishmëve” apo se ndoshta të zhdukin. Elita politike deklarativisht i është mirënjohëse mediave për publikimin e problemeve të caktuara, përmirësimi i të cilave do të përmirësonte jetën e qytetarëve dhe vetë mënyrën e politikëbërjes, por realisht, asnjë pushtet nuk do media kritike. Ideale do të ishte një media që nuk merret me vendimet e tua të gabuara, ideal për çdo qeveri, janë gazetarët që nuk bëjnë pyetje të sikletshme. Presioni mediatik ka treguar se nëse jemi të palëkundur, nëse bashkohemi në qëllimin e vetëm, të thënies së të vërtetës sado t’i dhembë qeverisë, gjërat ndryshojnë. Tërheqja e ligjit për tregjet e gjelbra, është vetëm një dëshmi shtesë se mediat mund të detyrojnë qeverinë të ndryshojë politikat e gabuara. E shembuj të tillë ka.

#### **5. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Sipas definicioneve të njohura, media merr gjithnjë formën e strukturave shoqërore dhe politike brenda të cilave operon. Në mënyrë të veçantë media reflekton sistemin e kontrollit shoqëror, brenda të cilit janë rregulluar marrëdhëniet mes individëve dhe institucioneve. Nisur nga kjo, sigurisht që media ka rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për të inicuar ndryshimet për qeverisje të dobishme. Problemi qëndron në faktin se sa mediat e përdorin këtë pushtet dhe sa mospërdorimi i kësaj fuqie në masën e duhur, i jep komoditet pushtetarëve në politikëbërje. Vetë radhitja e RMV-së në listën e vendeve me liri të kufizuar

të mediave, tregon se përdorimi i këtij pushteti nga ana e mediave, lë akoma shumë për të dëshiruar.

**6. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Shkalla e pavarësisë së mediave përcaktohet në shkallë të madhe nga shkalla e kontrollit të medias nga strukturat politike. Politika shpesh ka përdorur “armë” të ndryshme për të pasur ndikim në media. Ligjin për media e miraton politika, në versionin aktual kontrolli për hir të së vërtetës, është më i sofistikuar dhe më i moderuar. Kontrolli fillon me përpjekjet për të kontrolluar transmetuesin publik (RTM), përmes mënyrës së financimit dhe kontrollit të përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve drejtuese. Këta të fundit sipas ligjit, duhet të propozohen nga organizatat e shoqërisë civile, organizatat e gazetarëve apo nga bota akademike, me kritere qartësisht të paracaktuara e që në një farë mase janë të kënaqshme në letër. Por në fund të procesit vendimi merret nga politika.

Këtë e vërteton fakti se ende partitë nuk po dakordohen dot për këshillin drejtues të RTM-së. Sa i përket financimit nga buxheti, RTM zgjidhi problemin akut të mungesës së financave, duke mundësuar kështu kontrollin qeveritar në politikat redaktuese dhe zhvillimore. Kjo për faktin e thjeshtë se qeveria, nuk respekton ligjin dhe nuk i kalon transmetuesit publik shumën financiare të cilën vetë u dakordua t’ia akordojë. Kjo mospagesë e financave që na takojnë sipas ligjit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në program, pasi nuk jemi në gjendje për mungesë financash, të realizojmë programin e punës të paraqitur e të miratuar edhe në Kuvend. Të dy palët shkelim ligjin, askush nuk mban përgjegjësi. Mediat private kanë varësi të tjera në luftën për mbijetesë në treg. Mendimi im, në RMV nuk ka media tërësisht të pavarura, ka media të varura në anën “e duhur” ose “të gabuar”. Profesionalizmi varet nga fakti i thjeshtë se në cilën anë të varjes je.

**1. Si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë?**

Mediat masive kanë rol kyç në hartimin e politikave. Kanë aftësinë për të arritur në masat e gjera me mesazhe të forta dhe me ndikim që ndikojnë në shoqëri. Media ka të paktën tre role të rëndësishme: të informojë, edukojë dhe të ndikojë në opinion. Këto tipare të veçanta të mediave tradicionale, janë shkaktuar nga media e re. Media tradicionale është shoqërues, por edhe burim i rëndësishëm informacioni për ndjekësit e televizioneve.

**2. A janë mediat faktorë për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

Raportimi i mediave, si dhe sferat e tjera të organizimit dhe veprimit shoqëror, është i lidhur me diskursin politik publik. Kjo shpesh është faktor kryesor në përcaktimin e informacionit publik në kushte të mobilizimit politik. Prandaj, media është një faktor kryesor në zbatimin e proceseve politike, veçanërisht në kuptimin cilësor.

**3. Mediat sa kanë liri shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen jo të mirë, nga garnitura politike në pushtet?**

Media dhe politika kanë marrëdhënie komplekse dhe si dy sfera shoqërore ndërtohen ose ndërliken mes veti. Kjo i referohet marrëdhënieve që media dhe gazetarët ndërtojnë në veçanti me partitë politike. Liria e mediave është gjithmonë një pasqyrim i natyrës së sistemit politik. Ekziston ndikim i drejtpërdrejtë në nivelin e demokratizimit të shoqërisë me lirinë e mediave, e cila është e lidhur me kulturën politike, por edhe me mekanizmat e kontrollit juridik dhe shoqëror të pushtetit politik të ndërtuar. Perceptimi i përgjithshëm është se media nuk ka shumë hapësirë shprehëse për të shprehur pakënaqësi për proceset politike ose keqmenaxhimin nga partitë në pushtet.

**4. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita politike në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtejshme?**

Përgjigja e pyetjes - në çfarë mase merret parasysh mbulimi i mediave nga elitat politike në pushtet, megjithatë, varet nga politikanët. Prandaj mendoj që palët që duhet t'i përgjigjen kësaj pyetjeje, janë partitë politike.



## **5. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Media ka rol korigjues të shoqërisë, por a e kryejnë realisht atë funksion në vendin tonë, duhet të hetohet nga publiku dhe partitë politike.

## **6. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Vetë-rregullimi në media është një model i pranuar përgjithësisht, përmes të cilit vendosen marrëdhënie dhe lidhje në gazetari, respektohen standardet dhe parimet etike. Është përpjekje e përbashkët e punonjësve të mediave, për të krijuar udhëzime editoriale. Në një epokë të rritjes së informacionit, mungesa e aftësisë në media, sensacionalizmi, lajmet zbavitëse apo lajmet e rreme, kanë sulmuar seriozisht cilësinë e gazetarisë, gjegjësisht, pluralizmit në media.

Gazetarët nën presionin e qeverisë, nën presionin e pronarëve, sakrifikojnë objektivitetin e tyre në raportim. Vetë-rregullimi është vendosur teorikisht nga teoricienti i shquar i mediave franceze Claude Jean Bertrand.

Përshtypja e përgjithshme është se media nuk kontribuon në informacion cilësor për publikun. Çdo qeveri natyrshëm dëshiron që media të jetë sa më pozitive në lidhje me sukseset e saj, por qeveria duhet të heqë dorë nga ndikimi në media.

## **Admir Qose – Kryeredaktor i AlsatM**

### **1. Si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë?**

Mediat ndikojnë në politikbërje, falë aftësisë dhe pushtetit të tyre që konsiderohen si pushtet i katërt. Trajtimi i shumë ngjarjeve, i shumë skandaleve ose i rasteve konkrete që dalin në opinion, i raporteve të ndryshme që vijnë nga institucione relevante siç janë revizori, nga institucionet siç është prokuroria, gjykata, etj, pasqyrimi i tyre në media dhe hedhja e ngjarjeve për vlerësim dhe komentim në opinionin publik përmes medias, e cila ka rol si urë lidhëse dhe testimin të ngjarjeve me zërin publik, janë një formë presioni që e detyrojnë partinë, e detyrojnë sektorin civil, detyrojnë që të gjithë aktorët jetësorë politik, të nxiten që të japin reagime. Një gjë e tillë si feedback final, ka faktin që edhe partitë të reflektojnë në organet e tyre si komitetet ekzekutive ose në takimet me qytetarët, arrijnë t'i

artikulojnë këto gjëra, dhe të njëjtat të mund t'i pasqyrojnë, përmirësojnë dhe në fund t'i zbatojnë, ndoshta përpara zgjedhjeve, ndoshta përpara proceseve të tyre më të mëdha, etj.

Pra, do të thoja që media ka ndikim, pavarësisht se duhet të kemi një qëndrim të qartë edhe mbi faktin që media fatkeqësisht ende nuk është e çliruar nga pozitat e saj politike, biznesore, të presionit nga grupe të caktuara, njerëzish ose lobues. Megjithatë pasqyrimi i ngjarjeve të caktuara në media, tregon se media ka efekt ndikues në politikbërjen e vendit.

Unë jam i qëndrimit dhe e mbështes fort këtë që media edhe pse e gushitur deri diku për shkak të ndikimit politik, biznesor, lidhjeve të ndryshme, prapë është një nga faktorët më kryesorë në arritjen e politikbërjes në shtet.

## **2. A janë mediat faktor për përmirësim në aplikimin e proceseve politike?**

Po. Përgjigjja ime është po. Pikërisht duke u nisur nga ato çfarë thash edhe më sipër. Mediat e kanë atë ndikim, e kanë atë forcë që ta gozhdojnë një parti politike, ta gozhdojnë një grup të caktuar njerëzish, të gozhdojnë një politikë të caktuar, qoftë shtetërore qoftë politikë që vjen nga një grup tjetër interesi, dhe pas analizave të shumta të mund të kenë aftësinë e tyre ose ta zhbëjnë një politikë ose t'i japin një kahëzim tjetër, që ajo politikë është e vlefshme, por edhe mund të përmirësohet në favor të qytetarëve.

Pa saktësuar diçka konkrete, di që kemi pasur plot politika që kanë qenë lidhur me rininë, me largimin e rinisë, si mund ta mbajmë këtu, me largimin e mjekëve, spacializantëve, janë bërë sondazhe, debate politike, janë bërë kërkesa nga interes grupe të caktuara. Kjo mund të jetë një nga faktet që qeveria ose ministria konkrete të ketë qenë e detyruar, t'u krijojë masa lehtësuese specializantëve me specializime të posaçme që ata të qëndrojnë këtu dhe ta shikojnë vendin e tyre si mundësi për të kontribuar në të ardhmen, t'u krijojë rritje rroge, etj.

Media është në kuadër të këtij drejtimi që të jetë faktor kryesorë në përmirësimin për aplikim të proceseve politike. Këtu nuk marrim parasysh vetëm politikën, por për proceset politike gjeneralisht. P.sh.: shumë parti të vogla arrijnë që ta gjejnë veten me grupe të caktuara qytetarësh duke artikuluar nevojat e tyre dhe prandaj mund të krijohet një parti e vogël. Cili do proces që këto parti nisin dhe fakti që gjejnë mbështetje te qytetarët dhe gjejnë hapësirë të mundshme relevante, që temat e tyre të diskutohen në media, nënkupton se ato kanë një proces të caktuar politik dhe që është relevant. Kështu që nuk mund ta mohojmë faktin që media me anë të dhënies së kësaj hapësire televizive për diskutim, është faktor

kryesorë në përmirësimin e proceseve politike dhe politikave të shumë faktorëve të tjerë në jetën tonë të përditshme.

### **3. Sa liri shprehëse kanë mediat për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen jo të mirë nga garnitura politike+ në pushtet?**

Ekspertët e medias dhe ne si televizione, mund të bëjmë një dallim fare të lehtë se si ka qenë njëra garniturë dhe se si është garnitura tjetër, por janë edhe institucionet e tjera relevante, që masin transparencën e institucioneve, kështu që liria e shprehjes nuk është në nivele të kënaqshme ende në Maqedoni. Po t'i shikojmë raportet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, si FreedomHouse, e të tjera, krahasuar me garniturën e kaluar, nëse nuk gaboj, Maqedonia ka një rritje për 7 ose 9 vende. Kjo nuk do të thotë se është e mjaftueshme. Ne nuk jemi Finlanda, nuk jemi shtete të tjera që mbajnë vendin e parë, as Amerika nuk e mban vendin e parë, vetë presidenti Trump ka averzion ndaj gazetarëve dhe i quan ata 'enemy of state' – armik të shtetit, ndaj Maqedonia hyn në shportën e atyre vendeve që janë njësoj si me vendet afrikane, etj., pavarësisht se sipërfaqësisht duket që bëhet diçka, dhe është e vërtetë që me përbërjen e fundit qeveritare, ka një transparencë më të madhe.

Mediat luftojnë, por nuk mund të mohojmë edhe presionin. Përse? Marrë nga aspekti institucional, çdo qeveri ka pasur njeri që është përgjegjës për mediat, edhe në këtë qeveri është Ministri Popovski, që në këtë rast, nuk bën dallim nga herët e kaluara kur ne kemi pasur ministër propagande, pra është thjeshtë një formë e ndryshuar e titullit. Ai si ministër në qeveri, tenton që të bëjë propagandën, por nga ana tjetër kur nuk e arrin dot atë, normal shikon edhe mjete të tjera të caktuara se si t'i bëjë mediat, t'i detyrojë ose t'u telefonojë gazetarëve ose shefave të medias, që lajmet të dalin në favor të tyre, ose të paktën mos t'i dëmtojnë. Kjo nuk bëhet me mjete të dhunshme siç është bërë dikur, por në një formë të sofistikuar, ashtu siç është sofistikuar edhe jeta jonë sot për sot. Pra e kemi ende këtë "propagandë", këtë presion politik.

Liria e shprehjes është ende e cunguar. Nëse i referohemi shembujve më lartë kur dikush të bën një telefonatë që ky lajm të mos paraqitet, nuk është vetëm ai një element që të bllokoi lirinë shprehëse. Liria shprehëse e një televizioni varet shumë kur ti i drejtohesh një institucioni për pyetje dhe t'i kthen përgjigjet pas dy muajsh, dhe është e vërtetë, meqë ligji parasheh deri në tre muaj pritje për përgjigje, por kjo është katastrofike.

Në garniturën e kaluar kemi pasur raste të mëdha etnike, sulme, rrahje, vrasje, dhe në 99% të të gjithë rasteve, Ministria e brendshme nuk ka guxuar të dalë në të njëjtën ditë, në të njëjtën sekondë që ta japë ngjarjen ose të jetë në hap me gazetarët dhe të bëhet paralel në

investigimin e një ngjarje, por zakonisht i është dashur tre katër ditë për të dalë me një qëndrim të caktuar dhe kanë thirrur pres konferencë dhe ato tre katër ditë, lënë hapësirë për dyshime të mëdha që ajo vrasje ose ai akt mund të manipulohet, mund të interpretohet ndryshe, dhe sipas kësaj, institucioni paraprakisht blen opinionin dhe pastaj del me qëndrimin e tij, gjë që duhet të jetë e kundërta.

Ne nuk kemi një transparencë fuqplotë, midis institucionit, medias, titullarit, gazetarit dhe të shkurtojme kohën e bërjes së lajmit dhe kontaktit me publikun. Sipas mendimit tim, po të bëjmë dallime me garnitura, jemi diku për 3-4 vende më mirë, por për mua si kryeredaktor i Alsatit, janë jo relevante. Nuk jemi ende në ato suaza ku institucioni duhet të të rri gatitu për informatën e caktuar, ashtu sikurse gazetari punon gatitu për ndodhitë në teren.

#### **4. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtejshme?**

Unë do të doja të besoja që po, por në shumicën e rasteve ose ndodhivë të fundit, edhe jo. Nëse marrim çështje të caktuara siç ka qenë amnistia, prishja e parimit të drejtësisë, media ka bërë presion të mos ketë amnisti ashtu sikurse kemi ngritur zërin kundër ish-Presidentit Ivanov kundrejt amnistimit të keqberësve të caktuar duke kërkuar drejtësi në institucionet përkatëse, por edhe tani nuk ka ndodhur që autoriteti t'i dorëzohet presionit. Kemi pasur amnistinë e deputetëve, ata që hapën dyert e kuvendit, kur opozita akuzon kryeministrin se është i vetamnistuar, etj. Nëse unë si kryeredaktor, por edhe si qëndrim personal e konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishëm parimin e drejtësisë, e quaj të patolerueshëm dhe si një materie jashtë negociatave të mundshme politike që dikush, pavarësisht autoritetit politik që ka, të mund ta përdor. Kështu që në këtë rast, për sa i përket pyetjes, shpreh skepticizëm.

Ndërsa për sa i përket rasteve tjera të shqetësuese nga ana e qytetarëve, dhe më pak relevante për pushtetarët, si rasti i jugohromit ose shqetësime të qytetarëve, mund të them që një pjesë e mirë e rasteve kenë parë zgjidhje, dhe kjo falë edhe presionit të medias edhe reflektimit të zërit të qytetarit dhe pa anketën që bën media me qytetarët, nuk mundet të përçojë mesazhin e qytetarëve politikanit.

Dua të besoj që media e ka atë pushtet, që falë raportimeve mediatike, mund t'i ndryshojë qëndrimet e një autoriteti politik, të një kryetari komune, të një institucioni që ka të bëjë me rregullimin e një rruge, ose mbikalimi siç është rasti konkret i fundit i mbikalimit

në Bitpazar që Alsat bëri lajm për pamundësinë e përdorimit të mbikalimit, për shkak se është bllokuar nga kioskët e caktuar, edhe ashensori është i mbushur me mall. Asnjë autoritet nuk ka forcën e duhur që të heq atë kioskë dhe të kërkojë që qytetarët të mos hapin kalim tjetër të jashtë ligjshëm, ku nuk ka madje as vija të bardha. Kemi pasur të paktën dy vdekje deri më tani në mes të rrugës në Bitpazar. E gjithë kjo sepse as Kryetari i Komunës dhe as Kryetari i Qytetit nuk marrin iniciativë të përbashkët për zgjidhje të problemit të mbikalimit ose të paktën të legalizohet ai kalimi i paligjshëm i qytetarëve, të vendosen vijat e bardha dhe që shoferi ta dijë që është hapësirë për këmbësorë. Por kjo neglizhencë në të verbër, bën që kjo situatë të jetë ende pa zgjidhje.

#### **5. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Në këtë situatë që ne po përmendim (duke iu referuar problemeve më lartë), në këtë përplasje të rrymave politike, biznese, grupeve të interesit, gjithashtu në kushte të parregulluara të një tregu mediatik, që tenton të vetë-rregullohet, por nuk ka një kornizë të qartë ligjore, kur ndryshimet ligjore janë të pamundura në kuvend, kur në televizionin shtetërorë ku duhet të jetë pasqyrimi më i mirë dhe shembulli më i mirë i korrektësisë mediatike, por ende mbetet hallkë politike e cilësdo garniture politike, e mungesës së vullnetit për pastrimin e shumë problemeve brenda, nënkupton që tregu këtu është i paarrtshëm. Në kushtet e këtij tregu të parregulluar dhe faktorëve që ndikojnë, do të thoja që prapë se prapë media ka bërë diçka dhe tenton të bëjë çdo gjë, edhe përkundër mungesës së gazetarëve dhe mundësive që kemi, sërish këmbëngul, që ne kemi aftësinë që t'i detyrojmë falë raportimeve dhe dua të besoj që jemi faktorë ndryshues pozitiv drejtë qeverisjes më të dobishme.

#### **6. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Partitë politike sikurse bëjnë me qytetarin, ashtu bëjnë edhe me median kur vjen periudha e zgjedhjeve, ofrojnë, premtojnë, garantojnë çdo gjë. Që nga zgjedhjet e 2008 mbaj mend që ende subjekte politike na kanë borxh për fushatat e tyre, d.m.th. kjo është shumë reale te ne, njësoj siç e gënjejnë qytetarin, gënjejnë edhe median. Duhet të kemi parasysh një fakt, të gjitha televizionet tona kombëtare kanë ardhur ose nga periudha e privatizimit të Maqedonisë ose edhe më vonë, por ama një gjë është e qartë, që të gjithë në krye kanë biznese dhe nëse nuk ka ndikim biznesi i vet i tyre, normalisht që ka politika. Edhe

përkundër uljeve dhe ngritjeve të tyre, përsëri jemi të ekspozuar në ato lidhje. Media nuk është një grup i caktuar gazetarësh të pavarur ose një asociacion i pavarur që të ketë bazë financiare të pavarur që të na bëjë neve më të qartë dhe me imunitet për të mos u prekur nga ndikimi politik ose nga lidhja me partitë politike, d.m.th. edhe neve nuk mund të themi që jemi të pavarur, asnjë në median e Maqedonisë nuk mund ta thotë këtë. Ka që janë më të varur, dhe disa më pak të varur. Aspekti financiar dhe kjo parregullsi mediatike, si pronar i medias dhe si menaxhment, tërthorazi të çon që të shpresosh që kur të vijë paratë e fushatës së njërës parti, të mund të paguash kuadrin tënd, punëtorët, etj. Kështu që nuk ka asnjë arsye të fortë që ta mohoj dhe të them që sot neve nga Maqedoni jemi Finlandë. Jemi të varur, nuk jemi të pavarur, por cilido jemi të varur në formën e vet dhe në sasinë e vet, por jemi.

## **Goce Mihajloski – Kryeredaktor i Kanal 5**

### **1. Si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë?**

Media në shoqëritë moderne demokratike ka pasur një ndikim të madh në hartimin e politikave. Natyrisht edhe Maqedonia, nuk është përjashtim. Një nga rolet kryesore të mediave është të quhet ‘qeni roje’ për vlerat demokratike dhe të alarmojnë në kohë për të gjitha devijimet. Kjo zakonisht ka sukses edhe te ne, megjithëse institucionet nuk janë ende plotësisht transparente dhe media ka burime të kufizuara.

### **2. A janë mediat faktorë për përmirësim në aplikim të proceseve politike?**

Pjesërisht, po, edhe pse fatkeqësisht në vitet e fundit kur portalet në internet dhe në rrjetet sociale po lulëzojnë, si të ashtuquajtura media të reja, përdoren gjithashtu në drejtim të kundërt, d.m.th., për të krijuar opinionin publik sipas dëshirës së qendrave politike të pushtetit. Sidoqoftë, ndikimi i mediave është i padyshimtë, veçanërisht i besueshëm, dhe ka shumë raste kur pasi publikohen histori ose raste, bëhen korigjime të politikave. I tillë është rasti me nepotizmin dhe shpenzimet e udhëtimit.

### **3. Sa kanë mediat hapësirë shprehëse për pakënaqësitë e proceseve politike ose qeverisjen, nga garniturat politike në pushtet?**

Sipas *Freedom House*, media në Maqedoni është ende pjesërisht e lirë, por ndryshe nga vite më parë, sot shkruhet dhe raportohet lirshëm për të gjitha skandalet kryesore të

korruptionit ose rastet e qeverisjes së keqe. A mund të bëhet më shumë dhe më mirë, natyrisht që mundet. Sa u përket partive në pushtet, ata gjithmonë do të përpiqen të ndikojnë në media, thelbi është që mediat të jenë rezistente ndaj atyre ndikimeve.

#### **4. Sa merren parasysh raportimet mediatike nga elita politike në pushtet, në mënyrë që të hasen përmirësime të mëtejshme?**

Elitat politike nuk janë gjithmonë të lumtur të pranojnë kritika, pa marrë parasysh sa pretendojnë ta perceptojnë atë si qëllim-mirë. Ata gjithmonë refuzojnë të mohojnë deformimet e qeverisjes dhe të mbrojnë zyrtarët e tyre, por në rastet kur ka shumë fakte që tregojnë për abuzime, atëherë subjektet të frikësuar për rejtingun e tyre, ndërmarrin disa hapa. Çështja është se ata e bëjnë atë për interesat e partisë së tyre, dhe jo sepse janë kundër një mënyre të tillë të funksionimit. Atyre thjesht ju pengon vetëm imazhi i tyre i keq.

#### **5. A janë mediat faktorë ndryshues pozitiv për qeverisje të dobishme?**

Padyshim që po, veçanërisht ato që u përmbahen standardeve profesionale të raportimit. Politikanët në fakt kanë frikë vetëm nga media, të cilat pavarësisht nga të gjitha problemet me të cilat përballen, mbesin pranë popullit dhe problemet me të cilat përballen në jetën e përditshme.

#### **6. Si do ta përkufizonit veprimin e mediave në vendin tonë? - Të varur ose të pavarur nga subjektet politike?**

Është e vështirë të përgjithësohet, por politika kurrë nuk do të heqë dorë nga përpjekja për të ndikuar pak a shumë në punën e mediave. Kjo ndodh edhe në shoqëri shumë më të përparuara se sa e jona. Sidoqoftë, jo të gjithë janë të njëjtë dhe ka shembuj për të cilët mund të krenohemi.

Është për t'u përshëndetur transparenca, sinqeriteti dhe guximi i kokave udhëheqëse të 2 prej televizioneve më në zë për t'u informuar qytetarët. Moskokëçarja ndaj të thëni të vërtetën troç dhe pa hezitim, bën që të dua edhe më tepër zgjedhjen e diskutimit dhe hulumtimit të kësaj problematike. Si servisi publik dhe ai privat, janë më se të etur për pavarësi dhe transparenca, ose të paktën për më pak ndikim kontrollues në politikat redaktuese mediatike. Por s'mund të lë pa përmendur faktin që kam vërejtur përgjigje diplomatike dhe të tërthorta nga ana e dy kryeredaktorëve maqedon, por gjithsesi secili prej tyre në formën e vet janë dakord për një treg mediatik më të lirë dhe pa kontroll politik në të.

Gorenca dhe Qose janë dakord që media nuk ka ndikimin e duhur në politikbërje dhe në vend që mediat të vihen në funksion të përmirësimit të politikbërjes, vihen në funksion të justifikimit të veprimeve politike, por edhe pse e gushitur deri diku për shkak të ndikimit politik, biznesor, lidhjeve të ndryshme, prapë është një nga faktorët më kryesorë në arritjen e politikbërjes në shtet.

Andonova dhe Mihajloski janë të mendimit absolut dhe të pahamendshëm që mediat në vend kanë rol kyç në hartimin e politikave dhe i ndihmojnë proceset politike dhe megjithëse institucionet nuk janë ende plotësisht transparente dhe media ka burime të kufizuara, mediat kanë aftësinë për të arritur në masat e gjera me mesazhe të forta dhe me ndikim që ndikojnë në shoqëri.

Edhe Qose do të jetë i mendimit që mediat janë faktor ndryshues. Sipas tij mediat e kanë atë ndikim, e kanë atë forcë që ta gozhdojnë një parti politike, ta gozhdojnë një grup të caktuar njerëzish, të gozhdojnë një politikë të caktuar, qoftë shtetërore ose qoftë politikë që vjen nga një grup tjetër interesi, por gjithnjë kur gazetari dhe media janë indiferent ndaj tentimeve të shantazheve ose blerjeve politike. Dhe nuk ka asgjë të keqe që një media të mbështesë politikat e një subjekti të caktuar, shton Gorenca, rreziku fillon kur mbështetja kamuflohet duke shkaktuar huti, kur vendimet politike të gabuara justifikohen me materiale gazetareske të kamufluara me “fakte” të pavërtetueshme. Në një atmosferë të tillë mediatike, vështirë që media në përgjithësi, aktualisht, të ketë ndonjë ndikim domethënës në politikbërje. Nëse për dy të parët ndikimi mediatik për përmirësim në vend ishte më shumë dëshirë se sa realitet, për Mihajloskin ndikimi i mediave është i padyshimtë, veçanërisht i besueshëm, dhe ka shumë raste kur pasi publikohen histori ose raste, bëhen korrigjime të politikave, por nuk ka cekur diçka konkrete.

Hapësira e të shprehurit të lirë për pakënaqësitë qeverisëse, është diskutabile sepse qeveria ende vlerëson se gazetarët duhen mbajtur nën kontroll, lufta kundër lajmeve të rreme, justifikon pushtetarët të akuzojnë media e gazetarë të caktuar, për shpërndarje të lajmeve të rreme, sa herë që informacionet nuk shkojnë në favor të interesave të tyre. Edhe në bazë të raporteve ndërkombëtare edhe në bazë të eksperiencës së tyre personale, përsëri vihet theksi i krahasimit mes qeverisë Gruevski tejet kontrolluese dhe pushtet-ushtrore dhe qeverisë Zaev më të hapur për ndryshime dhe më e lirë ndaj hapësirave mediatike. Sipas dallimeve të lartpërmendura mes garniturave politike, jemi diku për 3-4 vende më mirë, por



është arritje jo relevante sepse nuk jemi ende në ato suaza ku institucioni të rri gatitu për t'i dhënë medias infot e duhura dhe në momentin e duhur.

Për qeverisje të dobishme, është e domosdoshme reforma mediatiko-politike, që të mund të diskutohet për përparim. Mihajllloski është i bindur që media është faktorë ndryshues në vend, ndërsa ka disa nga rastet që kryeredaktorët kanë përmendur më lartë si rasti i amnistimit dhe prishja e parimit të drejtësisë, vetëamnistimi, gjithashtu edhe rasti i raportimit të vazhdueshëm për mbikalimin në bitpazar dhe hasja në vesh të shurdhër, janë rastet për të cilat vihet në dyshim marrja parasysh e raportimeve nga elitat në pushtet. Por nga ana tjetër kemi rast balancues të situatës së mëparshme që na çon të mendojmë që gazetaria në vend ende ka shpresë dhe një të ardhme më të ndritur, është zbardhja e rastit “Zhvatja”, duke qartësuar sado pak hutinë e disa vendimeve gjyqësore të pakuptueshme për persona të veçantë të akuzuar në rastet e PSP-së. Një lajm mediatik, për fat të keq jo i mediave në RMV nënvizon Gorenca, çoi në dorëheqjen e zv/ministrit të shëndetësisë. Presioni mediatik, bëri të dorëhiqet deklarativisht zv/kryeministri i ekonomisë, i cili ende kryen funksionin e tij sepse nuk ka “kush ta zëvendësojë”.

Dhe pyetja e fundit shtruar pjesëmarrësve në intervistë në lidhje me varësinë politike të mediatike, gjegjësisht a janë mediat te ne të varura politikisht ose jo, Andonova dhe Mihajllloski janë më optimist dhe më pozitiv në përgjigjet e tyre duke u thirrur në ato 3-4 pozitat ngjitëse të raporteve të fundit, por gjithnjë duke lënë të nënkuptohet që gjithmonë ka hapësirë për përmirësim dhe korrigjim.


Kundrejt tyre Migena dhe Admiri, mes ilustrimeve të përgjigjeve, kanë mendimet koncize dhe pa labirinte ku unanimisht janë të bindjes që në RMV nuk ka media tërësisht të pavarura, por ka media të varura në anën “e duhur” ose “të gabuar”. Dhe do të doja ta mbyll këtë analizë të intervistave me qëndrimin realist dhe pa kamuflim të Qoses ku thotë: Nuk asnjë arsye të fort; që ta mohoj dhe të them që sot, ne, nga Maqedoni jemi Finlandë. Jemi të varur, nuk jemi të pavarur, por cilido jemi të varur në formën e vet dhe në sasinë e vet, por jemi të varur.

#### 4.2. Shpalosja e rezultateve nga anketa e realizuar me 215 pjesëmarrës

Në vijim do të ilustrjmë të dhënat dhe rezultatet nga pyetësi anketues në lidhje me ndikimin e mediave në politikë, informimin e tyre për lajmet më të fundit, besueshmërinë në media dhe kënaqshmërinë e tyre me qeverisjen aktuale.


Janë përfshirë gjithsej 215 të anketuar të të dy gjinive, me nivele të ndryshme të arsimimit, me profesione dhe besime të ndryshme. Pjesa e interpretimit të rezultateve të arritura do të jetë në koordinim edhe me hipotezat e formuara në lidhje me ndikimin e politikës në tregun mediatik dhe shfaqjen e gazetarisë si sferë për arritje të qëllimeve politike.

Në grafikën e parë është ilustruar pjesëmarrja e të anketuarve në bazë të gjinisë.




**Grafika 1.** Tregues i pjesëmarrjes sipas gjinisë

Në vijim mund të shihet pjesëmarrja e të anketuarve sipas grupmoshës.




**Grafika 2.** Tregues i pjesëmarrësve sipas grupmoshës

Në grafikun e tretë kemi të ilustruar grafikun me pjesëmarrësit sipas nivelit të arsimimit.




**Grafiku 3:** Tregues i pjesëmarrësve sipas nivelit të arsimimit

Në vijim shohim frekuencat e pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike.



**Tabela 1:** Tregues i pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike


Në tabelën e dytë kemi ilustrimin e pjesëmarrësve sipas përkatësisë fetare.



**Tabela 3:** Tregues i pjesëmarrësve sipas përkatësisë fetare

Grafiku më poshtë është ilustrues i përgjigjeve të pjesëmarrësve në lidhje me njohuritë e tyre të sektorit joqeveritarë.


**A njihni ndonjë OJQ ose Shoqëri civile?**



**Grafika 4:** Tregues i përgjigjeve për njohuritë e sektorit joqeveritarë


Grafiku i pestë paraqet njohuritë e pjesëmarrësve në lidhje me reagimet e mundshme të sektorit joqeveritarë për raste të caktuara.

**A keni dëgjuar reagime nga OJQ-të në fjalë?**



**Grafiku 5:** Tregues i njohurive të pjesëmarrësve për reagime të OJQ-ve


Më poshtë mund të shohim rezultatet nga aktivitetet e qytetarëve në sektorin joqeveritar dhe vërejmë që dominon pjesëmarrja në debate të organizatave joqeveritare, mesatarisht me pjesëmarrje në trajnime dhe më pak në punëtori.



**Tabela 4:** Tregues i pjesëmarrësve në sektorin joqeveritarë

Shfaqja e rezultateve të radhës ka të bëjë me transparencën komunale për investimet me mjetet vjetore, dhe në të njëjtën vërejmë përqindjen e lartë të përgjigjes negative të kësaj pyetjeje, pothuajse e përafërt me përgjigjet e transparencës mesatare.


**Sa është transparente vetqeverisja lokale (Komuna), për mjetet vjetore dhe raportimin për ecurin e proceseve investitore në komunën përkatëse?**



**Tabela 5:** Tregues i transparencës komunale për mjetet vjetore

Në këtë tabelë dominon përgjigja negative për pjesëmarrjen komunale për buxhetin vjetor.


**A keni participuar në debate komunale, për buxhetin komunal, planin urbanistik ose në ndonjë mledhje për ndonjë rast tjetër të qytetit?**



**Tabela 6:** Tregues i pjesëmarrjes komunale për buxhetin vjetorë


Tabela e radhës ilustron përgjigjet e të anketuarve për ndikimin e mediave në politikbërje, dhe siç mund të vërejmë nga frekuenca e përgjigjeve, përgjigja *mesatarisht* ka dallim të dukshëm, por përgjigjet tjera janë shumë të përafërta me njëra tjetrën. Nëse pak ndalemi dhe analizojmë përgjigjet e kryeredaktorëve, mund të vijmë edhe në përfundim që përgjigjet e tyre me përgjigjet e të anketuarve, janë të njëjtin mendim që mediat ndikojnë në politikbërje, nëse jo tërësisht, të paktën mesatarisht.

**Sipas jush, si ndikojnë mediat në politikbërje në vendin tonë?**



**Tabela 7:** Tregues i pjesëmarrësve për ndikimin e mediave në politikbërje


Grafiku i radhës është ilustruesi i përdoruesve të rrjeteve sociale, një realiteti ndoshta pak të dëshiruar, por shumë i praktikuar nga të gjitha grupmoshat. Shpeshherë edhe moshat e mesme dhe personat e shtyrë në moshë, dinë të jenë pre e tranzicionit të brezit dhe të kaplohen nga tendenca e të pasurit profile në rrjete sociale, kurse kjo anketë ku janë të përfshirë të gjitha grupmoshat dhe me këto rezultate, e vërteton më së miri fenomenin e përdorimit të rrjeteve sociale nga të gjithë.



**Grafika 6:** Tregues i përdorimit të rrjeteve sociale


Gjithashtu kemi edhe tabelën e tetë me radhë, ku kam pyetur për mënyrën e informimit për lajmet më të reja.






**Tabela 8:** Tregues i mënyrës së informimit për lajmet e reja

Besueshmëria e lajmeve varësisht sipas mënyrës së informimit, është treguesi i radhës.



**Tabela 9:** Tregues i besueshmërisë sipas mënyrës së informimit

Tabela e 10-të dhe e fundit tregon frekuencën e lartë të pakënaqësisë ndaj mënyrës së qeverisjes në vendin tonë, dhe shohim qartë që qeverisja le për të dëshiruar.



**Tabela 10:** Tregues i kënaqësisë ndaj qeverisjes në vend

Duke u nisur nga rezultatet e grafikoneve dhe tabelave, vijmë në përfundim që qytetari ose votuesi, është shumë pak i informuar për hapat e vetëqeverisjes lokale, mënyrën e shpenzimit të mjeteve monetare, transparencën e vogël për po të njëjtin proces, gjithashtu edhe besueshmëria e vogël ose mesatare ndaj informimit mediatik.

## 5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE

### Hipoteza kryesore

- Mediat nuk janë të pavarura, d.m.th. ekziston lidhje varësie mes mediave dhe politikës!

### Hipoteza ndihmëse

- Gazetaria shihet si mundësi indirekte bindëse për të shërbyer në favor të politikës!

Që në momentet e definimit të titullimit të kësaj teze, kisha në hamendësim hipotezat e para që kishin të bënin me kufizimet politike kundrejt mediave dhe tregut mediatik. Thellë në vete ndoshta edhe shpresoja për rezultate ndryshe, më premtuese dhe më pozitive se këto, por argumentimi dhe vërtetimi nga gjithsej 7 të intervistuar dhe 215 të anketuar, bën që mos të ketë dyshime në lidhje me këtë çështje.

Janë disa gjëra që votuesi i di nën vetëdije dhe i nuhat nga përditshmëria e transmetuesve mediatik, por prapë pa fakte dhe pa prononcime koncize dhe të mbështetura në të vërteta të terrenit, ato mbeten pikërisht konkluzat e pabaza.

Kurse nga sot e tutje, me të gjitha të dhënat e mundshme të shkruara, të koleksionuara dhe hulumtimin vetanak, mund të themi që hipoteza kryesore dhe ndihmëse janë të vërteta. Pra tregu mediatik nuk është i pavarur dhe politika vë gisht në të sa herë që i jepet mundësia, që të shfrytëzojë gazetarinë si dritare lobuese për promovim të politikave të tyre.

## 6. PËRFUNDIMI

Përmirësimi i zbatimit të së drejtës për informim është themelor për një shoqëri më demokratike, më të hapur dhe për një qeverisje më transparente. Me gjithë përmirësimin e situatës në disa aspekte të zbatimit të së drejtës për informim, mbetet ende mjaft për të bërë në këtë drejtim. Ndryshimet e duhura janë në tri aspekte kryesore: rregullimi ligjor, praktika administrative dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve.

Përfundimi i kësaj teze më duket më se i qartë dhe konkret. Hamendësimet në lidhje me lirinë e shprehjes, transparencën mediatike dhe vërtetësinë në raportim, u përmblohdën në rezultate të hapura, ku media dhe politika dolën të gërshetuara me njëra-tjetrën. Pavarësisht rrethanave qofshin financiare ose profesionale, media është ajo e cila duhet të jetë e pakusht me publikun dhe e pashatër me politikën, ose të paktën jo deri në shkallë të kontrollimit absolut ose të manipulimit me informacione.

Mënyra e vetë-rregullimit ofron mjete përmes të cilave gazetarët dhe redaktorët mund të ushtrojnë lirinë e tyre redaktuese (editoriale).

- Vetë-rregullimi mbron lirinë redaktuese (editoriale).
- Ndhomon për të mbajtur në minimum ndikimin e qeverisë.
- Promovon cilësi.
- Promovon përgjegjshmëri.
- Bën kontakte me publikun.

Rritja e mediave të reja ka komplikuar sistemin e mediave politike. Media e trashëgimisë që përbëhet nga institucione të krijuara të mediave masive që paracaktajnë Internetin, të tilla si gazeta, emisione radio dhe programe lajmesh televizive, bashkëjetojnë me mediat e reja që janë rezultati i inovacionit teknologjik. Marrëdhënia midis mediave të trashëgimisë dhe mediave të reja është simbiotike. Media e trashëgimisë ka përfshirë media të reja në strategjitë e tyre të raportimit. Ata shpërndajnë materiale në një grup të platformave të reja të komunikimit.

Idealisht, media shërben me disa role thelbësore në një shoqëri demokratike. Qëllimi i tyre kryesor është të informojnë publikun, duke u ofruar qytetarëve informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të zhytura në mendime rreth lidërshiptit dhe politikave. Media vepron si roje që kontrollojnë veprimet e qeverisë.

## BIBLIOGRAFIA

Albanian Media Monitor 2003, Albanian Media Monitoring Centre, Tiranë, 2003

Alberto Papuzzi. Diskutim për etikën (përmbledhje esesh dhe artikujsh për etikën e gazetarisë së sotme), Instituti shqiptarë i medias, Tiranë, 2007

Andrew Heywood, Politika, Macmilan Foundations, Prishtinë, 2008

Aristoteli, Politika, Botimi I, Plejad, Tiranë, 2003

Bekim Baliqi, Politikat publike dhe qeverisja, Prishtinë, 2017

[https://www.researchgate.net/publication/322071392\\_Politikat\\_Publike\\_dhe\\_Qeverisja](https://www.researchgate.net/publication/322071392_Politikat_Publike_dhe_Qeverisja)

Charles Kegan Paul, "Journal of Politics". Cambridge Library, 2015

Christian Baylon, Xavier Mignot. Komunikimi, Logos A, Shkup, 2004

Daniel Dajun Zeng, Social Media Analytics and Intelligence, 2010

Framework: <file:///C:/Users/Mirjeta/Downloads/SNAMAuszug.pdf>

Denis McQuail, McQuail's Mass Communication Theory (6th edition), WashingtonDC, 2006

<https://www.amazon.com/McQuail%E2%80%B2s-Communication-Theory-Denis-McQuail/dp/1849202923>

Deni Elliott. Ethical Challenges: Building an Ethics Toolkit, First published by AuthorHouse, Bloomington, 2009

[https://www.academia.edu/35600873/Ethical\\_Challenges\\_PDF.pdf](https://www.academia.edu/35600873/Ethical_Challenges_PDF.pdf)

Diana Owen. The Past Decade and Future of Political Media: The Ascendance of Social Media, OpenMind Project

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/12/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-Past-Decade-and-Future-of-Political-Media-The-Ascendance-of-Social-Media.pdf>

Diana Owen. The new media's role in politics, OpenMind Project

<https://www.bbvaopenmind.com/wp-content/uploads/2018/03/BBVA-OpenMind-Diana-Owen-The-New-Medias-Role-in-Politics.pdf>

Димитар Мирчев, Лидија Христова, Модерната политологија, ФОН Универзитет, Скопје, 2008

Емилија Симоска, Наташа Габер, Климе Бабунски, Политичката култура на граѓаните во Република Македонија, Скопје, 2001

Eric Maigret, Sociologjia e komunikimit dhe e mediave, Botimi III, UET Press, Botimet Papirus, Tiranë, 2010

Francis Balle. Mediat dhe shoqëritë, Edicioni 15, Botimet 'Papirus', Tiranë, 2011

Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana, Sadri Ramabaja. Gazetaria 1, Shtëpia botuese e librit univerzitar 2003, Shtypshkronja 'Dajti2000', Tiranë, 2003

Hamit Boriç. Gazetaria 2, Shtëpia botuese e librit univerzitar 2004, Shtypshkronja 'Dajti 2000' Tiranë, 2004

Hasan Jashari, Jonuz Abdullai, Zemri Elezi, Memet Memeti, Ali Pajaziti, Fillet e pluralizmit politik në Maqedoni dhe post-komunizmi, Botuar nga SEEU, nga Shkup, 2019. Liljana Siljanovska. Artikulli: Media and the political pluralism during the post-communism in Macedonia

Holli Semetko, The media, journalism and democracy, United Kindom, 2000

<https://www.crcpress.com/The-Media-Journalism-and-Democracy/Scammell-Semetko/p/book/9781138729612>

Hysamedin Feraj, Shkenca Politike, Botimi I, Tiranë, 2004

Jonila Godole. Gazetaria shqiptare në tranzicion, Papirus, Tiranë, 2014

Jonuz Abdulli, Politika dhe politikat publike, Botimi III, Botuar nga SEEU, Tetovë, 2016

Joseph R. Dominick. Dinamika e komunikimit masiv (media në periudhën digjitale), UET Press, Tiranë, 2010

Konferencë shkencore. Media midis infomacionit masiv dhe marrëdhënieve me publikun. Organizatorë: Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, FHF, Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Komunikimit Masiv, Kolegji AAB, Prishtinë. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2016

[https://aab-edu.net/assets/uploads/2017/05/thesis\\_layout\\_shqip-1.pdf](https://aab-edu.net/assets/uploads/2017/05/thesis_layout_shqip-1.pdf)

Kristina Plavšak Krajnc. Marrëdhëniet me median - Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile, Rrjeti Ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile, Shkup, 2007

<http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/03/balkan-civic-practices-4-sq.pdf>

Lindita Aliu Tahiri. Bazat e komunikimit masiv, Tiranë, 2018

<https://stereotipe.files.wordpress.com/2018/11/bazat-e-komunikimit-masiv.pdf>

Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë, OSCE; Misioni në Kosovë, Qershor, 2014

<https://www.osce.org/sq/kosovo/122391?download=true>

Media dhe shoqëria e informacionit në Shqipëri, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë

Media Instituti i Maqedonisë dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis”-Shkup, Doracak për arsimtarë për zotërimin e mësimit bazik për mediat në lëndën e gjuhës amtare, Shkup, 2010

<http://www.medium.edu.mk/attach/mpal.pdf>

Michael Mule Ndonge, Media Ethics in Journalism and Mass Communication, Kenya, 2014

[https://www.academia.edu/8345702/Media\\_Ethics\\_in\\_Journalism\\_and\\_Mass\\_Communication\\_Exploring\\_the\\_Virtual\\_World](https://www.academia.edu/8345702/Media_Ethics_in_Journalism_and_Mass_Communication_Exploring_the_Virtual_World)

Norberto Bobbio, Politika e cultura, Cambiago, 1955

[https://www.abebooks.it/servlet/BookDetailsPL?bi=22828940960&searchurl=an%3Dbobbio%2Bnorberto%26sortby%3D20%26tn%3Dpolitica%2Bcultura&cm\\_sp=snippet-\\_srp1-\\_image1](https://www.abebooks.it/servlet/BookDetailsPL?bi=22828940960&searchurl=an%3Dbobbio%2Bnorberto%26sortby%3D20%26tn%3Dpolitica%2Bcultura&cm_sp=snippet-_srp1-_image1)

Neda Chaloska, Jasmina Golubovska, Voislav Stojanovski, Alkesandar Jovanoski, Overview by “Network 23”, Judiciary and fundamental rights in the Republic of Macedonia, Skopje, 2015 [https://www.epi.org.mk/docs/Analiza\\_Poglavje23\\_en.pdf](https://www.epi.org.mk/docs/Analiza_Poglavje23_en.pdf)

Natalie Jomini Stroud. Niche News: The Politics of News Choice, Issue 2, Oxford

University Press, New York, 2011

<https://www.universitypressscholarship.com/search?isQuickSearch=true&pageSize=20&q=Natalie+Jomini+Stroud.+The+Politics+of+News+Choice%2C+Issue+2&sort=relevance>

OJQ Civil, ShGM, Doracak Gazetaresk, 2011 <https://civil.org.mk/wp-content/uploads/2013/05/Journalist-Manual-inside-AL-4web.pdf>

Otfried Jarren, Medien, mediensystem und politische Öffentlichkeit im Wandel, 1998

[https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0\\_4](https://link.springer.com/chapter/10.1007/978-3-322-87320-0_4)

Programi i BE për Monitorim dhe Avokaci i Institutit të Shoqërisë së Hapur, Monitorim: Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia, Printuar në shqip nga shtypshkronja ‘Maluka’, Tiranë, 2005

Stanley J. Baran. Introduction to mass communication, Mayfield Publishing Company, Toronto, Update 2001.

Tom Murse, Aricle: How Social Media Has Changed Politics, 2019

<https://www.thoughtco.com/how-social-media-has-changed-politics-3367534>

Veli Kreci, Ali Pajaziti, Memet Memeti, Governence in public sector, Botuar nga SEEU, Tetovo, 2018

Vesna Shopar, Zoran Dimitrovski, Sefer Tahiri, Aleksandra Temenugova. Doracak për interesin publik në gazetari (Botues: Instituti i Studimeve të Komunikimit Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun), Shkup, 2016

<http://respublica.edu.mk/attach/priracnik-mediumi-11-03-2016-ALB.pdf>

Zekë Gecaj, The Kosovo: News & Propaganda War, The international Press Institute, Vienë, 1999

William Roberts Clark, Matt Golder, and Sona N. Golder. (2013), "Power and politics: insight from an exit, voice, and loyalty game."

[https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark\\_golder.pdf](https://projects.iq.harvard.edu/files/pegroup/files/clark_golder.pdf)

[www.bbvaopenmind.com](http://www.bbvaopenmind.com) OpenMind është një komunitet në internet, qëllimi i të cilit është të debatojë mbi temat e kohës sonë, për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri që do të përfitojnë nga shoqëria në tërësi. Më shumë se dyqind autorë udhëheqës, ekspertë dhe akademikë nga e gjithë bota, shqyrtojnë sfidat më të mëdha të shkencës, teknologjisë, ekonomisë dhe biznesit, dhe shkencave humane.

LINQE

<https://freedomhouse.org/report/freedom-press/freedom-press-2017>

<https://www.thoughtco.com/about-us>

<https://www.thoughtco.com/how-social-media-has-changed-politics-3367534>

<http://www.unesco.org/new/es/unesco/events/prizes-and-celebrations/celebrations/international-days/world-press-freedom-day/previous-celebrations/2012/2012-themes/media-freedom-has-the-power-to-transform-societies/>